



*Radioelektronika 74*

*Milano 2025*

*Petrit Misa*



*50 vjetori i diplomes*



*Ky liber lidhet me kujtimet e viteve të universitetit. Fillimisht nuk kisha shumë kujtime për ti paraqitur në një libër. Më kujtoheshin pak gjëra dhe shumë nga kujtimet ishin jo të plota dhe shpesh të pa sakta. Nga muaji qershor i vitit 2024, mbas takimit të 50 vjetorit të diplomës, ku u bë iniciator Gëzimi, dhe që u arrit edhe me përpjekjet e Pëllumbit Metit dhe Apostolit, arrita të ri vendos kontaktet me disa shokë të grupit. Me propozimin e Pirros dhe Maksit u krijua një grup në WhatsApp që u titulluar “radioelektronika 74.”*

*U bëra menjëherë anëtar dhe u propozova shokëve të mbledhja sa më shumë kujtime nga periudha e universitetit për ti paraqitur në një libër. Shumë treguan kujtimet e tyre. Për këtë arsye, unë grupin “elektronika 74” vendosa ta quaja edhe “Dritarja e kujtimeve”, sepse sa herë që “hap” këtë dritare gjej një kujtim të shokëve që i referohet atyre viteve. Nga ana tjetër kjo dritare nxit kujtimet dhe imagjinatën time për ti dhënë jetë dhe vërtetësi asaj që përshkruaj.*

***Dua, me këtë rast, të falenderoj të gjithë shokët për mesazhet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre të cilat e mundësuan shkrimin e librit.***

*Kreu i pare*

***Zborret Ushtarake***







*Divjakë 1970*

## **Zborri i parë**

Në çdo vit shkollor ishte i detyrueshëm zborri ushtarak një mujor. Në vitin e parë të universitetit, zborri na u caktua në Divjakë pranë një reparti të artilerisë kundërajrore.

Zborrin e filluam menjëherë mbas pushimeve të dimrit

Në Divjakën e vitit 1970 takuam vetëm pyll me pisha dhe kënetë. Reparti ushtarak ndodhej në brendësi të pyllit dhe jo larg detit.

Sapo mbritëm në repart, komandanti na rreshtoi përpara repartit për të na dhënë informacionet e duhura në lidhje me rregullat kryesore të zhvillimit të stërvitjes gjatë periudhës së zborrit.

Mbasi na uroi mirëseardhjen vazhdoi:

- Kini parasysh që këtu jemi zonë kufitare, kështu që edhe trajtimi i juaj është i nivelit më të lartë, por edhe stërvitja që do të zhvilloni ka kërkesa të larta dhe kërkon mobilizim të plotë, impenjim të lartë dhe sakrifica. Reparti jonë bën pjesë në forcat kundër ajrore të R.P.Sh, kështu që do të keni mundësinë të mësoni përdorimin e artilerisë kundërajrore që përfshin topat 76mm dhe 100mm dhe mitrolozët kundër ajror. Gjithashtu do të merrni

njohuritë e duhura edhe për sistemin e radarëve.  
Tani po ju le në dorën e instruktorëve tanë që do të kujdesen për sistemimin tuaj - tha komandanti dhe u largua duke na uruar zborr të mbarë.

Mbas apelit, u drejtuam për në magazinën e repartit dhe mbasi tërhoqëm rrobat e zborrit dhe automatikët, zumë vënd në kapanonin e caktuar për ne.



*Divjakë 1970*

## **Stërvitja Taktike**

**M**egjithëse ishte dimër miskonjat nuk mungonin. Këneta favorizonte prezencën e tyre në çdo stinë të vitit.

Më kujtohet Llëri, një nga shokët e kursit që bëheshe i ëmbël me të gjithë duke bërë shaka e treguar barcaleta. Por me sa duket e kishte gjakun e ëmbël edhe për miskonjat të cilat e ndiqnin shumë. Çuditërisht miskonjat e Divjakës dukeshin më inteligjente dhe më të rrezikshme se të tjerat. Duke bërë pjesë në këtë repart ushtarak, dukej që kishin mësuar edhe ato rregullat e stërvitjes dhe gjenin momentin e duhur për të të sulmuar. Zakonisht miskonjat preferojnë të sulmojnë qënjet e gjalla të palëvizura, dhe prandaj të pickojnë më shumë kur je në gjumë.

Por vura re që sulmi i miskonjave gjatë zborrit, koencidonte shpesh edhe me komandat “ gadi tu”, “në sup arm” dhe “ për nder arm”. Mbas këtyre komandave ushtarët duhet të qëndronin pa lëvizur duke u bërë prehë e sulmit të miskonjave.

Gjatë një paraqitjeje rreshtore, në stërvitjen e taktikës luftarake, instruktori i stërvitjes, komandant Gjini dha komandën:

- Toga. Në dy rreshta mblidhu!

Dhe më pas:

- Toga. Në sup arm! Gadi tu!

Të gjithë qëndruam gaditu dhe toga ra në qetësi. Dikush lëvizte kokën për të larguar miskonjat.

Nuk kaluan pak sekonda, dhe qetësinë e prishi zhurma e një shuplake. Ishte Llëri që, mesa duket e kishte vrarë miskonjën e vet, ngaqë një shenjë e kuqe i dukej mbi faqe.

Komandanti e dëgjoi dhe kur e pa shenjën, dha komandën :

- Prapsou! Pranë këmbës arm! Ushtar M. Përse nuk e zbaton komandën.
- Isha në luftë kundër miskonjave, shoku komandant.

Ne ja dhamë të qeshurës.

- Armiqtë tanë të vërtetë janë imperialistët dhe revizionistët dhe jo miskonjat. Miskonjat duhet di durosh.
- Si urdhëron shoku komandant - u përgjigj Llëri.

Më pas komandanti vazhdoi.

- Gadiii tu! Në sup arm! Para marsh! 1,2 ...1,2 -

dhe na drejtoi për në vëndin e stërvitjes. Stërvitja zhvillohej në breg të detit ku dukej vetëm deti, rëra dhe pylli i pishave. Sapo arritëm, komandanti vazhdoi me një seri komandash si:

“Togë ndal”, “majtas ktheu”, “pranë këmbës arm”, “rreshti i parë një hap para”, “përdhe arm” e “qetësou” dhe më pas filloi leksionin e taktikës.

Mbasi na spjegoi pozicionin e togës në luftim dhe pozicionin e çdo skuadre brënda togës, na bëri që të rimarim automatikët dhe na pozicionoi konkretisht në formacion luftimi. Pa pritur na bëri këtë pyetje:

- Supozoni që në këtë moment nga pylli me pisha do të dali një batalion i tankeve të armikut, cila do të ishte përgjigja jonë, çfarë veprimi duhet të bënte toga jonë ?

Për një kohë të gjatë ngelëm në heshtje, nuk dinim se ç'përgjigje të jepnim. Pyetja na u duk pa vend. Nuk flitej për rezistencë, ishim të armatosur me pushkë automatike por pa fishekë, reparti ishte larg dhe çdo tentativë për tja dhënë vrapit drejt repartit do të na sillte vetëm dënimin me vdekje. Dorëzimin tek armiku nuk e vinim në diskutim, do të konsideroheshin të gjithë tradhtarë të popullit, të atdheut dhe të partisë. Nuk dinim çfarë përgjigje të jepnim. Asnjë nuk e merrte fjalën. Komandantit ju kujtua historia e miskonjës dhe ju drejtua Llërit:

- Ushtar M. përgjigju. Ti çfarë do të bëje? Ki parasysh se në këtë rast nuk ke të bësh me miskonja - vazhdoi komandanti me ironi.
- Çere do të bojsha una? Shyqyr zotit, plaku ma ka mësu notin shoku komandant. Do futesha në det me not, kështu do ti fshihesha syrit të armikut.

Përgjigja origjinale e Llërit, bëri që të plaste gazi. Dikush filloi të duartrokiste.

Duke menduar që emri Gjin është emër i malësorëve të veriut të cilët banojnë larg detit, ju drejtua komandantit:

- Pse ju shoku komandant çere do bojshit?

Gjini u zu ngushtë. Dukej që vërtet nuk dinte as të notonte. Ne vazhduam të gjithë të qeshnim. Komandanti u skuq prej turpit. Kujtoj se e kishim me të, ndërkohë që ne qeshnim me origjinalitetin e fjalëve të Llërit. Llëri i binte drejt muhabetit dhe fliste pa influenca ideologjike.

Ai e kishte kuptuar mirë ironinë e komandantit dhe kur e pa që komandanti kishte rënë squk, duke parë edhe entuziazmin tonë, mori revansh:

- Shoku komandant ju na e shpjeguat bukur vendosjen e togës në pozicion luftimi. Por çere luftimi mund të bojm ne xhonëm kur, jo vetëm nuk kena anti-tanke, por nuk kena as fishekë me shti - dhe më pas vazhdoi ligjëratën:
- Partia dhe shtabi i përgjithshëm nuk na ka pru në zborr që të hikim si mish për top. Nga ne kërkohet që të ruajmë veten dhe të mos dorëzohemi tek armiku..

Llëri mund të vazhdonte gjithë ditën me këtë argument. Dukej sikur po i bënte moral komandantit. por Gjini e ndërpreu.

- Ushtar M. qetsohu, të kuptova drejt, por pyetja ime i referohet rastit kur do ti kishit të gjitha armatimet për tu mbrojtur. Tani jemi vetëm në stërvitje, dhe stërvitja jonë është taktike ku duhet të mësojmë si duhet ti kundërvihemi armikut dhe jo të hyjmë më det si thua ti - e mbylli bisedën komandanti.

Ndërkohë ne të gjithë e kishim të qartë që komandanti e kishte bërë pyetjen gabim dhe Llëri i ishte përgjigjur

drejt por kjo gjë i kishte ngritur nervat komandantit dhe prej Llërit e hëngrëm të gjithë. Komandanti na a “nxori shkumbën”, Na bëri të ecnim barkas deri sa mbaroi stërvitja. Mbas këtij debati dha menjëherë komandën:

- Toga, barkas shtriu! Me zvarritje drejt pyllit!



Kur hymë në pyll ju drejtova Llërit.

- Llëro, a sheh gjë tanke ti ?
- Çere tankesh o Tito, po ky osht bo me hije tu dhënë kët

mësim përditë..

Ne vazhduam të qeshurën. Komandant Gjini u bë keq:

- Vazhdoni zvarritjen barkas.

“ Oh ç’na bone Llëro” mendova me vehte pa e ndërprerë të qeshurin.

Zvarritja brënda pyllit u bë e vështirë mbasi përveç rërës kishte edhe shkurre e bimë me gjemba. Si për dreq, na zuri edhe shiu.

Më në fund komandanti na dha urdhërin:

- Toga, mbas meje në rresht për dy mblidhu! - Dhe vazhdoi:
- Me hap rreshtor dhe me këngë rreshtore drejt repartit, paraaa marsh!

Komandanti priste këngën rreshtore “në një të dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën”, por të gjithë ishim bërë

telef dhe asnjë nuk këndonte. Komandanti e kuptoi por vazhdoi të insistonte.

- Toga ndal! Me hap rreshtor dhe këngë rreshtore para marsh!

Përsëri qetësi. Asnjë nuk këndonte. Atëherë mu kujtua një këngë ritmike që ishte në “hit parade” dhe fillova ta këndoja me forcë:

“ Na na nana, na na nana, heej, good by 1,2. Na na nana, heej, good by 1,2...”

<https://youtu.be/QaG2Acg8n60?si=v4Gvcw4ZlXk7yOVB>

Komandant Gjinit i hipën nervat por nuk kishte çfarë të thoshte.

Në fund të fundit po këndonim një këngë rreshtore dhe po hecnim me hap rreshtor. Mesa duket e kuptoi që po bënte gabimin e dyte të ditës dhe dha komandën:

- Togë ndal ! Me këngë patriotike para marsh!

Atëherë nxora nga repertori një këngë koçare:

“Se un ushtar në kufi, në dëborë e në shi, nat e ditë për ty vigjëloj,

Se un ushtar në kufi.. “

***Komandantit, me sa duket i pëlqeu teksti i këngës ndoshta edhe për faktin që ishim në kufi e binte shi, dhe nuk u ndie më deri sa hymë në repart.***



*Divjakë 1970*

## **Kënga e luftës.**


**K**ishte kaluar java e parë e zborrit kur na komunikuan që të nesërmen do të zhvillonim një stërvitje speciale. Në orën e taktikës luftarake, toga do të merte pjesë në një aksion zbulimi. Stërvitja do të zhvillohej në kënetë dhe me pajisjet complete, përfshirë edhe kundra gazet. Në kontrollin e kësaj stërvitje do të merte pjesë edhe gjenerali Q.K. i cili ndiqte nga afër përgatitjen luftarake të këtij reparti ushtarak.

Siç kujton Fatmiri, gjenerali kishte zënë vënd në një pikë dominuese mbi kënetë. Që andej vëzhgonte stërvitjen dhe jepte instruksionet e nevojshme për zhvillimin e saj. Me qënëse në këtë stërvitje mernin pjesë edhe fëmijët e tre anëtarëve të byrosë politike, gjenerali kërkonte të linte një mbresë të veçantë tek këta të fundit për kualitetin e zhvillimit të stërvitjes. Kështu, në mënyrë indirekte do të informonte edhe udhëheqjen. Për herë të parë morëm pjesë në një stërvitje, ku përveç armatimit na ishin vënë në dispozicion edhe mjete të ndërlidhjes dhe mjete piroteknike.

Të nesërmen u bëmë gati dhe u nisëm. Këneta ishte relativisht e vogël, ishte më shumë moçal se sa kënetë. Nga bregu në breg ishin rreth 80m dhe nuk ishte më e thellë se 1,5m. Ishte e mbushur me kallamishte dhe me

bimë të tjera uji, të larta sa një bojë njeriu. Ne qëndronim në brendësi të pyllit me pisha dhe prisnim urdhëron për të filluar aksionin. “Armiku” ndodhej në bregun përballë.

- A e shihni flamurin e zi me kafkën e bardhë i cili simbolizon vdekjen? – Pyeti komandanti.
- Po - i thamë
- Aty janë forcat armike. Qëllimi i stërvitjes është që të merni në dorë flamurin armik në një kohë sa më të shkurtër nga momenti i dhënies së komandës së sulmit. Komanda e sulmit do të jepet vetëm kur grupi jonë i vëzhguesve do të dallojë lëvizje trupash në kënetë. Kështu që sa më vonë të diktoheni nga vëzhguesit, aq më afër objektivit do të jeni në momentin e sulmit dhe vlerësimi do të jetë më i lartë. Në fundin e stërvitjes, do të lavdërohet në mënyrë të veçantë ai që merr në dorë flamurin armik.



Mesa morëm vesh, në krye të grupit të vëzhguesve ishte vetë gjenerali që kishte përgatitur stërvitjen.

- Duhet të lëvizni me shumë kujdes që të mos diktoheni - shtoi komandanti. Na kërkoi fillimisht të maskoheshim me gjethet e kallamave dhe bimëve të tjera të kënetës dhe të merrnim distancë luftimi nga njëri tjetri. Duhej që të afroheshim barkas deri tek bregu

i kënetës dhe më pas të hynim me kujdes në ujë.. Komanda e sulmit ishte parashikuar të jepej me mjete piroteknike, që çdo gjë të zhvillohej pa zhurmë.

Filluam përgatitjet e maskimit. Llëri kishte frikë mos e pickonin miskonjat dhe mos shkaktonte lëvizje të pa dëshëruara.

- Vërtet Ilir, ty edhe të ngacmojnë shumë - i tha Etleva - harrova të marr kremin me vehte që të lyeje fytyrën.
- Nuk prish punë Etleva, se lyhem me voj pushke. E kom provu që nuk afrohen me këtë. Masanej, duhet me u ly ene me baltë kënete.

Mbaj mend që të gjithë qëndronim të heshtur në pritje të sinjalit të sulmit. Dëgjohej vetëm kënga e bretkosave të kënetës që dukej sikur po shoqëronte vallen e pilivesave që kërcenin mbi ujë. Miskonjat na vinin rrotull dhe na bezdisin. Por lëvizja më e vogël mund të tërhiqte vëmendjen e “armikut” kështu që duhej ti duronin.

Për fat bimësia që ishte rritur në kënetë na maskonte mirë. Lëviznin shumë ngadalë. Uji po na vinte deri në gju, por sinjali i sulmit nuk po dukej akoma. Kjo tregonte që akoma nuk ishim zbuluar dhe avancimi jonë në kënetë shkonte në rregull. Avancimi po, por i ftohti dhe lagështia na kishin hyrë deri në palcë. Për dreq filloi edhe shiu.

- Nonën atij që na futi në kënetë - foli Piro.
- Nonën the? Una e kom sha me libër shtëpie - shtoi Llëri.

- Çuna, kemi gocat këtu afër - ju tha Fatmiri.

Të sharat vazhdonin nëpër dhëmbë. Ishte e vetmja gjë që mund të bënim. Për të folur mund të flisnim se asnjë nuk na dëgjonte. Në një moment u dëgjua zëri i Gencit:

- Çuna mua po më shpëton çici në brekë nga të ftohtit.
- Mbaje Genco sa të vrasim armikun – i them.

Nuk guxonim as të qeshnim, që të mos dridheshim.

Në atë kohë, Llëri u kurdis:

- Genco futja në kënetë, se nuk meret vesh gjo këtu, këtu e bojn të gjithë, ene peshqit, ene bretkocat ene pilivesat. Boje ene ti.

Ne nuk e mbajtëm dot të qeshurit. Megjithatë, era e lehtë e kënetës favorizonte maskimin e dridhjeve të të qeshurës. Dukej sikur kallamishtet lëviznin nga era dhe jo nga lëvizjet tona.

- Dëgjoni këtu..., mua më ka hyrë “tartakuti” dhe po dridhem e tëra, po fajin e ke ti Ilir që i lëshon batutat vënd e pa vënd - ndërhyri Tenka - do na dënojnë që të flemë me bretkocat e kënetës sot.

Zëri i Tenkës na bëri që të pushojmë. Uji po na vinte deri në mes. Komandanti qëndronte në bregun përballë dhe vlerësonte nga larg veprimet tona. Ndërkohë i ishim afruar bregut dhe ndodheshim rreth 40m larg objektit të sulmit. Mu duk që momenti kishte arritur, dhe vërtet, mbas pak dëgjova krismën e thatë të pistoletës, dhe mbi kokat tona dallova shenjën piroteknike që na sinjalizonte për fillimin e betejës.

U dëgjua një thirrje e fortë që oshëtiu mbi kënetë. “Urmeta, urra, urmeta.” Kjo thirrje më ngjethi mishin, ndjeva gjakun që më lëvrinte ndër vena, fytyrën që mu skuq dhe flokët që mu ngritën përpjetë. Këtë radhë nga shpirti më doli kënga e luftës “urra, urra!” më e fortë se çdo këngë tjetër që kisha kënduar. Për një moment



mu duk sikur nuk më drejtonte më truri por shpirti. Ai i jepte fuqi këmbëve që vraponin duke shtyrë me forcë ujin e kënetës dhe drejtonte duart mbi automatik. Për pak sekonda u ndodha vetëm 10 metra larg bregut. Kënga e luftës vazhdoi më me forcë akoma “Në sulm përpara, urra!”

Veshët më oshëtinin nga zërat e shokëve që dukej sikur këndonin të njëjtën këngë. Për një çast mu duk sikur dëgjoja edhe breshërinë e automatikëve dhe zhurmën e predhave, si një orkestër që shoqëronte këngën tonë të luftës. Dallova pranë meje Piron, Beson, Ilirën, Fatmirin, Gencin, Tenkën dhe Llërin që me tytat e automatikeve të ngritur lart, vazhdonin atë këngë pa melodi “ urra....raa..” E ndieva që më kishte marrë euforia e luftës. Më vonë mendova që është pikërisht ajo eufori që të çon në vdekje, që të bën kriminel ose viktimë të krimit.

Tashmë kishim dalë nga uji por kishim ngecur ne llucen e kënetës dhe mezi leviznim.



Në atë moment mu duk sikur tytat e pushkëve të “armikut” që tashmë ishin vetëm 5 metra larg meje më kishin vënë në shënjestër.

Por mbas pak, u përmenda dhe në vënd të armikut, pashë fytyrat e shokëve të mij që më prunë në vehte. Ata po buzëqeshnin duke përgëzuar Beson që mbante në duar “flamurin e vdekjes” Kjo shënonte fitoren mbi armikun dhe fitoren mbi vdekjen.

Komandanti u bë i gjallë dhe thirri :

- Ju lumtë! Misioni ynë u realizua me sukses. Armiku u dorëzua.

Më pas dha komandën.

- Toga në një rresht mblidhu! Majtas ktheu!

Ne po dridheshim nga të ftohtit. Pa pritur, përpara nesh u çfaq gjenerali. Komandanti tha komandën:

- Gadi tu! Shoku gjeneral, toga e zbulimit e kreu me sukses detyrën luftarake.

Gjenerali na u afrua, vuri re në ç’gjendje ishim dhe mesa duket, i thirri mëndjes që rrezikonte tashmë vërejtje dhe jo lavdërime nga shtabi i përgjithshëm. Prandaj mbasi na përgëzoi për kryerjen me sukses të detyrës luftarake, dha urdhër që të na furnizonin me geta dhe të brendshme të reja, që të ndizeshin të gjitha sobat për tu tharë e për tu ngrohur, të na përgatisnin çaj dhe të na jepnin aspirina.

U këthyem menjëherë në kapanon për tu ndëruar dhe për të tharë rrobat. Të nesërmen konstatuam që fitorja jonë

kishte qënë si “fitorja e Pirros.” Gati gjysma e efektivit të togës mori të ftohur dhe disa kishin edhe temperaturë.

Mua më kishin zënë ethet dhe e ndjeja që po më merte gripi. Fatmiri mu afrua dhe më tha:

- Mbulohu mirë se ka rënë gripi Indonezian.

Llëri që nuk ishte ndier nga të dridhurat më në fund i erdhi zëri:

- Vallahi po qe lufta kështu, keq e kena.
- E çfarë do bësh Llëro, veç me u dorëzu ke armiku. Ti na mbajte gjithë atë fjalim, kur kishim stërvitjen e taktikës - i tha Genci
- Po ashtu e desh ai, komandant Gjini, që nuk dinte as me notu.

Gjenerali ishte i merakosur për shëndetin tonë, veçanërisht për Tolin, Gencin dhe Etlevën. Dërgoi një infermiere për të na vizituar. Morëm të gjithë aspirinë. Nja dyve ju bënë edhe pelicilinë në tule.

Të nesërmen na bënë mësim teorik në klasë dhe nuk dolëm në stërvitje.

Në mbrëmje u mbledhëm pranë menciës dhe, si për natë, filluan barcaletat dhe këngët.

*Kanë kaluar 55 vjet, por kjo mbetet stërvitja ushtarake që nuk më hiqet nga mendja akoma. Mu duk vetja sikur kisha marrë pjesë në një betejë të vërtetë, dhe gjatë kësaj stërvitje kuptova marrëzinë e luftës. Shpesh i bëj pyetjen vetes. Përse ekziston akoma lufta, dhe përse njerëzimi nuk është në gjendje ta eliminojë. Përgjigjen e gjej tek kënga e mrekullueshme e Xhon Lenon*

*“imagine” dhe mendoj se njerëzimi ka akoma shumë për të bërë, për të realizuar ëndrrën e Xhon Lenon. Uroj që të reflektojmë së bashku e ta këndojmë së bashku :*

<https://youtu.be/VOgFZfRVaww?si=mTtCBZDlAxLgJ2gi>

*Ndoshta, po ta këndojmë të gjithë, forca e kësaj kënge do të triumfojë mbi të keqen, bota do ta kuptojë marrëzinë e luftës dhe do ta ndaloj atë.*

*Imagine all the people*

*Living life in peace..*



*Diviakë 1970*

## **Zona e minuar.**

**E**shtë data 14 maj 2025. Disa ditë më parë, kisha takuar shoqet dhe shokët e fakultetit dhe atë mbrëmje po pija një gotë birrë me Gencin. Si zakonisht në këto raste takimi, mendimi shkon në vitet tona të rinisë. Jo pa qëllim bisedën e hodha tek libri që po shkruaja dhe kujtuam një episod të ri, të pa shkruar deri në atë moment i cili së bashku me gotën e birrës, na e ndezën humorin e asaj mbrëmje.

Ishte java e parë e janarit të vitit 1970. Komandant Gjini na kishte çuar përsëri në fushën e stërvitjes taktike. Atë ditë ditë kishim stërvitje xheniere. Këtë rradhë do të na shpjegonte përdorimin e granatave të dorës dhe të minave. Kishte marrë me vete edhe një “metal dedector” për të na spjeguar si duhet ti diktonim minat dhe si duhet ti shmangnim ato. Bile kishte në program



edhe një demonstrim praktik për dizaktivimin dhe shpërthimin e minave anti këmbësorë dhe anti tanke. Qëndronim të ulur mbi rërën e bregut të detit pranë pyllit me pisha dhe fillimisht, po ndiqnim me shumë interes

leksionin, por mbasi kaloi rreth gjysëm ore, ndjeva që po më merte gjumi nga monotonija e të folurit të Gjinit. Më në fund Gjini e përfundoi pjesën teorike të leksionit, na ndau në grupe, çdo grup ishte i pajisur me nga një minë antitank të dizaktivizuar dhe 2 lopata xheniere. Grupi ishte i formuar nga 5 veta. Efektivi i grupit tonë ishte ai i qitjes me top. Unë isha në grup me Fatmirin. Ximin, Nerin dhe Beson

U nisëm më drejtim të pyllit kur dëgjojmë zërin e Gencit:

- O Tito jo andej se është zonë e minuar,
- Po çfarë thua Genco, sapo e morrëm urdhërim për ta minuar ne zonën.
- Po mor po, por janë minuar 2 ditë më parë me Mina anti këmbësore të tipit BF-70.

Të them të drejtën nuk morra vesh gjë. Genci ishte natyrë e qeshur dhe gjithmonë lëshonte ndonjë batutë dhe bënte shaka, kështu që askush nuk i besoi fjalët e tij. Skuadra jonë i hyri me vrull punës që të merte lavdërimet e radhës nga Gjini. Neri me Fatmirin morën lopatat xheniere dhe filluan të gërmonin. Pa pritur u përhap një erë e keqe si erë fekale. Lopatat ishin ndotur bile Neri edhe e kishte shkelur me këmbë dhe vrapoi që ta lante këpucën në det. Edhe nga grupi fqinjë u dëgjuan të shara. Llëri ishte më i revoltuari i togës dhe filloi të shante “me libër shtëpie” Mesa duket kishte shkelur ndonjë të madh, mbasi vrapoi drejt detit, hoqi këpucët dhe filloi të lante edhe pecat.

- Genco po ti fol shqip o burrë, kjo nuk osht minë. Ne anej nga katuni jonë i thona drejt, shkurt, qartë ..”m\*t” ene i madh bile. Kjo osht mo keq se mina.., ngjit ene nuk pastrohet për qamet. Bjeri drejt muhabetit o Genc, jo po mina BF-70.. e futja në pordhë.
- Llëro, pavarësisht si e quaj, unë të paralajmërova për rrezikun por ti kujton se boj shaka.
- Po ti gjithmonë bon shaka Genco. Na je bo si puna e atij bariut të cilin nuk e besonte mo njeri ene kur i ra ujku ndër dele.

E di atë?

- Hë
- Nji bari lojçak, si puna jote, një ditë thërret me zë të lartë:

*“ O fshat, ka ra ujku ndër dele ”*

*Fshatarët, që punonin në arë, lanë punën dhe vrapuan të ndihmonin bariun, Kur arritëm tek delet bariu filloi të qeshte :*

*- Ha, ha ha, e hongrët ëë.. po kjo ishte lojë.*

*Një ditë tjetër ujku ra me të vërtetë nder dele. Bariu filloi të thërriste” O fshat, ndihmë, ka ra ujku ndër dele!”*

*Po asnjë nga fshati nuk e besoi.*

*Kështu ene ty nuk të beson më njeri se gjithmonë bon shaka.*

- Meqë nuk më besoni, shkelni në m\*t atëherë – ju përgjegj Genci në mënyrë të prerë.

Unë hodha një vështrim për rreth. Pamja ishte vërtet e çuditëshme. Të dukej sikur kishin mbirë kërpudhat në

mes të dimrit. Sa më thellë futeshe në pyll aq më të freskëta ishin. Dukeshin edhe nga ngjyra që kalonte nga e zezë në kafe e deri në të verdhë të kuqërremtë. Më kujtohet që atë ditë filluam të shanim Gencin.

- Ti që na dhe alarmin, një gjë e di.
- Po jo or çuna nuk i kam bërë unë. Edhe sikur ta bëj 7 herë në ditë, nuk mundet të mbush një pyll të tërë me fekale. Po të kishit qënë më të vëmendshëm do ta kishit vënë re edhe ju.
- Atëherë nga e di ti që e kanë minuar 2 ditë më parë.

Genci nuk foli. E kuptoi që kishte folur më shumë se ç'duhej dhe tani duhej të gjente një justifikim. Prandaj ndroi bisedë dhe ju drejtua Gjinit:

- Komandant a të kërkojmë ndonjë vënd më të pastër.

Gjini ishte bërë “xhind”. I ishte prishur stërvitja.

- Do lajmëroj komandën - tha- që të venë roje në gjithë këtë zonë. Kjo është zona ime e stërvitjes taktike dhe jo nevojtoe në natyrë.

Nuk mbaj mënd se çfarë ndodhi më vonë.

Më kujtohet vetëm që komandant Gjini na e spostoi vendin e stërvitjes afro 1 km më poshtë.

Duke pirë birrë, atë mbrëmje, Genci më tregoi për herë të parë historinë e plotë të “zonës së minuar”. Dy ditë përpara stërvitjes xheniere, mbas darke kishte kaluar nga banjat e repartit për të bërë “ të madhen”. Banjat i kishte gjetur shumë të pista aq sa nuk afroheshe dot. Vendosi që atë natë ta bënte “ në natyrë”. Ishte futur brënda pyllit me pisha dhe kishte filluar shkarkimin. Nuk kishin

kaluar as 2 minuta kur dëgjoi zëra. Një grup vajzash po afrohej duke qeshur. Genci u befasua dhe qëndroi pa lëvizur.

Vajzat nuk e bënë të gjatë dhe filluan të zbërthenin pantallonat dhe më pas bollkat e bardha, të cilat bënë pjesë në pajisjet dimërore të zborrit, ishin si brekushe të gjata me ushkur. Mesa kuptohej ju dukej vetja sikur ishin në shtëpinë e tyre. Procesi i këtij spektakli “striptis”, pra ishte i gjatë meqë duhej të zbërthenin rrypa e ushkurë. Ndërkohë që ato zbërthenin dhe ulnin të brendshmet, Gencin e zuri turpi. Vajzat i konsideronte si motra dhe nuk deshte ta shikonte pamjen që do të vinte më pas. Menjëherë zuri sytë me pëllëmbën e dorës së djathtë duke penguar shikimin, por kurioziteti e mundi turpin. Gishti i mesëm dhe ai tregues u hapën dhe Genci u befasua nga pamja që u ju hap para syve. Në errësirën e natës, u çfaqën pa pritur një seri topash të bardhë të rrumbullakët, njëri më i bukur se tjetri që theksonin në errësirën e natës. Mbase mbaruan punë vajzat u ngritën në këmbë u mbërthyen, u rregulluan mirë e mirë dhe u larguan duke qeshur e me mendimin që ja kishin hedhur edhe asaj rradhe.

- Kështu Tito historia e kampit të minuar. Mesa kuptova vajzat e bënë atë punë çdo natë. Duket që kishin merak nga banjat e pista të repartit. Ajo pjesë e pyllit ishte bërë banja e tyre private dhe çdo natë spostoheshim në një zonë të pa ndotur më në brendësi të pyllit.
- Mirë Genco, po një gjë nuk kuptova.
- Hë

- Ato minat BF-70 çfarë ishin?
- Po pra Tito, ishin prodhimet e tyre. BF është emri i firmës prodhuese pra “ B\*thë Femre”, kurse 70 tregon vitin e prodhimit pra 1970.

Filluam të qeshnim së bashku.

- E bukur Genco, do ta shkruaj në libër.
- Tito lere, mos shkruaj gjë. Mos na turpëro me këto histori të vjetra.
- Genci, nuk ka asgjë për tu turpëruar – i thashë – turp mund të kishin ato që e bënë në natyrë. Pastaj se mos i shihje vetëm ti. Ti u ndodhe rastësisht në një vënd të gabuar dhe në një kohë të gabuar. Po ushtarët e repartit, që ju ishte bërë syri bakër?.. A e di ti që mund të kishte edhe ndonjë maniak seksual që i linte apostafat banjat e pa lara. Pastaj spektaklin e tyre e ndiqnin edhe kafshët e pyllit bile edhe bufi i kënetës...
- Po rri o Tit mos na kujto bufin tani (shim vetëm 2 ditë mbas zgjedhjeve)
- Dëgjo Genci, Kanë kaluar mbi 55 vjet nga ajo ditë, gocat janë bërë gjyshe dhe po bëhen plaka, kurse ti ke turp tja kujtosh bukurinë femërore të rinisë së tyre. Jam i bindur që ato kanë qejf që tja kujtojmë dhe tja përshkruajmë. Pastaj, më fal, po ku e di ti që ishin gocat tona xhanëm, mundet të ishim ato të “Gjuhëve të huaja”. Genco hiqe mëndjen dhe ma ler mua në dorë se e qëndis unë.
- Mirë o Tit, shkruaje, vetëm mos e bëj shumë banale. E di çke ti, lere ta vendosim nesër. Nesër do

takojmë “vajzat gjyshe” dhe të shohim çfarë do të thonë ato.

Më pëlqeu epiteti “Vajzat gjyshe” që ju vuri gocave të kursit. Vërtet, me gjithëse ishin bërë gjyshe , në kujtimet tona mbeteshin vajza të reja.

*Të nesërmen në drekë, u takuam me “vajzat gjyshe” dhe në bisedë e sipër , njëra prej tyre kujtoi edhe shkarkimin në natyrë e në ajrin e pastër që vinte nga deti.*



*Divjakë 1970*

## **Qitja me top**

Në dispozicion të stërvitjes së togës ishin vënë topa 76 mm dhe 100 mm.

Toga jonë ishte ndarë në skuadra me nga 5-6 veta seicila në vartësi të topit që do të kontrollonim. Unë kisha detyrën e graduesit, duhet të vendosja vlerat e koordinatave që vinin nga stacioni radarëve, veç kësaj kishim edhe shënjuetin, dy mbushës të topit me predha dhe një komandant topi që mbante një flamur në dorë të cilin e përdorte për të dhënë shenjën e komandës “zjarr”. Komandanti lidhej gjithashtu me qendrën e radarëve për të marrë të dhënat e gradimit të topit dhe priste nga ne përgjigjen për zbatimin e komandave. Ne ishim të detyruar që mbas çdo komande të komunikonim zbatimin e urdhrin.

Mbas shumë ditësh stërvitje, erdhi dita e shumëpritur e qitjes me top. Komanda e repartit e kishte përgatitur terenin. Qitja këtë radhë bëheshe me predha luftarake dhe objektivi ishte real. Një avion i vogël i telekomanduar tërhiqte nga pas një pëlhurë të ngjurosur me rrathë, ku ishin shënuar numurat 1 - 10, që do të

tregonin edhe vlerësimin e qitjes tonë. Kishim në dispozicion një arkë me predha. Komandanti dha komandën:

- Skuadra, para topit! Gaditu! Pozicion luftimi merr!

Zumë menjëherë pozicionet tona pranë topit. U dëgjua komanda:

- Top mbush!-

Mbushësit tanë Neri dhe Ximi, lëvizën me shpejtësi.

I pari nxori predhën nga arka dhe i dyti e futi në top.

Duke dhënë përgjigjen:

- Mbushja gati.
- Azimuti ..45 !- urdhëroi komandanti.

Unë lëviza me shpejtësi levën e graduesit të këndit të Azimutit. Dhe u përgjigja:

- Azimuti 45!
- Tokësori 63! - Vazhdoi komandanti.

Nuk vonoi përgjigja:

- Tokësori 63 nga Fatmiri.
- Zjarr! - thirri komandanti dhe uli poshtë flamurin.

Shënjesi jonë Beso, centroi objektivin dhe shtypi pedalën e shkrepjes. Roli i shënjesit ishte kryesori në qitjen me top. Beso, ishte i shkathët dhe qëllonte mirë në objektiv. Ishte pra jo vetëm “ Sy pushke por edhe “ sy topi”

U dëgjua zhurma e qitjes. Mbushësit që e dinin mirë detyrën, kishin bërë gati predhën e dytë. Dhe më pas dëgjonim vetëm :

- Mbushja gati!
- Zjarr!

.....

- Mbushja gati!
- Zjarr!

Kur arka me predha u boshatis, komandanti dha komandën:

- Zjarr ndalo!

Ktheva kokën dhe pashë mbrapa meje Nerin dhe Ximin të djersitur dhe me fytyra të nxira nga tymi i predhave. Pluhuri i zi i barutit të djegur ju ishte ngjitur në djersën e fytyrës.



Komandanti dha komandën:

- Skuadra para topit rreshtou!

U vumë në rresht dhe po prisnim rezultatin e qitjes. Komandanti, mbasi u lidh në telefon me qendrën e vëzhgimit, erdhi pranë dhe na përgëzoi:

- Shkëlqyeshëm çuna, kemi 75 pikë. Deri tani jemi të parët

Ne u hodhëm përpjetë dhe filluam të përqafojnë njëri tjetrin. Ishte vërtet një sadisfaksion i jashtëzakonshëm.



*Divjakë 1970*

## **Kënga e Dashurisë.**

**R**ezultatet e larta të stërvitjes, vendosëm ti festonim. Ramë dakord që mbas darke të këndonim me kitarë. Bashkë me ne, në këtë repart ushtarak, zhvillonte zborrin edhe shkolla e gjuhëve të huaja të Tiranës. Ajo që binte në sy në grupin e gjimnazistëve ishte një vajzë shumë e bukur, brune, e gjatë me sy shumë tërheqës. Bukuria e rrallë e saj, kishte goditur rëndë Beson, shokut tim të kabanonit dhe qitësin e dalluar të topit.

Beso dilte gjithmonë i pari në stërvitje dhe nuk përkulej përpara vështirësive por përpara kësaj bukurie, ishte i pa fuqishëm. Përveç bukurisë fizike, vajza kishte edhe zë të bukur dhe këndonte me shumë pasion. Kjo dhunti ja shtonte prezencën gjatë grumbullimeve tona të mbrëmjes, dhe kishte fituar simpatinë e shumicës prej nesh, ndërkohë që Beso, po vuante një dashuri platonike për të dhe nuk e hiqte dot nga mendja. Fliste shpesh me vehte duke psherëtitur:

“Ah. ...”

Më kujtohet që atë mbrëmje vajza na këndoi këtë këngë:

*“Një djal i ri o me kitarë,*

*Po i këndon vajzës Korçare...*

*Të vegjël ishim kur u takuam*

*Brenga nuk kishim, u dashuruam....”*

Beso rinte i shtangur. Unë e pashë keq dhe i fola:

- Beso, largoje mendjen se nuk është për ty. Rreh lart ajo.

Ndërkohë kënga vazhdonte :

*“Vajto kitarra ime vajto ti shpresën time, vajto ti shpresën time, që iku dhe më la.”*

- Nuk e dëgjon që po ta thotë edhe me këngë “vajto ti shpresën time që iku dhe më la.”
- Nuk e ka me mua, është kënga ashtu Titi, Unë nuk e heq dot nga mëndja. Sot nuk kam pirë as çajin e darkës sepse dua që ta shoh edhe në ëndër.
- Çfarë lidhje ka çaji këtu.
- Po nuk e ke parë ti se çfarë ere i vjen çajit. Seç i hedhin një pluhur të bardhë brënda që është kundër “ëndrrave të lagura”. Duket si sodë buke, po kushedi se çdreqin është.
- Beso, hiqe mëndjen e mos bëj marrëzira.

E ndërpreva bisedën me Beson sepse shokët prisnin këngën time. Morra kitaren dhe fillova me disa këngë të muzikës sonë të lehtë. Mbasi këndova disa këngë ritmike, vazhdova me një këngë të Anita Takes

*“Në bankat e shkollës o mike,*

*dy emra ç'i gdhendëm dikur,*

*Por unë nuk e di si më ike,*

*Dhe zemrës I vura një gur...*

*Ne u ndamë në errësirë..”*

Beso këndonte bashkë me mua duke ju drejtuar vajzës:

*“Ne u ndamë në errësirë, jeta ndarje ka*

*Porse zemra lamtumirë, zemrës nuk i tha.”*

Vajza, për mirësjellje na u afrua dhe vazhdoi këngën me ne. Mbas këngës u larguam në drejtim të kapanonit. Errësira kishte mbuluar gjithçka. Beso vazhdonte këngën:” *Ne u ndamë në errësirë.. “*

***Këto ditë, mbas 50 vjetësh e regjistroi këtë këngë në you-tube.***

<https://youtube.com/watch?v=U3o6oqZYt-0&feature=shared>



*Rapi i Trishit 1972*

## **Me vajzat në regjimentin e ndërlidhjes**

Shokët e grupit të radioelektronika 74, më kujtojnë vazhdimisht që të shkruaj diçka për zboret ushtarake ku ishim prezente edhe shoqet tona të kursit.

Ishte data 30 Tetor 2024. Ndodhesha në Tiranë dhe Genci më ftoi për darkë. Bashkë me mua kishte ftuar edhe vajzat e kursit. U takuam me Ilirën, Etlevën dhe Tenkën.

Biseda me to e bëri të natyrshme shkrimim e këtyre kujtimeve.

Më kujtohet zborri i vitit 1971. Po e bënim pranë regjimentit të ndërlidhjes tek rrapi i trishit.

Zakonisht vajzat tona, Tenka, Ilira, Etleva, Alma, Tamara, Shpresa dhe Pavlina qëndronin në grup edhe sepse, shpesh, kishin biseda femrash.

Por atë natë kishin futur në mes edhe një mashkull. Vura re që ishte një djalë i ri dhe shumë i pashëm. E qeshura e tij më krijoi bindjen që duhet të kishte edhe zë të bukur. Po kush do të ishte vallë? Unë kisha marrë kitaren në dorë dhe po këndoja Çelentanon. Çunat, që e kishin qef, filluan të këndonin bashkë me mua:

*“Questo e la Storia di uno di noi...”*

Këndoja me forcë dhe pasion që të tërhiqja edhe vëmendjen e gocave, por ato vazhdonin bisedën me djaloshin, dhe nuk ja vinin veshin këngës sime. Kjo skenë më është kujtuar shpesh edhe këtu në Itali, kur në televizion mediaset “canale 5”, shikoja programin “Beato tra le donne”. Në këtë program, i ftuar ishte një djalë i pashëm ndërsa një grup vajzash të bukura i bënë shoqëri. Tashti që po shkruaj mendoj që ai djalosh ishte vërtet “ një i bekuar në mes të vajzave”

- Dori, do të na këndosh ndonjë këngë? – I tha Ilira djaloshit.
- Nuk e kam kitarën këtu.

E kuptova që kishte ardhur koha të më merrnin edhe kitarën, kështu që vazhdova pa ndërprerje me shpresën që nuk do të ma ndërprisnin këngën. Por mbas mbas pak, edhe kjo shpresë më la. Vajzat nuk duruan dot. Dërguan Etlevën e cila mu afrua dhe me shumë edukatë më foli:

- Petrit,.. më fal që po ta ndërpres këngën..por kemi një kërkesë.. Të lutem të na e plotësosh.

Si gjithmonë, Etleva fliste me ngadalë dhe me shumë delikatesë por unë bëra sikur nuk kuptoja :

- Hë çfarë kënge doni që tju këndoj.
- Po jo,.. nuk është fjala për këngë, ..Petrit.
- Po për çfarë?
- Po ja, ..sikur të na i japësh pak kitarën..po brënda mundësisë ama.

Unë nuk i rashë asaj ane dhe bëra sikur nuk kuptoja.

- Etleva, unë e di, që asnjëra nga ju nuk i bije kitarës.
- Po.. Petrit, por i bije ai shoku jonë.
- Etleva, ti e di që unë kitarën nuk ja jap asnjërit.  
Merre, po të keni kujdes mos më këputi ndonjë tel.

Mënyra e sjelljes me edukatë dhe delikatesa e të folurit të Etlevës më ç'armatosën dhe ma morën kitarën nga duart.

- Faleminderit shumë Petrit dhe mos ki merak fare.

Të them të drejtën, nuk më erdhi mirë që ndodhi kështu.

Edhe çunat u mërzitën.

- Tito, kush është ky bandill, që vjen e na bën ligjin këtu tek ne - foli Apostoli i revoltuar.
- Ooo.. më duket se e njoh, e ka shtëpinë ke Medreseja – shtoi Maksi. Më von morëm vesh që e quanin Dorian, ishte një talent i ri ne muzikën shqipëtare. Po atë vit konkuroi në festivalin e 11 të këngës në Radio – Televizion me këngën e Cesk Zadesë “Erdh’ një djalë në fshatin tim.(Shoqja më e mirë)”

<https://youtu.be/70ooZb9eZ80?si=859tUvdDmRU7AHLN>

Doriani, kishte repertorin e tij , që përshtatej me zërin dhe intonacionin e tij muzikor. Kishte zë të plotë dhe të ëmbël. E dëgjoja me kureshtje dhe, pa e kuptuar më lindi një ndjenjë xhelozie, jo vetëm që këndonte bukur por edhe sepse kishte fituar simpatinë e vajzave. Mezi po

prisja sa të mbaronte këngën dhe të rimerja kitaren në dorë. Kur erdhi ky moment, krijova një la-minor në kitarë për të kënduar këngën më të re dhe më të famshme në hit- paradin e Italisë. “Pensieri e parole” të Batistit.

<https://music.youtube.com/watch?v=34WsjareGnc>

*“Che ne sai di un bambino che rubava.*

*E soltanto nel buio giocava..... “*

Refreni i këngës shpërtheu me forcë, dhe dëgjova zërin tim që oshëtiu në qetësinë e mbrëmjes:

*“Davanti a me c'è un'altra vita*

*La nostra è già finita*

*E nuove notti e nuovi giorni*

*Cara, vai o torni con me*

*Davanti a te ci sono io (dammi forza, mio Dio)*

*O un altro uomo (chiedo adesso perdono)*

*E nuove notti e nuovi giorni*

*Cara, non odiarmi se puoi”*

Prezenca e Dorianit i dha forcë dhe pasion këngës dhe interpretimit tim.

Mbasi u largua , erdhi momenti i barcaletës. Llëri atë natë kishte zgjedhur barcaleta jo shumë pikante, të cilat mund ti tregonte edhe në prezencë të vajzave.

- Ishte njoni që i merrej goja - filloi tregimin Llëri.
- Si puna jote Llëro - e ndërpreu Pëllumbi.

- Jo mu më merret pak, atij i merrej aq shumë sa i ngatarronte fjalët dhe e bote fjalinë lomsh.

Llërit shpesh i merrej goja vërtet, kështu që tregimi i barcaletës doli i përsosur:

- Ene qi thoni ju, i ishte ça hunda për dahon të shkretit. Shkoi në një kinkaleri dhe i tha shitëses:

*O shoqe më jep një ppp*

*...pullë poste.”*

Në vend qi me thonë “paqet Partizoni” i tha “pullë poste”. U turpnu i shkreti dhe majti rradhën për së dyti. U afrua tek banaku dhe ju drejtua shitëses:

*“O shoqe më jep një ppp..pp”*

*“Po fol or shok, fol!”*

*“Një ppp...pullë poste.”*

Tak, shitsja pullën e postës në dorë dhe ju bonë 2 pulla.

Ky u bo keq, doli nga dyqani e filloi tu përsërit me vehte:

*“ppp..paqet Partzan, ppp..paqet Partizan..”*

Kur e mësoi mirë përmendësh hyri me vrull në dyqan dhe tha:

*”shoqe një ppp..paqet Partizan”*

Shitësja diçka po rregullonte nën banak dhe nuk e dëgjoi.

*“Çfar..?”*

*“Një ppp..pull poste”*

Tak shitsja pullën e postës.

Ju bon 3 pulla poste dhe që atë ditë e la dahonin, sepse nuk dite me e ble.

- Morali i barcaletës? – E pyetëm ne.
- **Mos pini dahon në zborr.**
- Ilir , po ja fut kot tani, çlidhje ka barcaleta jote me zborrin - i tha Ilira.
- Nuk e di, kom një parandjenjë të keqe.
- Leri parandjenjat tani, po e di ç’ke ti?
- Hë Ilira.
- Me që na kujtove duhanin, na jep një cigare.
- Pse a pi macja uthull?
- Po çke mo ti, ma ndiz një se do të shkoj ta pi në banjë.
- Cigare Partzani nuk mbaj sepse jom me Tironën. Po të jap një Gent me filtër. Këto jon cigare për femna. Ki kujdes vetëm se jon cigare kontrabandë. Thonë që i ka qit deti. Osht mytë një anije plot me Malboro dhe me Gent dhe cigaret e kon mush plazhin nga Durrësi e deri në Kavajë. Mu mi kon fal nja dy steka.
- Po ç’më duhet mua o Ilir. Edhe unë kontrabandë do ta pi, - tha Ilira, që e ndezi dhe mori të shkojë për tek banjat e regjimentit.
- Lira, pie këtu më mirë se je më e mbrojtur.
- Mos u bëj merak Ilir se nuk më ndodh gjë.

Ne vazhduam bisedën. Llërit që i rrinte mëndja tek duhani filloi të na tregonte:

- Vallahi për cinare nuk qahem. Ene Toli ene Genci më kanë pru gjithmonë cinare të mira. Mbaj mend një herë kur Toli më bjeu një stekë me cinare “zuez” dhe ma dha mçeftas. Unë e falenderova dhe i thashë “Sokol të rosh sa kodrat” dhe ai filloi të qeshë.

Genci e pyeti:

- Po pse sa kodrat dhe jo sa malet Llëro?
- Malet janë zonë. Të na rrojnë baballarët sa malet.

Ne filluam të qeshim. Unë mendova se e kishte vetëm me Tolin, mbasi të gjithë uronin “të rrojë sa malet shoku Enver”, mirëpo Llëri vazhdoi:

- Mos qeshni hiç. E di që e keni maru shkëlqyeshëm gjimnazin, por që jemi të gjithë bashkë tek dega e radios, kjo osht ene meritë e baballarëve tanë që janë njerës të nderum pranaj uroj që ata të na rojnë sa malet.
- Po Llëro, fjalë me vënd - i tha Apostoli dhe vazhdoi:
- Dua të recitoj për baballarët tanë pjesë nga kjo poezi e bukur e Dritëro Agollit që e kam pasur temë provimi në gjimnaz. Më pas u ngrit në këmbë dhe filloi recitimin:

*“Në shpate ngjiti e nga shpatet zbrisni*

*Të hollë si kosore e jataganë;*

*Kutitë hapni e çibukët ndizni ,*

*E gjunjët çlodhni, baballarët tanë !*

*Ju shpien udhët në ara e qytete  
Dhe s'prehi kurrë e s'rrini kurrë,  
Po gjithnjë kërkoni nëpër jetë,  
Godisni me çekanë e mbillni grurë;*

Vura re që apostolit i merrej zëri nga  
emocioni, por nuk e ndërpreu recitimin:

*...Kjo zhurmë e erë pa gjumë ju lë natën ,  
Se hapin tonë ndiqni, rrini pranë;  
Të bardhat koka tundni buzë vatrës:  
“ Të fortë dolën bijtë tanë!”*

*Eh , baballarë, kjo vatër ne na polli,  
Këta thëngjij të kuq na mbajtën nxehtë,  
Ky lesh velenxash trupin na mbështolli ,  
Ky prag na nisi udhëve në jetë.*

*Në dejtë tanë gjaku juaj ecën  
I nxehtë, si në motet tuaj rinorë,  
Kur vriteshit me plumb për të vërtetën  
Në brazdat e në malet me dëborë.*

*Ju baballarë, keni djem të mirë,  
Se ëndrrat i bashkuam në një ëndërr,  
Se grurin tok e kemi shirë,  
Ndaj njëri-tjetrin nuk e shohim vëngër*

*Dhe kur dikush, këlysh mikroborgjezi,  
Me petkun progresiv na vjen vërdallë  
Dhe sherrin etër-bij kërkon të ndezë,  
Ia shkulum dhëmbë edhe dhëmballë...”*

Në grup kishte rënë qetësia, të gjithë dëgjonin me kureshtje këtë poezi të pavdekshme. Apostoli e recitonte me pasion duke i dhënë peshë fjalës dhe tonalitet vargut:

*“U plakët, baballarët tanë, u plakët!  
Ndonjë prej jush mbyll sytë ndaj të gdhirë  
Dhe pranë vatrës prushin lë dhe flakën ,  
Çibukun dhe duhanin e papirë.*

*Dhe ne lexojmë ndër nekrologjitë,  
Rrethuar me korniza emrat tuaj,  
Dhe heshtim për një çast të trishtë,  
Mbi torno, diga, libra, duaj....*

*Dhe ne u bëmë baballarë, baballarë!*

*Dhe gjaku i përcjellë nga epoka  
Tek bijtë, le të rrjedhë në damarë  
Që pulsën si çekan ta ndiejë toka!*

*Dhe bijve tanë u themi ashpër :  
Kërkoni , bij, e ndeshuni në jetë  
Dhe çani rrugë të mëdha shpirtpastër ,  
Siç çanë baballarët tuaj të rreptë,*

*Dhe mos harroni kurrë baballarët,  
Që maleve të ritë e tyre lanë,  
Që qenë mes betejave ushtarë  
Dhe erdhën me lirinë në Tiranë”.*

*Dhe shkojnë motet , bën të sajën koha,  
Ju plaki edhe kërrusi si kosorë,  
Po para nesh ju ngrihi si epoka ,  
Fisnikë ,  
madhështorë! “*

Vazhdonim të rrinim të shtangur. Piroja u përmënd i pari dhe filloi të duartrokiste. Kisha qënë disa herë në shtëpinë dhe e dija që e deshte dhe e respektonte shumë të jatin. Mbas tij filluam të duartrokasim edhe ne të tjerët.

Poezia na e kishte marrë aq shumë mëndjen, saqë nuk vumë re që pranë po kalonte komandant Hakiu, që ne i thërrisnim shkurt “Kiu”

- Kiu Kiu.. - Dha alarmin Pëllumbi. Ne i fikëm cigaret, dhe bëmë sikur s’e pamë.
- Obobo Ilira - tha Llëri - e kapi më duket.

Hakiu u afrua tek banjat e vajzave. Era e duhanit ndihej që nga jashtë banjave.

Ilira doli nga banja pa menduar se çfarë e priste.

Siç kujton ajo vetë, tersi e ndiqte në çdo hap. Edhe këtë radhë nuk i shpëtoi dot.

- Ushtare Sh. ndal, ku shkon. Përse ke pirë cigare në repart.

Ilira në fillim u befasua, mbasi nuk e priste që ta ruanin edhe mbas derës së banjës por, nga ana tjetër, nuk mund ta mohonte, mbasi era e duhanit ndihej deri larg dhe tymi i bardhë dallohej në errësirën e mbrëmjes.

- Shoku komandant, mendova që banja është ambient privat dhe jo publik dhe nuk jemi në stërvitje por në kohën e lirë.
- Urdhëri është që mos pihet duhan në të gjitha ambientet dhe në çdo kohë. Këtu nuk je në shtëpinë tënde, por në repart ushtarak, pranë karburantit dhe depove të municionit. Kjo cigarja jote mund të na hedhë në erë të gjithëve.

Për këtë shkelje të rregullores do të marrësh dënimin që meriton, do të propozoj që të të shtyhet zborri edhe 10 ditë të tjera. Tashti shko bashkohu me grupin.

Ilira, që ja dinte kokën Kiut, nuk e zgjati më shumë dhe u afrua tek ne. Llëri e pa të mërzhitur dhe i tha:

- Ene ti o goce, më je bo si gruja e Nastradinit, më je bo. A e dini atë të gruas të Nastradinit?
- Hë - i thamë.
- E pysin Nastradinin:
- *“ Si osht e mundur që ti Nastradin i di dhe i parashikon të gjitha gjërat ”*
- *Osht e thjeshtë.., pyes gruan.*
- *Po pse kaq e zonja është gruaja jote....*
- *Edhe pastaj bëj të kundërtën e asaj që thotë gruaja. Më del gjithmonë.*

Ne filluam të qeshim, ndërkohë që Llëri vazhdonte barcaletën:

- *Po gruaja jote Nastradin?*
- *Edhe ajo bën të kundërtën e asaj që i them, Prandaj nuk më pyet më.*

Ne vazhduam të qeshurën.

- Po rri mo Ilir se as ti nuk je Nastradini dhe as unë jam gruaja e jote - i tha Ilira.

E qeshura që pasoi sikur e ndryshoi pak atmosferën.

- Morali Llëro, Duam moralin.
- **Meqënëse una nuk jom Nastradin atëherë Ilira ka “qimen e derrit”.**
- Llëro po ja fut kot më duket - i tha Apostoli.
- Kjo është e vërtetë - tha Ilira - tersi më ndjek gjithmonë.

Vajzat u munduan ta qetësonin Ilirën.

- Mos u mërzit i tha Tamara, nuk ka për të ndodhur asgjë. Ai vetëm kërcënon. E me kë do ti bësh 10 ditët shtesë ti, me ushtarët e repartit? Këtu nuk ka asnjë femër.
- Eee.. - ja bëmë ne dhe filluam të qeshnim - e ku do të të vënë të flesh Lira?

Etleva, shoqja më e afërt e Ilirës, dhe shoqja më e sinqertë e grupit, besonte lehtë në ato që thuheshin. Kur dëgjoji që donin ta ndanin nga shoqja e saj, u temb dhe tha:

- Uaaa.. po unë si do të le ty vetëm?

Genci e kishte gati batutën:

- **Veç po fjeti në një krevat me ty.**
- Iii sa budalla, po unë e kam si motër mo.

E qeshura jonë vazhdoi:

- Eee.., Çuna u bënë dy. Kiu me një të shtënë, na i la të gjitha vajzat në zborr më duket. Hajde, ka ndonjë vullnetare tjetër?

Kiu, që vazhdonte të vinte vërdallë e kuptoj që po flisnim për të, dhe ndoshta, mendoi se po e tallnim. Atëherë, u afrua dhe urdhëroi Pëllumbin që ta fuste togën në kaponon.

- Shoku komandant jemi akoma në orarin e pushimit.
- Duke folur me zë të lartë, po prishni pushimin e të tjerëve. - Vazhdoi Kiu duke na e ngrirë të qeshurën në buzë.

Atë natë radhën e rojes së kapononit e kisha unë. Detyra ime ishte të ruaja qetësinë e kapononit, dhe të zgjoja

efektivin në rast alarmi. Isha i lodhur, më vinte gjumë dhe koka më varej mbi supe.

Kur isha në kokër të gjumit, dëgjoj një zë:

- Kiu, kiu.

U tremba , gjumi më doli dhe qëndrova gaditu.

Zëri dëgjohej akoma

- Kiu, Kiu

Ishte Gëzimi që fliste në gjumë.

Kiu, pra, nuk na u nda, na dilte edhe në ëndër. Gjumi më doli plotësisht, por mendimet nuk më lëshonin. Më rinte mëndja si duhet ti kundërviheshim këtij njeriu , që na e bëri zborrin “zborr” dhe na ishte qepur keq edhe gjatë kohës sonë të lirë.

Të nesërmen, ju thashë shokëve:

- Çuna na osht qep si morr, nuk di çfarë ti bëjmë. Genci që herë pas here enxirte ndonjë “xhevahir”, këtë rradhë tha:
- Veç po i sajtonve ndonjë këngë.
- Bravo Genco – I thashë.

Më ra ndërmend një këngë e Fausto Lealit që titullohej “A chi” e që shqiptohet “ A ki”

- Çuna, goca, I kam gjetur një këngë. Është kënga më e bukur e Fausto Lealit, që ka dalë në 1966. Duhet ta keni dëgjuar.
- E pastaj? - pyeti Tenka.
- Kënga titullohet “A chi”. Të shohim si do të reagojë

- O, e bukur kjo , do kujtojë sikur ja kemi nxjerrë atij.

Nuk e zgjata, krijova një Do# në kitarë dhe fillova ta këndoj:

<https://youtu.be/3iPjXjWKCjc?si=krEvOREtCdaoNaGz>

*“A chi sorriderò, se non a te?*

*A chi, se tu, tu non sei più qui?*

*Ormai, è finita, è finita tra di noi*

*Ma forse un po' della mia vita*

*È rimasta negli occhi tuoi”*

Për fat, viti 1971 ishte viti i liberalizimit në art e muzikë dhe këngët italiane mund ti këndonim pa problem, bile shpesh i transmetonte edhe Radio Tirana.

Forca e kësaj kënge e goditi Kiun. Ju krijua bindja që po e tallnim. Përgjonte fshehurazi dhe mundohej të kapte ndonjë fjalë nga teksti i këngës. Kur e shihte që ishte e kotë, largohej për tu rikthyer mbas pak. Mirëpo ne, atë moment ruanim. Sapo dëgjoja “Tito Kiu, Kiu.. “ ja filloja këngës:

- *Aaa Ki..ii.sorridero se non a te..*

*Aaa Ki ii...*

Kiu u skuq nga inati, Mu afrua dhe më tha:

- Ushtar Misa, lere kitarën dhe hajde me mua në shtab.
- Si urdhëron shoku komandant.

Shkuam në zyrën e tij. Fjala e parë që më tha ishte:

- Po ta dëgjova edhe një herë këtë këngë do të ta thyej kitarën.
- Shoku komandant, kjo është një këngë dashurie shumë e bukur dhe mund ta dëgjoni edhe në Radio Tirana “A ki” në Italisht do të thotë “Për kë” ose “kujt” e nuk ka lidhje me emrin tuaj.
- Këtu vendos unë dhe do të bësh si të them unë.
- Si urdhëron shoku komandant – i thashë dhe u largova.
- E Tito, ta shtoi edhe ty zborrin? – Më pyeti Genci.
- Jo, po do që të më thyej kitarën. Dëgjo Genco, këndoje ti pa kitarre, se ty nuk të thotë gjë.
- Po ku di unë ta këndoje o Tit?

Duke vrarë mendjen më lindi një ide e shkëlqyer. Shkova menjëherë në shtab dhe kërkova të flas në telefon me familjen.

Fola me babain që punonte në Radio. Më pas u ktheva, takova shokët dhe i shpjegova mendimin tim.

E djela e parë na zuri në sheshin qendror të regjimentit. Pranë nesh qëndronte Kiu të cilin e kishim ftuar të na rrinte pranë, mbasi donim ti bënim një surprizë.

Në orën 10 të mëngjesit dëgjohet melodia e hapjes së emisionit “Program me muzikë sipas kërkesave të dëgjuesve.” Programi filloi me këtë kërkesë:

*“Një grup studentësh që bën zborrin ushtarak në regjimentin e ndërlidhjes përshëndesin komandantin e tyre me këngën “A ki”*

Nga altoparlantët e repartit buçiti me forcë kënga:

*“A **chi** sorriderò, se non a te?  
A **chi**, se tu, tu non sei più qui?  
Ormai, è finita, è finita tra di noi  
Ma forse un po' della mia vita  
È rimasta negli occhi tuoi”*

Pëllumbi, që kishte më shumë kofidencë, ju afrua dhe i tha:

- Dëgjo komandant, tani na thuaj, a do ta dëgjosh nga ne apo nga Radio Tirana.

Kiu u shtang.

- Nuk ka mundësi që të jetë Radio Tirana kjo.
- A është qendra e zërit e regjimentit kjo? – E pyeti Pëllumbi.

Ndërsa Genci që ishte pranë e lëshoi batutën:

- **Veç po ta ketë lidhur komisar Gaqoja direkt me Italinë.**

***Forca e Këngës kishte triumfuar dhe që nga ajo ditë, vazhduam tja këndonim këngën Kiut.***



*Rrapi i Trishit 1974*

## **Këngët e Zborrit.**

Ishte fillimi i qershorit të vitit 1974. U paraqita tek “rrapi i trishit” ku ndodhej regjimenti ndërlidhjes për të filluar zborrin pas universitar.

Bashkë memua ishte edhe pjesa më e madhe e kursit. Mungonin ushtarakët dhe vajzat e kursit të cilët, sipas rregullit nuk duhet të bënin zborrin pasuniversitar.

Ne të tjerëve, na dhanë rrobat e zborrit dhe na futën të gjithëve në një kapanon. Mbasi zgjodhëm krevatët dhe u sistemuam, në kapanon ra qetësia. Siç kujton Piro, të parit që ju dëgjua zëri ishte Llëri:

- Çuna, zborri filloi dhe mbaroj.
- Çfar do të thuash Llëro? – e pyeta
- Du me thonë, që në zborr jeta nuk ka variacione. Të gjitha ditët janë njësoj.
- Variacione duhet ti krijojmë vetë ne – I tha Ylli
- Tito a i ke ngref telat e kitarës ti?
- Po o Llër, po - i them, - edhe ti bëj gati barcaletat.

Periudha e zborrit tonë pas universitar, ishte edhe periudha e revolucionit muzikor në të gjithë botën. Kënga italiane, gjithashtu pati një zhvillim të menjëherëshëm në atë kohë.

Battisti, çdo javë nxirrte ndonjë këngë të re, Mina gjithashtu e pasuronte repertorin vazhdimisht. Ndërkohë që disa këngë të Çelentanos si “Storia damre”, “il ragazzo della via Gluk” e “Azzuro” kishin mbetur shumë popullore. Atë vit Çelentano nxori edhe këngën “bellissima”, që menjëherë u rreshtua ndër vendet e para në “Hit parade”. Shumë nga shokët, e ndiqnin prej kohësh muzikën moderne dhe kishin qef që këngët ti këndonim edhe në zborr. Apostoli, Piro dhe Ilia pëlqenin më shumë Çelentanon. Mua më pëlqente më shumë Battisti.

Llëri, tregoheshe indiferent. Mëndjen e kishte te Joe Cocker. Ato vite ishte bërë e njohur kënga e tij “High time we won’t”

[https://youtu.be/oK3Uz42ADDQ?si=EU7zNSjIo\\_FzlCRQ](https://youtu.be/oK3Uz42ADDQ?si=EU7zNSjIo_FzlCRQ)

Llëri e kërkonte dhe e dëgjonte në radio dhe më thoshte:

- Tito, shih mos e kapish me kitarë
- Nuk ta këndoje dot Llëro, është e vështirë për mua.

E kisha më të lehtë me këngët Italiane.

Një ditë Apostoli më kërkoi të këndoje këngën “Storia damore” të Çelentanos.

Mora kitarën dhe fillova:

- *Tu non sai cosa ho fatto..*
- Fjalëve po ja fut kot, më duket.- Më thotë Apostoli.
- Italishten e kam me të dëgjuar, gramatikën nuk e njoh – i them.

Në fakt tekstet e shumë këngëve mi kishte dhuruar kushërira ime Lela, që e dinte Italishten më mirë se unë dhe ishte e pasionuar mbas muzikës moderne.

- Prit pak më tha Apostoli, që nxitoi të marrë laps e letër dhe filloi të shkruante.
- Hë jepi- më thotë.
- *Tu non sai cosa ho fatto qull giorno quanto io lo contrai.*

Apostoli, nuk mund të pranonte gjëra të pa sakta. Thirri për ndihmë Tolin dhe Pirron dhe filluan ta shkruanin tekstin së bashku. Më në fund teksti mori formë. Filluam ta këndojmë këngën duke lexuar tekstin e shkruar.

E filluam me Çelentanon dhe e vazhduam me Çelentanon.

“Il ragazzo della via Gluk dhe” dhe “ kënga e serafinos”, 2 histori të bukura të futura në këngë nga Çelentano, të cilat shpesh i këndonte njëra pas tjetrës.

[https://youtu.be/LIjTECarkg?si=z3\\_qb3IZn6NUlaRB](https://youtu.be/LIjTECarkg?si=z3_qb3IZn6NUlaRB)

<https://youtu.be/fPQbrgkbksU?si=WMPakSa5sDkcDgT3>

Me këto këngë vazhduam edhe koncertin tonë e asaj mbrëmjeje. Buria për gjumë nuk kishte rënë akoma, kështu që kishte kohë edhe për barcaletat e Llërit.

- Hajde Llëro, Si ishte ajo e ujkut se nuk e mbaj mënd – i thotë Pirro,

Barcaletat e Llërit i kishim dëgjuar me dhjetëra herë edhe nëpër zborret 1 mujore kështu që i mbanim mënd të gjithë, por Llërit i kishin shumë lezet kur i tregonte dhe

ai nuk përtonte ti tregonte sërish. Çdo herë që i tregonte, shtonte diçka ose ndryshonte interpretim duke e rinuar barcaletën. Atë natë, kishte ndryshuar interpretimin e ujkut, dhe barcaletën na e paraqiti kështu:

- Zysha po i shpjegonte kalamajve të klasës së parë, kafshët e pyllit. Ishte dita kur do tju fliste për ujkun. Në një moment, e kërkon fjalën Ceni:

*“Psss me leje zysh.”*

*“Hë Cen.”*

*“Gjyshi im di me bo tamam si ujk.”*

*“Ashtu? E po mirë, ftoje gjyshin, të na vijë në shkollë që ta dëgjojmë edhe ne – i tha zysha.”*

Të nesërmen Ceni vjen në shkollë bashkë me gjyshin dhe mësuesja, mbasi mbledh klasën e pyet:

*“Gjyshi, Ceni thotë që ti di të bësh si ujk.”*

*“Jo, unë nuk di të bëj as si ujk, as si qen, as si dhi dhe as si gomar. Nuk di të imitoj asnjë kafshë.”*

Kalamajtë e klasës filluan të qeshin dhe mësuesja u zu ngushtë. Atëherë Ceni ju thotë:

*“Me leje zysh, e bëj unë gjyshin që të bëjë si ujk”*

*“Pa të shohim.”*

Ceni i afrohet gjyshit dhe i thotë në vesh:

*“Gjyshi, sa kohë ke që s’e bën më atë punë..”*

*“Uh uuuuuu..hu uuu”*

Mësuesja dhe kalamajtë filluan të duartrokasin.

- *Ja fëmijë kështu bën ujku- përfundoi mësuesja.*

Ne filluam të qeshim dhe filluam ta ngacmonin.

- Llëro, Si bënte ujku?
- *Uh uuuuuu..huuuu*
- Tashti na thuaj moralin e barcaletës- e pyetëm
- ***Po u plake bohesh si ujk.***
- Llëro, mos u plaksh kurrë - i thamë njëzëri,

*Kanë kaluar 50 vjet që nga ajo kohë, dhe po hyjmë të gjithë në “moshën e ujkut”, dhe e kujtojmë gjithmonë këtë barcaletë.*

*Një ditë hyra në grupin tonë whatsapp dhe ju dërgova shokëve linkun e këngës “robi plaket kur don vetë”:*

<https://youtu.be/ZSnO9ZPao84?si=3tw-gsyCdJsScTE>  
M

Mbas barcaletës rradhën e kishte kënga.

- Llëro , po na e merr tani “këngën e ijes” - i them.

Unë që ja dija tonalitetin e zërit, fillova me një la-minor. Llëri filloi këngën.

*“Unë ty moj të kam dashur ije,*

*Prej së vogli deri në pleqëri,*


*S’të vjen keq ije, e me më lane ije, e të marrësh hajde tjetër njeri....”*

Kështu filloi zborri jonë pasuniversitar

Fatkeqësisht nuk gjetëm asnjë foto origjinale të këtij grupi, kështu që dikush nga ne mori iniciativën të krijonte fotomontazhin e mëposhtëm

Nji kajin i boku nga drit e stërvijes.





*Rrapi i Trishit 1974*

## **Ndeshja e futbollit**

**R**egjimenti i ndërlidhjes kishte një fushë futbollit në gjendje të mirë ku shpesh organizoheshin ndeshje midis togave. Një ditë na u bë propozimi për tu ndeshur me një skuadër të zgjedhur nga ushtarët e repartit.

Në këndin e lajmërimit të regjimentit u vu lajmërimi:

*“ Të dielën e ardhshme në orën 10 në stadiumin e regjimentit do të zhvillohet ndeshja e futbollit midis skuadrës STUDENTI dhe përfaqësueses të ushtarëve të repartit skuadrës “USHTRIA.”*

Menjëherë u vumë në lëvizje. Caktuam Ilian si drejtues të këtij eventit.

Ky i fundit , organizoi paraprakisht një stërvitje për të parë cilësitë tona në futboll. Në fakt ishin pak veta që dinin të luanim futboll.

Në lidhje me këtë Koli kujton:

*“Me kujtohet edhe ndeshja me ushtaret qe nuk benim dot 11 shen ku Toli luajti portier. “*

Mbasi zhvilloi stërvitjen, Ilia krijoi skuadrën. Në diskutimin për krijimin e formacionit morëm pjesë të gjithë. Ilia kishte vendosur ta fillonte ndeshen me

skemën taktike 1-4-3-3. Si portjer të parë zgjodhën Tolin. Ilia insistonte që Toli të ishte portieri i parë i skuadrës:

- Në lojë ka të bëjë shumë edhe faktori psikologjik, - thoshte ai, - mbasi ushtarët e rinj do të emocionoheshin nga prezenca Tolit në portë dhe do dalin huq ose do të gjuajnë jashtë.

Në mbrojtje u caktuan Xhorxhi, Vasili , Pëllumbi dhe Pirro. Në mes fushë ishin Piro, Bakja dhe Maksi, kurse në sulm Koli, Ilia dhe Llëri

Apostolin e kishim caktuar si organizues i tifozerisë e cila praktikisht mungonte ndërkohë që skuadra “ USHTRI ”, jo vetëm që luante në fushën e vet por, për të bënte tifozllëk i gjithë reparti.

Dy ditë përpara ndeshjes, Apostoli i trokiti në derë komisar Gaqos.

- Komisar, a mund të thërresim edhe shokët e kursit që nuk bëjnë zborr për të parë ndeshjen.
- Të kuptoj Apostol që të mungojnë tifozët, por mos u mërzit se unë dhe oficerët e shtabit do të bëjmë tifozllëk për skuadrën tuaj. Po ju jap edhe një megafon për të fuqizuar zërin tuaj.

Apostoli insistoi:

- Komisar Gaqo na lejo të paktën të thërresim vetëm 1 nga shokët tanë që është komentuar i talentuar, kështu që mund ta transmetojmë ndeshjen direkt nga qendra e zërit të rregjimentit.

Komisarit i pëlqeu ideja. Do të ishte hera e parë që një ndeshje futbolli do të trasmetohej nga qendra e zërit e regjimentit.

- Mirë Apostol, më jep emër, mbiemër që ti përgatis një leje - hyrje provizore për të dielën. Të tjerë njerëz nuk dua veç.

Kuptohej që komisari nuk deshte ti hapte telashe vehtes dhe e mbylli bisedën me kaq.

Ditën përpara ndeshjes, Apostoli hyri në kapanon me megafonin në dorë, e vuri para gojës dhe na foli:

- Skuadra “STUDENTTi” çohuni të bëjmë provën tifozllëkut.

Megafoni ishte vërtet i fuqishëm dhe na bëri të trembeshin e të hidheshin në këmbë.

Për nesër kemi ftuar edhe Telon, që do të trasmetojë ndeshjen drejt për së drejti nëpërmjet qendrës së zërit të regjimentit. Gjatë komentimit ai do të dijë që të mbajë anën tonë.

- Petja, na duhet hymni i skuadrës tani , kërko dhe gjej ndonjë këngë - mu drejtua mua.

Më ra ndërmend një nga këngët e festivaleve të parë në radio.

Kënga titullohej “ Në Stadium” dhe ishte kënduar nga Avni Mula.

Modifikova pak tekstin dhe fillova ta këndoj në La Maxhore

*“ Ra bilbili filloj loja, topi fluturim.*

*Skuadra jonë e STUDENTIT luan sot në stadium.*

*Ja një faull jep referi, dridhet dhe portieri.*

*Kujdes, shiko, përpara tejkallo.*

*Loja paraqitet dramatike.*

*Forca.*

*Duhet një ndërhyrje akrobatike.*

*Jepi.*

*Hec përpara, gola duam, mos në shtyllë se mbaruam.  
Pase. Gjuje. Shyte. Goo..oo..ool, GOL. “*

- Ky është hymni - ju thashë- dhe do ta këndojmë para fillimit të lojës, gjatë pushimit dhe në fund të ndeshjes. Gjatë ndeshjes skuadrën do ta inkurajojmë me ritmin dhe melodinë e këngës “Na na Heej hej kiss him Good Buy” dhe fillova ta këndoj:

“ Nana-nana, Nana - Nana, Heeej Studenti”

[https://youtu.be/\\_PxanXM48gI?si=IC6Cs5R5R3SqODTi](https://youtu.be/_PxanXM48gI?si=IC6Cs5R5R3SqODTi)

Kjo këngë e kompleksit Steam, disku i artë i vitit 1969, ishte shumë popullore në të gjithë botën, e thjeshtë dhe tërheqëse, krijonte emocione kolektive kur këndoheshe në grup.

Duke e kënduar mendova:

“Me siguri kjo këngë do të na i shtojë tifozët”

Këtë pjesë e mësuan shpejt mbasi ishte këngë shumë e dëgjuar dhe disa prej nesh e kishin kënduar edhe në zborrin e Divjakës. Ndryshe ndodhi për mësimin e hymnit të skuadres. Filluam provat, por asnjëri nuk ja thoshte. Ishte një këngë krejtësisht e pa njohur për ta.

- Po edhe ti, ç’këngë ke gjetur - më tha Apostoli.
- Nuk ka asnjë këngë tjetër për futbollin – i thashë - nuk mund ta krijoj dot sot për nesër.
- Mirë, mirë vazhdoni provat, unë po shkoj të lajmëroj Telon për nesër.

Apostoli arriti ta lajmërojë Telon nëpërmjet një komshiu të tij i cili kishte telefon në shtëpi.

Telos I ishte bërë qefi për ftesën.

- Telo, arrin dot ta trasmetosh gjithë ndeshjen? - e pyeti Apostoli.
- Po, po mos u bëj merak.
- Po zërin e Anton Mazrekut si do ta bësh, merr ndonjë kapse rrobash me vehte, që ta vësh në hundë.
- Po rri o Apostol se e di vetë atë punë. Ti shiko mos gjesh ndonjë stendë për të fiksuar mikrofonin.
- Mirë Telo, unë do të të jap një dy pagure me ujë që të lagësh fytyrën.

Ndërkohë që Apostoli bisedonte me Tolin, unë me tifozët vazhdonim të provonim hymnin.

Kërkova të gjeja një zgjidhje sa më të thjeshtë dhe u propozava:

- Dëgjoni atëherë, këngën po e këndoj unë me kitarë dhe megafon. Ju do të futeni në kor duke theksuar fjalët:

**“Forca, Jepi dhe Pase, Gjuje, Shyte, Gool..Gol”**

Mbas këtij propozimi, çdo gjë shkoi në rregull. Ishim gati për tifozllëk.

E djela erdhi ndërkohë që emocionet na kishin përfshirë të gjithëve

## **Ora 8:30**

Në regjiment hyri Telo i cili filloi menjëherë nga puna.

Së bashku me Vason, filluan të shtrimin kavot dhe të lidhnin mikrofonin me qendrën e zërit.

Çdo gjë shkoi në rregull dhe në orën 9:00, Telo filloi provat:

- Një,dy,tre, ...një dy, tre, katër, prova teknike. Pak më vonë Telo shënoi emrat e lojtarëve të të dyja skuadrave

Ne u nisëm për në stadium me këngë në gojë

### **Ora 9:30.**

Ilia nxori skuadrën në fushë dhe filloi nxemjen

Unë fillova hymnin:

*“Ra bilbili filloj loja, topi fluturim.*

*Skuadra jonë e STUDENTIT luan sot në stadium..*

*....” Kori e mbyllte hymnin duke thirrur:*

*“ Pase, Gjuje, Shyte, Go-o-ol..Gol ” dhe më pas fillonte:*

*“ Nana-nana, Nana - Nana, He-e-ej STUDENTI ”*

Unë shoqëroja me kitarë dhe këndoja me megafon

Ushtarët, kishin marë një daulle të madhe dhe, godisnin fort me një bastun druri. Për të eliminuar zhurmën e thatë, kishin lidhur në fund të bastunit një palë pece këmbësh.

Kori I tifozëve të ushtrisë ju përgjegj këngës sonë me thirjen:

“Ushtri, bum,bum bum.

Ushtri, bum,bum bum”

Ishte një thirrje pa melodi e cila, për momentin, dominonte mbi këngën tonë.

### **Ora 9: 45**

Telo afron mikrofonin dhe shtrëngon hundën me 2 gishta, duke imituar në mënyrë të përsosur Anton Mazrekun

Në altoparlantët e regjimentit u dëgjua qartë dhe fuqishëm :

- Të dashur ushtarë dhe oficerë të regjimentit të ndërlidhjes. Të dashur shokë të mij pasuniversitarë. Në lidhje të drejt për së drejti me stadiumin e regjimentit po transmetojmë ndeshjen e futbollit midis skuadrave **STUDENTI**, e përbërë nga studentët pasuniversitarë të degës së radioelektronikës të universitetit të Tiranës, dhe skuadrës **USHTRIA**, e përbërë nga ushtarë të regjimentit të ndërlidhjes.

Ndeshja drejtohet nga treshja Abdyli, Haxhiu dhe Metaj.

Pranë meje qëlloni një ushtar i ri që më bëri pyetjen:

- Ky është ai u radio Tiranës?
- Po, po i them, ai është, Anton Mazreku.

### **Ora 10:00**

Arbitri i fryu bilbilit dhe ndeshja filloi. Ushtarët u hodhën në sulm dhe rrezikuan që në minutat e para. Mbrojta jonë, e drejtuar nga Xhorxhi, arrinte ti zmbrapte me vështirësi sulmet. Situata ishte e vështirë, Atëherë I ftova tifozët të inkurajojnë skuadrën:

***“Nana-nana, Nana - Nana, He-e-ej STUDENTI ”***

Ndërkohë, Telo vazhdonte trametimin:

- Minuta e 15, rezultati është akoma i bardhë 0 me 0, Ja tani një zbritje e ushtarëve në krahun e djathtë me anë të Haxhiut, Haxhiu... Haxhiu, pasim në qëndër tek Ndoja.

Kori I ushtarëve “ eeeee..”

- Gjuajtje e fuqishme e Ndojës.. shtyllë.

Në atë moment u dëgjua zëri i stadiumit “puuuu..”  
epasuar nga daullja dhe kënga pa melodi e ushtarëve:

“Ushtri, bum, bum, bum”

“Ushtri, bum, bum, bum”

Për rreth 20 minuta resht ushtarët vazhdonin të bënin  
presion dhe “ zëri i stadiumit” dëgjohej herë pas here  
“eeeeee..” dhe më pas “puuuu..”

Ky zë tregonte më tregonte një gjuajtje në portë pa  
rezultat.

Telo vazhdonte trasmetimin :

- Minuta e 40 e pjesës së parë, presioni i skuadrës  
vendësve, por universitarët rezistojnë dhe loja  
vazhdon pa ndonjë rezultat konkret. Ja tani topin e  
ka Hasani, krosim në krahun e majtë, goditje me  
kokë e Piros dhe topi ka përfunduar jashtë vijës  
fundore. Goditje këndi për ekipin USHTRI.  
Goditjen nga këndi bëhet gati ta egzekutojë po  
Hasani.

Në këtë moment filluan daullet e ushtrisë. Mbas pak  
udëgjua fuqishëm “goooooooo...” Ushtarët u ngritën në  
këmbë dhe ma zunë rrezen e shikomit. Nuk e pashë si u  
bë goli, por në këtë kohë dëgjoj zërin e Telos

- Autogol i Xhoxhit. Minuta e 41-të dhe ushtarët  
kalojnë në avantazh. 1:0 pra për skuadrën USHTRI.

Në atë moment u mërzita, ula kitarën dhe megafonin  
duke qëndruar i shtangur për disa minuta. Dëgjoheshe  
vetëm kënga e stadiumit:

“eeeeee..” Shtyllë “puuuu..” Topin e ka... “eeeeee..” shut  
Jashtë “puuuu..”

Mbas pak e mora vehten, u ngrita në këmbë, e “thava” paguhen e ujit dhe fillova këngën:

- **Nana nana, nana nana, heeej, Studenti!**

Në minutën e fundit të pjesës al parë, ushtarët organizojnë një kunërzbritje dhe sulmuesi që kishte rrolin e “pykës” del i vetëm përballë Tolit. Atëherë vura megafonin në gojë the fillova thirrjet “ Huq, huq,.. huq”. Genci që ishte pranë vazhdoi:

“ Huq, huq se do ta hash... huq,” ”Huq se do ta hash.” vazhduam ne të tjerët, Ushtari u emocionua nga prezenca e Tolit, gjuajti dobët dhe topi përfundoj jashtë. “Atëherë, teoria e Ilias punon ” thashë me vehte.

Pjesa e parë përfundoj 1:0 për ushtarët.

Në pushim të ndeshjes, Apostoli, u vu në rolin e trajnerit, zbriti në fushë dhe mblodhi skuadrën për ti dhënë kurajo.

- Çuna të mos harrojmë që ata luajnë në fushën e tyre dhe me publikun e tyre, kështu që janë më të favorizuar, por ne duhet ta përmbysim këtë situatë. Fushën tashmë e njohim edhe ne. Po luajtëm mirë edhe publikun do ta bëjmë për vehte. Forca çuna, forca.. Ata kanë shpenzuar shumë energji dhe janë të lodhur.

Ilia vendosi të bëjë ndryshime për të forcuar sulmin. Kaloi në variantin 1-4-2-4 dhe bëri ndryshime në formacion. Në vënd të Xhorxhit u fut në lojë Apostoli.

Pjesa e dytë e lojës mori një pamje tjetër. Loja u çvendos në fushën kundërshtare dhe skuadra jonë nën drejtimin e Ilias filloi ta kontrollonte plotësisht lojën.

Ne, tifozët u bëmë më entuziastë dhe këndonim pa ndërprerje. ”*Nana-nana, nana - nana, He-e-ej*

**STUDENTI** ” Kënga na përfshiu të gjithëve, e jo vetëm ne, por edhe një grup ushtarësh që qëndronin pranë nesh. Kjo i dha më shumë kurajo skuadrës sonë.

Forca e Këngës rritej dhe po përfshinte gjithnjë e më shumë spektatorë bile edhe komisari ishte bashkuar me këngën tonë, pa e ditur as ai vetë që po këndonte një këngë të huaj. Unë vazhdoja di bija kitarës e të këndoja pa ndërprerje.

**“Nana-nana, nana - nana, He-e-ej STUDENTI ”**

Kënga u bë aq e fuqishme sa që daullja e tifozëve kundërshtarë, pothuajse nuk dëgjohej fare.

Telo vazhdonte transmetimin e ndeshjes:

- Jemi në minutën e 68 të ndeshjes. Topi kontrollohet nga Apostoli, pasim në krahun e majtë për Iljan. manovrim i tij në mes dy kundërshtarësh. Ja tani Ilia hyn me forcë në zonën e rreptësisë. Ilia..Ilia.

Në këtë moment thirrja jonë e fuqishme shpërtheu me vrull: “goooooooo..!”

U ngrita në këmbë dhe vazhdova këngën. Dy nga telat e kitarës ishin të këputur, gishtat më ishin skuqur, por nga emocionet e forta, dhimbjen nuk e ndjeja.

Kori jonë filloi të thërriste

**“ O ushtri shko në shpi, O ushtri shko në shpi”**

Por tre minuta më vonë, ushtarët krijojnë një kundërzbtje të rrezikëshme në krahun e majtë të portës sonë. Toli i lindi menjëherë një ide. E la portën dhe, me gjimnastorkën në dorë, doli që ti zinte rezen sulmuesit kundërshtar. Ne thërrisnim “ *huq, huq, huq huq se do ta hash* “ Ndërkohë Toli ju afrua dhe lëshoi gjimnastorkën në këmbët e sulmuesit. Ky i fundit ca nga gjimnastorka

dhe ca nga emocionet, e humbi kontrollin dhe topi ju ngatërua nëpër këmbë e përfundoi në duart e Tolit. Ishte rreziku i penaltisë por, me sa duket, arbitri nuk guxoi ta dënonte Tolin , dhe bëri shenjë që loja të vazhdonte. Kori jonë I tifozëve filloi të thërriste: “ **Toli, Toli, Toli.**” Toli i entuziazmuar e gjuajti topin me forcë në drejtim të zonën e rreptësisë kundërshtare ku e priste Koli. Ky manovron bukur në zonë . Ne filluam këngën “ **Pase, gjuje, shyte..shyte..**” dhe Koli lëshoi një bombë në drejtim të portës kundërshtare duke shënuar një gol shumë të bukur, e duke i dhënë shkas vazhdimit të thirrjes sonë “**Gool gool...gool.**” Por thirrja nuk vazhdoi më shumë se 5 sekonda dhe arbitri sinjalizoi një pozicion jashtë loje të Llërit dhe anulloi golin. Dëgjova Llërin që po i justifikoj Kolin:

- Jo, qafsha nonën, nuk isha apsajt.

Unë ngrira megafonin dhe fillova të thërras “ **Jashtë arbitri hilacak**” kurse të tjerët: “**Hilc, Hilc, Hilc**”. Nga ai moment tanët morrën vrull dhe u hodhën në sulm. Loja zhvillohej vetëm në fushën kundërshtare. Ushtarët e humbën kontrollin jo vetëm të lojës por edhe të mendjes.

Minuta e 82, Ilia pëson një goditje nga mbrapa shpine, rrëzohet dhe nuk po ngriheshe dot. Infermiera e regjiment ndërhyr dhe e nxjerrin me barelë jashtë fushe. Skuadra jonë mbeti me 10 lojtarë. Arbitri nuk dha as faull, por bëri shenjë që loja të vazhdonte. Atëherë Llërit i kërcyen nervat, i afrohet lojtarit që bëri faullin dhe i tha “Meqënëse nuk të dënon arbitri të dënojmë ne” dhe i futi një shqelm b\*thve. Arbitri e pa, i nxorri kartelin e kuq



dhe e përjashtoj Llërin nga loja, Ne mbetëm me 9 lojtarë

Unë nuk u përmbajta dhe vazhdova thirrjen me megafon: **Jashtë arbitri hilacak.**

Me zërin tim, tashmë u bshkua i gjithë stadiumi: **hile hile...hile**. Gjëndja ishte kritike. Ushtarët ishin tërbuar nga inati. Një minutë më vonë, Bakja rrëzohet brënda zonës së rreptësisë, por arbitri e dënon për simulacion dhe jep faull kundra nesh.

Për fat Ilia nuk e humbi toruan, futi menjëherë në lojë Gencin.

Telo, që kishte pirë 2 pagure ujë për të mos ju tharë goja, vazhdonte trasmetimin pa ndërprerje:

- Minuta e 89 e lojës. Skuadra Studenti vazhdon ta kontrollojë topin në fushën kundërshtare megjithëse me 9 lojtarë. Ja tani Pirro, që pason tek Apostoli, ky i fundit tek Maksi. Maksi ja lëshon topin Bakes që gjen të lirë Gencin në krahun e djathtë, Genci, Genci... Manovrim i bukur në zonë, Genci...,shmang bukur Deliun, Genci...,ndërhyrje e portierit Magjypi. Gjuajtje e Gencit dhe **gool**. Topi, mbasi kalon përmes këmbëve të Magjypit përfundon në rrjetë. Gol shumë i bukur i Gencit në minutën e fundit të ndeshjes.

Me atë pak zë që më kishte mbetur , thirra sa munda:

**”gool, ...gool”**

Emocionet më përfshinë dhe fillova këngën me megafon:

**Nana nana heej Studenti.** Tashmë bashkë me mua këndonte i gjithë stadiumi. “ **Nana nana heeej Studenti.**”

Nga frika që entuziazmi jonë të merte përmasa të pa kontrolluara, komisar Gaqo dërgoi një ushtar dhe ma mori megafonin. Mbas pak arbitri lëshoi fishkëllimin e gjatë të përfundimit të lojës duke e mbyllur ndeshjen me fitoren tonë.

Telo vazhdonte transmetimin dhe nuk e përmbante dot vehten nga gëzimi:

- Mbas një loje të shkëlqyer skuadra STUDENTI arrin një fitore të merituar...

Por në këtë kohë transmetimi u ndërpre. Dikush e kishte stakuar qëndrën e zërit.

Unë vrapova të përqafoja shokët e skuadrës. Kënga vazhdonte pa ndërprerje. Filluam të bënim xhiron rreth stadiumit duke mbajtur mbi shpinë Ilian, i cili këndonte bashkë me ne. Kënga jonë vazhdoi deri në mesnatë

**“Nana nana heeej Studenti”**



*Rrapi i Trishit 1974*

## **Kënga e pjatave.**

Gjatë zborrit, qëllonte që bënim shërbim në mencë ku përfshihej edhe larja e pjatave

Ishte kjo një nga shërbimet më të sikletëshme. Normalisht, duhet të lanim mbi 100 pjata dhe po aq gota prej alumini.

Një ditë shërbimi më ra me Tolin. Ishte ditë e hënë dhe pjatat për tu larë ishin dyfishuar.

- Toli, leri se i laj unë- i them.
- Jo, do ti lajmë bashkë, janë shumë pjata dhe nuk i bën dot vetëm.

E kisha të qartë që, në këtë lloj pune, Toli nuk ja thoshte, kurse unë, i kisha larë disa herë enët në shtëpi.

- Mirë i them, unë po i laj kurse ti, po munde, shplai.
- Dakord - tha Toli - se kam menduar edhe një metodë të re për shplarje.

Nuk vonova të filloj punën. Në fillim i pastrova të gjitha pjatat nga mbeturinat. Toli më rrinte larg dhe nuk fliste. Mu duk sikur kishte merak nga pjatat e pista. Në fakt ushqimi i ndenjtur nëpër pjata ishte thartuar dhe lëshonte një erë të rëndë. Kjo e vështirësonte edhe më shumë larjen.

- Toli rri larg se këtu qenka për kundragaz - i thashë

- Po pra - tha Toli dhe zuri hundën me dorë.
- Po të duash, dil përjashta dhe lere derën të hapur, sa të pastrohet ajri, se të thërras unë kur të mbaroj larjen.

Unë i dhashë vetes dhe në një tenxhere të madhe hodha ujë të nxehtë dhe pluhur sapuni. Kur u bë shkumbë fillova ti laj pjatat një nga një. Ca nga vapa dhe ca nga uji i nxehtë, u bëra ujë në djersë. Kur i përfundova, I bëra zë Tolit:

- Toli, I ke gati tani!

Toli hyri dhe përgatiti shplarjen.

- Largohu pak se mos lagesh - më thotë.

Ktheva kokën për të parë ç'po ndodhte.

Toli kishte rreshtuar mbi lavoman, nja 10 pjata. Pjatat i kishte vënë në “këmbë”, të mbështetura tek pllakat e lavomanit dhe me një zorrë kishte filluar ti lëshonte ujin me presion.

- Toli janë të lara mirë, mund ti shplash edhe me dorë, pa merak.
- Jo kështu e kam më kollaj - më tha – pse nuk të pëlqen si metodë?
- Jo, kështu duket e lezetshme.

“ Vazhdon të ketë merak” mendova, dhe e lashë në punën e tij.

Shkumba e sapunit që largohej ja linte vendin shkëlqimin të aluminit. Pjatat dukeshin aq të pastërta sa që dalloheshin qartë edhe gërvishtjet mbi alumin.

Toli e mori me qef punën,

Shtronte pjata mbi lavoman, i vinte në shenjë, dhe i gjuante me ujin e zorrës. Shpesh pjatat dridheshin nën presionin e ujit duke lëshuar një tingull metalik që ndryshonte nga pjata në pjatë, dhe krijoheshë kështu një melodi të veçantë.

Me sa dukej “koncerti i pjatave” i pëlqeu Tolit. Lëvizte shpesh gishtin e madh për të ndryshuar presionin e ujit dhe bashkë me të edhe melodinë.

Larja e pjatave u këthye vërtet në një lojë të lezetshme, aq sa Toli më tha.

- Këto po mbarojnë. A ka të tjera?
- Pjatat mbaruan. Po të jap ca gota - i thashë.

Për të njëjtin presion të ujit, gotat lëshonin tingull tjetër. Tolit i pëlqeu dhe në një moment më thotë:

- Kot sa nuk more kitarën, do krijonim një orkestër të vërtetë, Unë me pjata e ti me kitarë.
- Toli, ty nuk të thonë gjë, sepse zorra e ujit nuk njihet si vegël muzikore ( edhe po të njëjti nuk të thonë gjë ty.. mendova), kurse mua do më thonë që i bije kitarres në kohën e shërbimit në mence dhe do më dënojnë. Po të duash po të këndoj një këngë ku përmendet edhe larja e pjatave.
- Hë - tha Toli - gjithë qef – jepi sepse në punë kënga lejohet.
- Mirë - i thashë - por nuk është këngë rreshtore..është këngë Italiane.
- Po punë e madhe, a është këngë e bukur?
- Mua më pëlqen – i thashë.

E dija që Toli e pëlqente muzikën e huaj dhe fillova të këndoj një këngë të Mogol - Batistit e titulluar “Vendo casa” e kënduar nga kompleksi Dik-Dik :

*“La cucina guarda Che ce*

***Quanti piatti sporchi da lavare.***

*E mia madre sempre qui*

*Che ripete "non lasciarti andare".....*

*Un panino, una birra e poi*

*La tua bocca da baciare*

*E la fiamma si alza ancora dentro me*

*Questa casa è tutta da bruciare*

*Questa casa è tutta da bruciare.*

*Questa casa è tutta da bruciare.”*

[https://youtu.be/4jqIzX\\_Wu5E?si=\\_KnhInJySSmhRnez](https://youtu.be/4jqIzX_Wu5E?si=_KnhInJySSmhRnez)

Kënga e ndezi Tolin:

- Oo.., po e di edhe unë këtë këngë dhe filloi të këndonte me zë rrok:

*“Tutti questi piatti sono da lavare.*

*Tutti questi piatti sono da lavare.....”*

Për një moment, la zorrën e ujit përtokë dhe filloi të mbante ritmin me dy gota bosh.

Uji “mori dhenë” nëpër dysHEME.

- Kujdes zorrën Toli – i thashë.
- Lere, lere se na mori mendjen kënga-më tha dhe vazhdoi punën.

Akoma pa u shplarë të gjitha enët, u dëgjua një zë nga guzhina:

- O Nurie, na janë dehur çunat e pjatave moj.

Nuria, guzhinjerja e mencës hyri me shpejtësi:

- Po ju qenkeni bo tapë o çuna, po pse keni pi kanë shumë xhonëm?
- Nuk kemi pirë, po na ka dehur kënga – i thashë
- Po na e keni bo pellg me ujë guzhinën veç.

Toli u zu ngushtë dhe duke më shkelur syrin, u përgjegj:

- E.. po ishin shumë pjata prandaj. Ja, ja.., mbaruam dhe, pa e kuptuar as vetë, vazhdoi këngën.
- *Tutti questi piatti sono stati, da lavare.*
- Nuk po mor vesh gjo e të keqen nona.- tha Nuria.

Atëherë unë vazhdova këngën në shqip:

- *Gjithë kto pjata ishin  
Për tu larë.*
- *Gjithë kto pjata ishin  
Për tu larë.*
- E mora vesh o çunoo..., po mos bërtit kaq shumë ne ti, si gjithë të tjerët ene ju.
- Nurie, ne kemi larë dyfishin e të tjerëve.
- Ju lumshin durët o të keqen nona, ju qëlloj ditë e hënë prandaj.
- Pastaj mu drejtua mua dhe me zë të ulët më tha:
- Po ti mos u qaj or çun, se ty të ka çu përforcime udhëheqja.
- Unë qesha, kurse Toli, mu duk, sikur nuk mori vesh gjë.

Nuria kur e pa Tolin duke shplarë me zorrë, buzëqeshi dhe tha :

- Metodë e bukur kjo e jotja or çuno, por nuk na del as koha ne as ujti për ti shpla për ditë kështu.

Mbaruam larjen e pjatave dhe dolëm nga guzhina gjithë gaz dhe me këngë në gojë. Pasioni i këngës na e kishte ndryshuar humorin dhe na e kishte larguar trishtimin që na shkaktuan pjatat e pista. Bile atë ditë kjo këngë vazhdoi edhe në mbrëmje. Unë mora kitaren dhe me ne u bashkuan edhe shokët e tjerë:

*“Un panino, una birra e poi  
La tua bocca da baciare  
E la fiamma si alza ancora dentro me  
Questa casa è tutta da bruciare  
Questa casa è tutta da bruciare. Questa casa è tutta da  
bruciare.*

Kënga mbaroi, por Toli vazhdonte akoma të këndonte me shikimin e drejtuar poshtë nga qyteti.

*“Un panino, una birra e poi  
La tua bocca da baciare  
.... La tua bocca da baciare  
..... La tua bocca da baciare”*

Vazhdova ta shoqëroj këngën e tij dhe mendova:

“ Shumica nga ne, e ka nga një të dashur në qytet, që po e pret, sa shumë buzë kanë ngelur pa u takuar, sa shumë puthje kanë mbetur pa u shijuar.”

Pa dashur dhe pa e kuptuar, ky mendim mu bë këngë e cila mori formë mbi atë melodi të bukur të Batistit.

Atëherë vazhdova këngën, por këtë rradhë me poezinë e zemrës:

*“ Sa shumë buzë kanë mbetur pa takuar...*

*.. sa shumë puthje kanë mbetur pa u shijuar*

*na na na na na naaaaa”*

Perëndimi i bukur i diellit i cili e kishte skuqur qiellin mbi Tiranë na e shtonte frymëzimin dhe e rriste forcën e këngës tonë. Ndër kohë ndjeva që ritmit të kitarrës sime, ju shtua edhe tingulli i kitarrës së Vasilit. Edhe ai po i këndonte të dashurës së tij në Korçë. Me ne u bashkuan zërat e Apostolit, Vasos, Piros, Kolit, Yllit, Pellumbit, Pirros, Maksit, Ilias, Tolit, Llërit, Bakes, Vasilit...

Të gjithë po kujtonin dikë dhe po i këndonin dashurisë:

*“Sa shumë buzë kanë mbetur pa takuar..... sa shumë puthje kanë mbetur pa u shijuar, na na na na na naaaaa”*

***Akoma edhe sot, mbas 50 vjetësh, sa herë që shkoj të laj makinën, më kujtohet Toli që lante pjatat me ujë me presion dhe filloj të këndoj “ këngën e pjatave”***

*“Un panino, una birra e poi  
La tua bocca da baciare....”*



*Rrapi i Trishit 1974*

## **Kadaifi**

Ushqimi i zborrit na ishte bërë një rutinë e përditshme Pirro e kujton mirë menunë:

“ Në mëngjes groshë, në drekë pilaf ose makarona të skuqura që të mos merrnin shumë vaj dhe ndonjë gjellë me pak mish dhe në darkë caj me yndyrë dhe djathë.”

Kur ishte festë mund të na bënë ndonjë revani.

Periudha e verës ishte pa festa pra edhe pa revani.

Na kishte shkuar mëndja keq për një gjë të ëmbël.

Ishte data 18 tetor. Toli kishte festuar festën e babait dhe kishte marrë 2 ditë leje nga komanda.

Datën e saktë të kësaj ngjarje ma kujtoi Apostoli i cili mbante mënd vizitën që na kishte bërë shoku Pilo dy ditë më parë për të na treguar një kujtim nga libraria Flora. Në fakt e kishim dëgjuar sepse kujtimet e luftës po ato ishin dhe përsëriteshin çdo përvjetor.

Ishte koha e pushimit, kur Maksi hyn në kapanon dhe thërret:

- Çuna po këthehet Toli, po seç ka edhe diçka të rëndë me vehte sepse ka marrë edhe Ilian që ta ndihmojë

- Çfarë do të jetë Make? E pyet Apostoli.
- Nuk e di.. Duket si një tepsi e rrumbullakët.

Toli me Ilian ndaluan në postbllok, ushtari i rojës, i kontrolloi dhe i la të kalonin duke buzëqeshur.

Dolëm të gjithë jashtë për të parë. Sa më shumë afroheshin, aq më shumë shtoej kurioziteti, tashmë jo më për tepsinë por për çfarë fshihej brënda tepsisë. Maksi e prishi qetësinë dhe tha:

- Çuna bëni gati lugët, se diçka për të ngrënë është me siguri.
- Pse Maksi, ku e di ti?

Derisa po vjen me Ilian, do të thatë që vjen nga guzhina. Derisa vjen nga guzhina, vjen nga barba C. që është guzhinjeri i familjes, dhe deri sa vjen nga Barba... nxirni lugët o trima!

Atëherë Llëri dha komandën:

- Toga, lugë nxir !

Në zborr lugët ishin personale dhe seicili e mbante me vehte.

I kishin bërë apostafat me bisht të shkurtër dhe mund të futeshin edhe në xhep. Unë e kisha mbështjellë me një letër plastike dhe e mbaja në xhepin e majtë të xhaketës. E nxora dhe e bëra gati. Por, pa bërë as 10 metra nga postblloku, Ilia me tepsinë në dorë ndëroi rrugë dhe diku u fut. Na shkoi huq. Mbetëm me lugë në dorë pa provuar gjë. E pa pritura ndodhi më vonë, në mencë, mbasi hëngrëm darkë.

Tava u lëshua mbi tavolinë dhe zbuluam që ishte plot me kadaif.

U shtanglm, për një moment dhe po shikonim njëri tjetrin.

Të them të drejtën, ishte normale që kadaifi të ndahej në mënyrë të barabartë dhe të gjithë të provonim nga një copë, por dikush nuk duroi dhe bëri që të “plaste lufta”

Që në sekondat e para lugët dolën jashtë luftimit. Beteja për kadaifin zhvillohej me duar.

Apostoli kujton që më aktiv ishte Ilia cili përdorte njëkohësisht të dyja duart. Për 2 minuta tava u boshatis. Kush hëngri hëngri. Të tjerët po merrnin sherbetin me lugë. Në një moment tava ra përtokë duke lëshuar tingullin metalik të një ene të zbrazur. Siç kujton Vaso, Ylli një nga ata që kishin mbetur pa gjë, e kishte shtyrë tavën bosh duke i dhënë fund betejës për kadaif. Vetëm atëherë ngritëm kokat për të parë njëri tjetrin. Pamja ishte aq komike sa filluam të bëjmë me gisht njëri tjetrin dhe të shkriheshin gazit. Maksit i ishte bërë hunda gjithë copa kadaifi që ishim ngjitur nga sherbeti, Llërit i kullonin basetat sherbet, Pirros, që i kishte flokët e drejta, i ishin ngjitur në flokë copat e kadaifit dhe dukej sikur i kishte lyer flokët me llak. Të gjithë ishim zhgarravitur me sherbet.

- Iiii.. po qy kush është mo - ja bëri Bakja.

Kthyem kokën dhe pamë Ilian. I kishte ngrënë kadaif jo vetëm goja, por edhe hunda, bile edhe vetullat e qerpikët ishin me copa kadaifi. Ilia ishte pak bjond dhe me flokë të dredhura, kështu që edhe flokët i kishte me

ngjyrën e kadaifit, Nuk merrej vesh pra ku mbaronte kadaifi dhe ku i fillonin flokët. Të dyja duart i kullonin akoma sherbet dhe nuk pastronte dot as fytyrën.

- Iiii.. Po qysh më qenke bërë kështu mo Ilo - vazhdoi Bakja me naivitet, duke e ndezur akoma më shumë të qeshurën tonë.
- Si skulpturë futuriste - shtoi Apostoli.

Nga e qeshura e madhe filluan të na shkonin lot nga sytë. Edhe lotët e kripura na u bënë sherbet.

Bakja vazhdoi:

- Po ç'më qani o të zinj, Do na sjellë Toli një tepsi të madhe javën që vjen.

Llëri vazhdonte të qëndronte si i ngrire me lugë në dorë.

- Llëro, mos u mendo shumë po fute lugën në brez, se kadaifi mbaroi. Hëngre çfarë hëngre mjaft tani.
- Qafsha nonën që nuk kom fut asnjë copë kadaif në gojë.
- Po ti shih si të është bërë surrati një herë – i thotë Piroja
- Prej jush që më shtytë e rashë me turi në sherbet, por kadaif nuk kom hongër.

Të them të drejtën, në atë moment unë i besova më shumë basetave që kullonin sherbet se sa lugës bosh.

- Llëro, tek basetat e faqes së majtë, ke një copë kadaif që po të lëviz - I thotë Piroja. Rri ashtu siç je, mos lëviz.- dhe u bë gati ti jepte një shuplakë mbi faqe.
- O rrotë mullini, mos aty se po më vret nishonin.

- Obobo, Llëro qenka grenxë më duket. – dha alarmin Piroja, dhe e lëshoi pëllëmbën mbi fytyrën e Llërit.
- Ooo Piro, o shoku i poshtër, ma vrave nishonin. Ishalla se më ke thy syzet se kom për të bo nomin e zi.

Llëri ishte i vetmi në grup që mbante syze. I hoqi me shpejtësi dhe në kokën e mbuluar me sherbet ju theksuan 2 vrimat e syve. Qerpikët i ishin rënduar nga sherbeti dhe nuk i lëvizte dot.

- Iii, po qysh më je bërë kështu mo Ilir, si pilot alikopteri je bërë – vazhdoi Bakja.

Në atë moment, grenxat ishin shtuar shumë dhe kishin kohë që vinin vërdallë.

Disa ishin mbytur në sherbetin e tepsisë dhe nuk lëviznin dot më. Mbasi kishin mbaruar punë me tepsinë, filluan të na sulmonin edhe ne.

E ndërpremë të qeshurën dhe ja dhamë vrapit për në banjë me gjithë grenxat që na ndiqnin nga mbrapa.

Po ku laheshe gjithë ai sherbet. Më e keqja ishte se kishim bërë pisë edhe uniformat.

Khaketa e Llërit kishte marrë shumë sherbet dhe nuk i lahej për qamet.

Bakja, që kishte mbetur pa kadaif, ishte kurdisur keq dhe vazhdonte të fliste:

- Po ti vajte dhe u zhyte me kokë në sherbet o derëbardhë. Po ç'ke bërë kështu o i pa ngopur. Po

do të të ngjisë pushka në xhaqetë e nuk të shqitet më, o i ziu ti.

Bakja, që vinte nga Qyteti Stalin, fliste në dialekt. Zëri i tij i hollë dhe shumë ngacmues bënte që e qeshura jonë të mos pushonte.

- Po, po Llëro, kujdes nesër në stërvitje se mos na ngelesh “në sup arm”- vazhdoi ta ngacmonte Piroja.
- Piro, do më lesh rehat, se ti më shtyve dhe rashë mbi tavë...

Të qeshurat nuk pushuan gjithë atë natë.

Të nesërmen e ditës së “kadaifit”, si çdo mbrëmje, u mblodhëm pranë kapanonit për të vazhduar me këngë dhe barcaleta.

- Tito, na merr një kongë për kadaifin tani. - Më thotë Llëri.
- Po ri o Llër ri, ku ka kongë për kadaifin.
- Tito, mos e dridh tani. Na sajo një kongë për kadaifin.
- Mirë, – i thashë – Sa ta sajoj, fillo ti me ndonjë barcaletë.
- Mirë, tani po ju thomi una një barcaletë për kadaifin  
- tha Llëri dhe filloi tregimin:

*“Në xhiron e Tiranës, kishte dalë një gocë me mini fund. Kishte komë të gjata e të bukura dreqi. Kishte vesh një palë geta të qëndisura me kuadrate në formë rombi. Komët e gjata dhe fundi shumë i shkurtër të krijojnë përshtypjen sikur kuadratet e qëndisura me fromën e copave të bakllavasë nuk mbarojnë kurrë.*

*Një grup çunash, të tërhequr edhe nga bukuria e këmbëve e saj, ju vu nga mbrapa. Më garipi, e pyet:*

- *Goce, deri ku të shkojnë këto copat e bakllavasë?*
- *Edhe pak më lart o çuno se pastaj më fillon kadaifi.”*

Zakonisht në fund të çdo barcalete Llëri shtonte ndonjë koment. Këtë rradhë heshti.

Ne ja kërkuam me një zë:

- **Morali I barcaletës, Llëro ?**
- Jo, jo.. Kjo osht barcaletë e pa moralshme.
- Duam moralin, duam moralin..- vazhduam të gjithë me një zë.

Atëherë Llëri shtoi:

- **Rroftë kadaifi që është burimi i jetës.**

Plasi e qeshura. Unë, që desha akoma kohë për ta sajuar këngën i them.

- Morali është shumë i përgjithshëm Llëro dhe, duke ju drejtuar Gencit, bëra pyetjen.
- Genci si thua ti ?

Zakonisht Genci I fillonte batutat me shprehjen “Veç po..”

- ***Veç po ta kesh provuar bakllavanë, të shijon edhe kadaifi.*** - e lëshoi batutën Genci - jo si ti që u zhyte drejt e në kadaif dhe nuk e provove bakllavanë.
- Mos ma thuj dy herë Genco, pse kishin pru ene bakllava?
- Po jo mor Llër, bakllavanë na e kujtove ti. Tito, filloje pra me bakllavë që të dalim në kadaif.

Atëherë unë fillova këngën:

*“2 dele 300 pare, 2 dele 300 pare,*

*Çohu Llëro, Çohu Lllro kap një valle,*

*Merre Kolin, merre kolin dor për dore.*

*Marshalla ç ’të paska hije,*

*Si bakllava. si bakllava në tepsie”.*

Llëri këndonte gjithë qef.. Në dorë mbante tavën e kadaifit bosh që e kishte larë mirë e mirë dhe e përdorte si dajre. Forca e këngës e hodhi përpjetë. U ngrit në këmbë dhe ja mori valles nën ritmin e kitarës.



Këtë rradhë gjithë toga u rreshtua në valle. Pellumbi dha komandën:

- Në rreshtin e valles mblidhu!

Reshti u krijua. Mbas Pëllumbit vinte Llëri dhe me rradhë Koli, Apostoli, Vaso, Vasili, Genci, Maksi, Ilia e më në fund 2 Pirrot. Bakja e mbyllte rreshtimin e valles. Toli dhe Ylli, rrihnin shuplakat. Unë këndoja me kitarë.

Kënga dhe vallja “morrën dhenë”.

Ndërkohë, duke gërmuar në repertor dhe mu kujtua një këngë qytetare shkodrane që shpesh e këndoja me shokun tim, Dolfi. Ja modifikova pak tekstin, dhe fillova ta këndoj në re-maxhor:

*“ Oh, Oh, se ç’rezik na ka qëllu. Oh, Oh kadaifi na osht mbaru.*

*Kadaifi kush e pruni për mbi tavolinë e vuni.*

*Kur pa prituri u lëshuam edhe tavën e mbaruam.*

*Vaj medet medet për mu, kadaifi çu maru.*

*Vaj medet medet për mu, iku shpejt pa e provu.*

*Dhe për Llërin e shkret,*

*Asnjë copë nuk mbet.*

*Ja hëngrëm me gjithë sherbet.*

*Dhe I thamë “Të rroni vet.”*

*Oh, Oh se ç’rrezik na ka qëllu,*

*Oh, Oh, kadaifi na osht mbaru..”*

Këngën filluam ta këndojmë të gjithë me një zë:

*“Oh, Oh se ç’rrezik na ka qëllu,*

*Oh, Oh, kadaifi na osht mbaru..”*

Në fund të valles Llëri lëshoi thirrjen:

- Çuna, rroftë kadaifi.

Më pas mu drejtua mua:

- Tito, tani ma kap kongën e shpirtit tim.

Unë e kuptova që mbas asaj mbrëmje të gëzuar, shpirti i kërkonte këngën e Ijes. Formova nje La në kitarë dhe Llëri filloi këngën:

*“ Unë ty moj të kom dashte Ije.*

*Prej se vogli, der në pleqni.*

*S’të vjen keq, Ije O me më lanë Ije.*

*E të morësh hajde tjetër njeri... ”*

<https://youtu.be/GKm3cnxVhFU?si=Htbudl-UAf1wuOb8>



Kjo këngë e bukur na i qetësoj shpirtin të gjithëve. U kthyem plot emocione në kaponon për të pushuar.

Të nesërmen e festës së “kadaifit”, rutina e ushqimit vazhdoi njësoj si përpara:

Groshë , makarona të skuqura, pilaf, , çaj, djathë...Groshë , makarona pilaf, , çaj, djathë....

Kaloi një javë nga “ dita e kadaifit” dhe Pëllumbi na rreshtoi për të bërë stërvitjen e radhës. Kishim rreshtore.

- Toga në rresht për 3 mblidhu!

Gadi..tu!

Në sup Arm!

Qëndruam pa lëvizur.

Pëllumbi vuri re që Llëri po përtypej.

- Ushtar M. dil nga rreshti.

Llëri u gëlltit me shpejtësi dhe doli nga rreshti.

- Dil këtu në krye të togës që të të shikojnë të gjithë.

Llëri doli.

- Ke një copë kadaif mbi buzë - I tha Pëllumbi.

- Una kadaif? Jo s'osht e mundur.

Ne filluam të qeshim. Bakja që ishte gati i thotë:

- Iii..po ç'thua mo Ilir. Po ty po të kullon sherbeti nga mjekra o derëbardhë.
- Qafsha nonën qi nuk kom hongër kadaif. Mos ka njel ndonjë copë nga ajo ditë që e hongrëm të gjithë.

Genci, që nganjëherë e lëshonte ndonjë të fortë i tha:

- ***Veç po të jesh ripërtypës, si puna e dhisë.***

Ne dolëm nga rreshti dhe filluam të qeshim me lotë.

Llëri ngeli dhe filloi të qeshte bashkë me ne. Më pas, për ta mbyllur muhabetin thirri:


- Çuna, Rroftë kadaifi!

Thirrja e tij na e shtoi të qeshurën edhe më shumë.

Në atë moment kuptuam që kadaifi ishte gjallë akoma dhe diku fshihej, ndoshta në ndonjë komedinë. Mirëpo, kjo ngjarje, e zbuloi sekretin dhe i zoti i komodinës e përllau që atë ditë dhe na i zhduki gjurmët.

Kanë kaluar mbi 50 vjet dhe historia e kadaifit mbetet akoma i gjallë në kujtimet tona.

***Dëshiroj që ky shkrim ta bëjë atë të pavdekshëm dhe ta kujtojmë sa të jemi gjallë.***



*Rrapi i Trishit 1974*

## **Vizita e Gjeneralit**

Viti 1974 shënoi ndryshime të mëdha në ushtri. Në plenumin e V të KQ të partisë u dënuan qëndrimet e ministrit të mbrojtjes B.B. cili më pas ishte shkarkuar nga çdo detyrë dhe ishte internuar në Roskovec. Ministër i mbrojtjes ishte caktuar M.Sh. dhe zv. Ministra P.D. dhe H.Ç. Situata në ushtri ishte akoma e pa stabilizuar. Zv. Ministri i ri gjeneral- leitnante P.D., që, deri dje kishte mbuluar rolin e shefit të shtabit të përgjithshëm të ushtrisë, nuk mund ti shmangej kollaj përgjegjësisë që kishte për veprimtarinë armiqësore të B.B. E ndjente që toka po i shkiste nën këmbë.

*Shokët e Radioelektronika74, më kërkuan që të shkruaja diçka për vizitën që na bëri në zborr zv. Ministri P.D.*

Atëherë hyra në internet për të kërkuar materiale të asaj kohe.

Vetëm shumë kohë më vonë nga ngjarjet e asaj periudhe gjeta të publikuara dy letra të panjohura të ish-Shefit të Shtabit të përgjithshëm dërguar sekretarit të parë të Komitetit Qëndror të PPSH-së. Letrat mbajnë datat 17 qershor dhe 16 tetor të vitit 1974, në të cilat bëhet fjalë mbi mosmarrëveshjet dhe kontraditat e thella që Shefi i

Shtatmadhorisë P.D kishte me Ministrin e Mbrojtjes, B.B, lidhur me punën e tyre disa vjeçare në krye të Ushtrisë dhe konceptet e tyre mbi tezat e Këshillit të Mbrojtjes, etj.

Ishte fundi i tetorit dhe, mesa duket, zv. Ministri nuk kishte marrë akoma asnjë përgjigje.

Mbasi i lexova letrat në internet, kuptova që me ato letra kishte rënduar edhe më shumë fajin. Letrat i ishin dërguar me shumë vonesë udhëheqjes ndërkohë që B.B ishte i dënuar.

Duke shkruar, më lindi vetë vetiu pyetja:

Cili ishte qëllimi i vërtetë i vizitës të P.D. në një togë studentash, në kohën që në udhëheqjen e ushtrisë, gjëndja ishte inkandeshente dhe problemet e një zv. ministri të ri në detyrë ishin shumë më të mëdha e më urgjente se sa vizita në një Togë studentësh?

Nën vështrimin e sotëm të ngjarjeve, logjika më çon në këtë përgjigje:

Në togën që po vizitonte ndodheshe një nga pjesëtarët e familjes të udhëheqësit të Partisë. Kushedi, në mënyrë indirekte, do të mund të dërgonte një mesazh udhëheqësit.

I vetmi koment që më vjen ndërmend në këtë moment që po shkruaj është epiteti që përdor Piroja:

“ Mavrija, kishte ardhur mos e gjente shpëtimin tek ne.”

Përpara takimit, komanda e repartit, nxitonte të përgatiste ambientin mikpritës.

Komisari i repartit na mblodhi për të na komunikuar vizitën.

Në lidhje me këtë Pirro kujton:

“Po komisarin që na bënte punë politike e mbani mend? Që thoshte se P.D. dhe H. C. e mbajnë ushtrinë.”

Më në fund dita e takimit erdhi:

Zv.ministri hyn në klasën tonë në repart. Ne qëndronim të ulur nëpër banka dhe nuk flisnim.

Siç e mban mend Piroja.

“ P.D. Ishte i zbardhur fare ne fytyre. Hypi mbi nje tavoline gjysem trupi dhe pyeti me radhe per emrat. Me duket se Gencit i beri nje kompliment për mustaqet”

Apostoli kujton që i kishte prekur muskujt e krahut duke i bërë edhe atij një kompliment:

- Zborri të paska forcuar edhe fizikisht.

Mbasi e ngrohu ambientin duke krijuar një klimë më shoqërore, me sytë e drejtuar nga Toli, na pyeti në se ishim të kënaqur me kushtet dhe trajtimin që na bënin, dhe urdhëroi që të na jepnin nga një palë uniforma të reja mbasi këto që kishim na ishin zbardhur nga dielli.

Më vonë filloi të na fliste për forcën dhe taktikat e luftimit të ushtrisë tonë, duke përsëritur të njëjta gjëra që mësonim në stërvitje. Na përmendi teorinë e “Derës ku nuk mund të hyjnë dy veta”. Kjo për na të treguar që as një ushtri armike më e shumtë në numër nuk ka ç’na bën dhe së fundi na pyeti a kishim ndonjë pyetje për ti bërë.

- Shoku zv. Ministër, a mund të informohemi më hollësisht për veprimtarinë armiqësore të B.B.? – pyeti Pirro.

Zv. Ministri, qëndroi pa folur për pak sekonda, pastaj, për ti dhënë fund muhabetit shtoi:

- Partia do tju informojë për gjithçka në kohën e duhur.

Më pas na uroi stërvitje të mbarë e u largua.

Vizita e zv. Ministrit pra na dhuroi vetëm nga një palë rroba të reja ushtarake të cilat i përdorëm akoma edhe pak ditë, mbasi ishim në fund të zborrit.

Si gjithmonë Llëri që përfitonte nga situatat e krijuara, filloi ta përdorte vizitën e P.D. për të nxjerrë përfitime të tjera.

Siç kujton vetë Llëri, një javë mbas vizitës të P.D. shkoi të kërkonte liri-dalje.

Mbas dënimit që kishte marrë, ishte shumë e vështirë që ti jepnin leje. U paraqit në komandë dhe ju drejtua komisarit :

- Shoku komisar, kom ardhë për të marrë liridaljen e fundit të javës.
- Ti e di që je i dënuar ushtar M.
- Po na ka dhënë leje shoku P.D.
- Kush ? – Pyeti komisari. Aty pranë ndodhej Maksi, I cili i pëshpëriti në vesh:
- Llëro ai ra nga fiku.

Llëri u shtang dhe tha:

- Asgjë shoku komisar, meqënëse nuk më takon, nuk ju kërkoj leje.
- Jo këtë javë nuk do të japim liri-dalje për asnjë.

Kishin kaluar veçse pak ditë nga vizita kur morëm vesh shkarkimin e P.D.

Atë mbrëmje diskutimi ishte shumë i ndezur.

Llëri e mori fjalën:

- Make, ti më the që P.D. ka rënë nga fiku, po nuk e mora vesh a ka rënë me kokë apo jo.
- Po ç'rëndësi ka o Llëro, kokën e ka vënë në rrezik deri sa ka rënë nga maja e fikut. Ti mund të më thoshe, ç'dreqin shkoj e hypi deri në maj të fikut. Kuptohet që sa më lart të ngjitesh në fik, aq më shumë vritesh kur bije nga fiku.

Por Llëri deshte të dilte tek tema e preferuar e tij, tek barcaleta dhe shtoi:

- Make, kjo s'do me thonë gjo. A e di atë të atij shqiptarit në Amerikë që ra nga maja e gradaçelit.
- Hë Llëro na i trego.
- Një herë, një shqiptar hëngri m\*t, u arratis ene u nis si emigrant për në Amerikë. Kujtoj se atje parja ishte sheshit, por i doli huq. Kur e pa veten keq, ra në depresion i shkreti dhe vendosi me vra veten. Hypi në majë të gradaçelit më të naltë të Nju Jorkut ene u hudh prej anej e ra poshtë. Mirëpo nuk e gjeti gjo dreqin. U ngrejt në komë për bukuri të zotit. Njerëzit në rrugë e panë dhe u habitën. E mori vesh gjithë Nju Jorku dhe ja mrinë në vend gazetarë, fotoreporterë, dhe kameramanë. I thonë “*A mund të*

*hidhesh edhe një herë që ta filmojmë.” Ky i thotë:  
“ Hudhem pa problem, por kom frykë që nuk bij mo  
me kokë” Qysh atëherë gjithë bota na thotë që ju  
shqiptarët jeni kokë fortë.*

- Morali Llëro ? – e pyetëm ne.
- **Koka e fortë të shpëton jetën.**

E harruam fare temën e diskutimit të asaj dite dhe ja  
dhamë të qeshurit me të madhe.

Llëri qeshte bashkë me ne dhe më pas mu drejtua mua:

- Tito, na e kap një herë atë ” Ra Faja prej fikut.”

Unë, që nuk ja prishja asnjëherë i thashë:

- Mirë Llëro po do na i këcesh ama.
- Po pa tjetër. A e Don topallçe.
- Po - i them.

Llëri hoqi kapelen dhe filloi kërcimin, kurse unë këngën:

*“ E Ra Faja prej fikut, e Ra faja prej fikut.*

*E si tja boj ashikut, e si tja boj ashikut.*

*Jarina, na, hopa.... e Faja ra ke gropa”*

<https://youtu.be/kBEe1Kh-unI?si=onHkPtZ1UcIb3wjY>

Llëri përthye një rën këngë për të kërcyer topallçe. Të  
tjerët rrihnin shuplaka për të mbajtur ritmin.

Për ne që nuk kishim “ hipur në fik”, jeta vazhdonte.

***Në punën politike të radhës, komisar Gago nuk foli  
më as për P.D. e as për H.Ç.***



*Rrapi i Trishit 1974*

## **Dënimi i Llërit.**

Një ditë na lajmërojnë që të nesërmen, toga jonë do të bënte një marshim luftarak në drejtim të “shkallës së Tujanit” Marshimi përfshinte edhe veprime taktike kështu që do të bëhej me paisje complete. Duhet të merrnim me vehte edhe tamburët me telat e ndërlidhjes edhe telefonat fushorë. Llërin nuk po e zinte vendi. Mendonte si e si ti shmangej marshimit. Rrinte përballë derës së infermierisë dhe po vriste mëndjen të hynte apo jo. Dështe të sajonte ndonjë raport për të mos shkuar në marshim. Vuri re që nga infermiera po dilte Toli.

- E Llëro, edhe ti je i sëmurë.
  - Ashtu mo, kom pak temperaturë.
  - Po shko vizitohu se mos të ka zënë gripi edhe ty.
  - Po shkoj por pak më vonë se ka njerës tani.
- Doli bashkë me Tolin dhe po merrnin rrugën drejt kapanonit.. Për fat, aty pranë kaloi komisar i regjimentit.
- Sokol, mos je gjë i sëmurë që ishe në infermieri? E pyet komisar.
  - Po, shoku komisar, jam pak pa qef.
- Llëri, që me zor e priste këtë rast, ja bëri me sy Tolit dhe i foli komisarit:
- Ene una, shoku komisar.

- Po - shtoi Toli- ishim të dy në infermieri.
- Mirë atëherë, mos hajdeni sot në marshim, paraqituni në mencë për të ndihmuar në guzhinë.
- Si urdhëron shoku komisar - i tha Llëri.



Ai marshim, ishte stërvitja më e vështirë që kam provuar gjatë zborrit pasuniversitar. Mbaj mend që pecet e këmbëve mu zgjidhën dhe këmbët që fërkoheshin me shollën e këpucëve mu skuqën dhe mu mbushën me fluska uji. Trupi më dhimte nga pesha e armës dhe e barabanit që mbaja në sup. Uji i pagures ishte bërë djersë dhe fyti më ishte tharë dhe më digjte nga etja.

Ndërkohë Llëri qëronte patatet në guzhinë.

Por, me sa duket, nuk ishte mjaftuar me kaq. Ndërkohë, që ne “po hanim dynjanë” në marshim, Llëri, i afrohet Tolit dhe i thotë:

- Tole, a ja mbathim për Tironë.
- Mos na thonë gjë – I thotë Toli
- Kush të na thotë. Sot i ke të gjithë ke Shkalla e Tujonit.
- Mirë është të marrim leje.
- Edhe me dash me mor leje, ske kujt i mer. Shefat i ke të gjithë në marshim.

Toli dukej i pavendosur. Por shpirti doli më I fortë se mëndja. Atje poshtë e priste dashuria.

- Mirë, nisemi – tha.

Hoqën përparëset e guzhinës, dhe nxituan të kapnin autobuzin e kinostudios.

Mbas tyre ja mbathën edhe 2 të tjerët që kishin shërbimin e programuar në guzhinë dhe patatet ngelën pa qëruar.

Kë kohën e drekës u kthyem në repart. Na kishte marrë uri ja dhe mezi prisnim që të binte buria për të ngrënë. Por buria po vonohej.

Komisari hyri në guzhinë për të parë gjendjen. Nga jashtë dëgjoheshin të thirrurat e tij:

- Ç'është kjo vonesë sot. Për këtë do të mbani përgjegjësi.
- Shoku komisar, përgjegjësinë ta mbajnë ata që i lanë patatet pa qëru, ne ja mbathën në Tironë - ju përgjegj Nuria, guzhinjerja e repartit.

Komisari u nevrikos dhe provokoi një mbledhje urgjente të shtabit të regjimentit menjëherë pas drekës.

Mbledhja filloi në orën 3 mbas dite dhe mernin pjesë officerët të cilët drejtonin dhe instruktonin togën tonë Hakiu, Xhevati dhe Tahiri.

Komisari e mori fjalën:

- Së pari ju njoftoj se 4 nga studentët kanë hikur pa leje në Tiranë duke lënë edhe detyrën që i kisha ngarkuar në mencë. Midis tyre është edhe Sokoli.

Si rezultat i kësaj, është krijuar edhe vonesa e drekës së sotme. Kërkoj mendimin tuaj.

Fjalën e mori i pari Xhevati:

- Këta persona unë i njoh mirë shoku komisar. Përsa i përket Sokolit, nuk mendoj të jetë ai që e ka organizuar hikjen pa leje. Sa herë që ka dashur leje i kemi dhënë. Sokoli, me natyrën e butë që ka, ka rënë viktimë e shokëve që kanë dashur të përfitojnë. Organizator i asaj që ndodhi sot është Iliri, që për sa e njoh unë, është personazhi më negativ i këtij grupi. Kam dëgjuar që punon tek antena e Dajtit dhe, kur jepen lajmet e Italisë, na e len Papen e Romës që të na bëjë propagandë fetare. Jo vetëm kaq, por kam edhe diçka personale. Disa ditë më parë, ka hyrë në dhomën time me një grup shokësh dhe, mender jush, kanë shkarkuar gjithë pordhët e javës dhe ma kanë qelbur dhomën...

Kur e pa që po e kalonte cakun, komisari e ndërpreu:

- Shoku Xhevat, nuk është kjo tema e jonë sot. Problemi i sotëm është si ti ndërpresim hikjet masive të studenteve nga zborri. Nesër-pasnesër mund të vënë përpara Sokolin dhe të hikin të gjithë në shtëpi dhe ne nuk mund ti dënojmë sepse duhet të dënojmë edhe Sokolin. A e kuptoni sa e rëndë është situata? Ti Tahir çfarë mendon?

Tahiri ngrihet në këmbë dhe duke nderuar me grusht thotë:

- Si urdhëron shoku komisar.

- Qetësohu, shoku Tahir, ulu dhe na thuaj mendimin tënd.
- Unë mendoj që ti dënojmë të gjithë me 2 ditë burg, shoku komisar. Sapo të këthehen të futen të gjithë në dhomën e izolimit dhe çdo 2 orë të lajnë banjat e ushtarëve. Gjithashtu mendoj që deri në fund të zborrit ti hiqet e drejta e lejes për të shkuar në shtëpi.
- Mirë, Faleminderit, do të bisedoj edhe me shokun komandant të regjimentit dhe do tju komunikoj vendimin. Ndërkohë ti Haki mblidh togën pasuniversitare dhe njoftoi për mbledhjen e shtabit e thuaju se jemi në pritje të vendimit të komandës.

Rreth orës 4, Hakiu na rreshton të gjithëve përpara kapanonit. Toli dhe Llëri nuk ishin kthyer akoma.

Hakiu e mori fjalën, pa humbur kohë:

- Që sot e tutje, rregullorja e regjimentit do të zbatohet me rigorozitet sidomos për largimet pa leje. Mbledhja e sotme e shtabit të regjimentit do të marrë masa të rrepta për të 4 personat që mungojnë në apel.
- Edhe për Sokolin do të merren masa – pyet Pëllumbi.
- Edhe për Sokolin, njësoj si për të tjerët. Kështu janë rregullat në ushtri, për ndryshe unë do ta ndjek çështjen deri lart.
- Sa do lart që ta ndjekësh, nuk ke për të zgjidhur dot gjë - i tha Pëllumbi. Dikush që e kishte gati batutën shtoi:
- **Veç po u ankove tek Mao Ce Duni.**

Hakiu nuk qeshte kurrë, por batuta ishte aq e fortë sa që nuk rezistoi dot, ndërkohë që ne po na dhimnin ijet nga të qeshurit. Mbas pak e mblodhi veten dhe vazhdoi:

- Mirë, mire. Shpërndauni tani.

Mbas nja një ore, Llëri u këthye në repart. Roja e la të kalonte, mbasi nuk kishte akoma asnjë vendim për dënimin e tij.

Hyri në kapanon dhe ne e pritëm me këmbët e para, Pëllumbi i foli i pari :

- Llëro, e di si po e bën ti, si ai jevgu që fshihet mbas gaxhojit. Lere Tolin rehat dhe mos ju qep më nga mbrapa, se po i prish punë atij edhe ne të gjithëve.
- Pse çëre ka bo vaki ?
- Ka bo vaki që po të dënojnë ty edhe Tolin sepse keni hik pa leje.

Lëri nuk e priti. Mendonte se do të kishte dal pa u lagur.

- E çere kon vendos?
- Nuk e dimë akoma, Besoj nesër do ta komunikojnë.

Të nesërmen në mëngjes. Toli ishte duke hyrë në repart. Roja e drejtoi tek zyra e komisarit ku i kishin komunikuar një vërejtje me paralajmërim për largimin pa leje.

Pak më vonë komisari thirri në zyrë Llërin dhe dy shokët e tjerë që kishin hikur pa leje për ti komunikuar vendimin e komandës bashkë me të ishin edhe Tahiri, Hakiu dhe Xhevati. Fjalën ja kishin lënë Hakiut:

- Për largimin pa leje 10 ditë shtesë të periudhës së zborit.

Llëri mori fjalën i pari:

- Mu nuk më duket e drejtë që ne të dënohemi dhe Sokoli jo. Kështu që shtesë zborri unë nuk boj.
- Në ushtri komandat, urdhrat dhe vendimet nuk diskutohen por vetëm zbatohen. Tani kthehuni në togë.

Llëri doli nga zyra e komisarit i mërzhitur dhe I nevrikosur. Duke dalë foli me zë të lartë:

- Në ushtri rregullat janë njësoj për të gjithë.  
Kjo shprehje e acaroi Hakiun i cili urdhëroi:
- Ushtar Mema, shko drejt e në dhomë të izolimit!  
Llëri nuk foli dhe u drejtua për në dhomën e izolimit për të kryer dënimin. E shoqëronte instruktor Tahiri i cili ju drejtua gjithë inat:
- Shokët e tu, “ hëngrën dynjanë” dje kurse ti do ta hash sot, më duket.

Llëri e bëri gati pështymën, por e mbajti veten dhe mendoi “Bëj durim o Llër. Do të vijë edhe dita jote”

Dhoma e izolimit luante rrolin e burgut të regjimentit. Ishte një dhomë e vogël. Dritaret ishin me hekura dhe dera mbyllej dhe hapej vetëm nga jashtë. Rrolin e gardianit të burgut e luante ushtari që kryente shërbimin e rojës të regjimentit i cili e hapte derën vetëm për ti sjellë ushqimin dhe për ti shoqëruar në banjë. Çdo 4 orë të dënuarit duhej të pastronin nevojtoret e regjimentit.

Të dënuarit, për tu dalluar nga ushtarët e tjerë, duhet të qëndronin pa kapele dhe pa rrip mesi.

Ajo natë Llërit i kaloj në mendime. Ju kujtua historia e Edmond Dantezit në librin Kontii i Montekristos dhe iu lut zotit: “ **O zot më jep forcë dhe pasuri që ti dënoj padrejtësitë.**”



*Rrapi i Trishit 1974*

## **Shërbimi i rojes.**

Ishte data 23 Tetor. Mbas asaj që ndodhi me ikjen pa leje, Llëri nuk ishte më i qetë. Më vinte keq kur e shikoja që vinte vërdallë nëpër kaponon duke çfryrë dhe sharë nëpër dhëmbë.

- Llëro kam me vehte një libër të bukur që do të ta largojë mëndjen nga halli dhe do të të qetësojë shumë – i thashë.

Ishte ajo periudhë kur nga letërsia e huaj, përktheheshin dhe botoheshin një numër i kufizuar librash. Atë vit ishte botuar, me tirazh të vogël, një libër fantastiko shkencor shumë tërheqës. Me sa më kujtohet titullohej “Udhëtim në vitin 10001”. (Apo diçka e tillë) Librin e kisha marrë me vehte dhe e lexoja në kohën e lirë. Ky libër, ndër të tjera, fliste edhe për evolucionin e njerëzimit dhe kapacitetet e inteligjencës të njeriut në ato vite të ardhshme. Më kujtohet që një nga argumentet ishte komunikimi midis njerëzve të asaj periudhe me anën e energjisë të bio-rrymave të trurit njerëzor. Sipas autorit, me qënë se çdo rrymë gjeneron edhe një fushë

rreth saj (p.sh.rryma elektrike gjeneron një fushë elektromagnetike për rreth), rrymat biologjike të trurit të njeriut , bënin të mundur që mendimi të transmetohej dhe të lexohej nga njerëzit e tjerë. Kjo teori është në studim edhe në ditët e sotme për të spjeguar fenomene të rralla si telepatia.

Në libër shpjegohej që distanca e komunikimit varej nga forca dhe intensiteti i mendimit. Venfosëm që leximin e librit ta bënim me turne. Kur unë mësoja ndonjë këngë në kitarë, Llëri lexonte librin.

- Tito, nigjo çerë thotë këtu...
- Po më le ta lexoj vetë o Llëro.
- Nigjo, nigjo se osht e bukur kjo - dhe filloi të më tregonte:
- Për të matur intensitetin e mendimit, njonin e paskeshin mbyll në një dhomë hermetike. Dritarja e dhomës ishte në tavan dhe e mbyllur me një shul elektronik, i cili hapej vetëm kur forca e mendimit arrinte një nivel të caktuar. Dhomën filluan ta mbushin me ujë. I shkreti rrezikohej të mbytej kështu që kishte filluar të mendonte “ Ah sikur të hapej ai shuli i dritares. Niveli i ujit rritej dhe bashkë me të edhe intensiteti i mendimit. Arriti një moment që truri lëshoi mendimin thirrës “ hapu shul..hapu shul” Forca e mendimit e arriti nivelin e programuar dhe shuli u hap.
- E bukur Llëro, por kjo mbetet fantazi sepse duhet të kesh trurin e njeriut të asaj kohe dhe të kesh edhe ndonjë hall të madh.
- Pse si të duket truni im ty.

- Nuk ta shava trurin o Llër. Por truni i njeriut zhvillohet vazhdimisht, kështu që në atë kohë për të cilën flitet në libër, sigurisht do të jetë më i përsosur.
- E di mor Tit, e di, por kjo gjo, mund të ndodhi edhe sot. Pse, nuk të ka bo ndonjëherë vaki që të kesh të njëjtin mendim me ndonjë tjetër, ose të nigjosh “sa qesh tu e thonë, ma more nga goja.” Po kështu edhe fenomeni i parandjenjës që shpesh kemi të gjithë. Nuk thotë kot populli: “Kujto qenin e boj gati shkopin” Por mo e bukura osht ajo që ndodhi në televizionin Italian. Kom nigju që një konkurrent i programit “rischiatutto”, që quheshe doktor Inardi ja lexonte mendimin prezentatorit Mike Bongiorno dhe fitoi paret e dynjasë rreth 50 milion lireta, dhe masanej o Tito, kur më flet ti për halle, nuk ka hall më të madh se ai që më ka zonë mu. Una kom fillu me fol me vete o Tit dhe me siguri nuk më flet vetëm goja por ene truni. Masanej fenomenet paranormale ekzistojnë edhe tek njerëzit e sotëm. Una e kom vu re me veten time. Ka raste që po të pashë në sy të mor vesh në se po më thu të drejtën apo po më rren.



Unë e kisha ndjekur me shumë interes programin “rischiatutto” dhe isha i bindur që Llëri nuk ja fuste kot. Më kujtohet që

në një nga puntatat Doktor Ilardi kishte fituar një shifër astronomike.( 8.700.000 lire) Mbas kësaj u hapën zëra që Inardi nuk ishte njeri normal por kishte të zhvilluar shumë telepatinë dhe arrinte të lexonte përgjigjet e pyetjeve nga mëndja e Mike Bongornos. Për këtë arsye në seancën e mëvonshme të programit u vendos që Mike të mos i dinte përgjigjet e pyetjeve. Përgjigjet i kishte të shkruara vetëm ndihmësja e tij, Sabina, e cila ishte pozicionuar shumë larg Inardit.

Megjithëatë unë nuk i kisha besuar asnjëherë këto fenomene dhe prandaj e pyeta Llërin:

- Mirë atëherë Llëro, më thuaj çfarë po mendoj unë tashti.

Llëri mi nguli sytë dhe qëndroi pa lëvizur për disa sekonda.

- Nuk marr vesh gjo, por jo për fajn tim, osht sepse ti je njeri pa halle dhe trurin e ke dyst. Truni jot nuk çon asnjë sinjal Tito. Osht tru i qetë, pa bio-rryma. Ndoshta osht ngaqë këndon, i bie kitares dhe e shkarkon mendimin nëpërmjet muzikës

Kur më fliste kështu, më vinte inat dhe ngacmoja më keq:

- Po me kë kompani do ta bosh zborin kur të hikim ne të tjerët. Mos të venë të flesh me atë Hasanin nga Burreli, atë që shënon gola shumë. Më kanë thënë që ka edhe shumë pordhë ai.
- Tito më le rehat të lutem se jom me nerva.
- Mirë atëherë, po të kap këngën e Ijes me kitarë që ta shkarkosh trurin dhe të të bien nervat.

- Vallahi po e kape, kom për ta thy kitarën e kom për ta bo copa-copa. Çere halli kom una, e çere qefi ke tina. Mu po më vlon kapina, tina do me u tall me hallin tem.

Atëherë u largova për ta lënë të qetë, me shpresën që do ti binin nervat.

Mora kitarrën dhe dola jashtë kapanonit. Fillova të përpunoj në kitarë vijën melodike të një pjese klasike për kitarë të J.S. Bach:

<https://youtu.be/SzALPFITbbk?si=oi3nxwmDHjBM57J1>

Këtë pjesë e kisha mësuar nga shoku im Edi, I cili përdorte një kombinim akordesh për të krijuar melodinë e ë saj pjese.

Ishte një kombinim i përsosur të cilin e kisha mësuar por më duheshe më shumë praktikë. Nuk kaluan as 10 minuta kur dëgjoj zërin e Llërit:

- Tito ku e lamë?
- Ke Ija. – I thashë
- Atëherë le ta vazhdojmë.
- Mirë - i thashë dhe fillova ti bie kitarës.

Llëri filloi këngën:

“ Unë ty moj të kom dashte ije,

Prej së vogli deri në pleqëri.. “

Ishte interpretimi më i bukur dhe më pasional i Llërit. Mu duk sikur deshte të shuante gjithë mllëfin që i ishte

mbledhur në shpirt. Këndonte me pasion dhe me sy të lagur nga lotët.

Llëri vazhdoi të këndonte duke e përsëritur këngën dhe unë nuk ja prishja, vazhdoja ta shoqëroja me kitarë. Arriti momenti kur ai e ndaloj këngën dhe më tha:

- Rrofsh Tito se më qetësove.
- Lëro është e rëndësishme që nganjëherë ti shkarkosh bio-rrymat.

Me sa dukej Kënga kishte dalë më e fortë se mendimi i keq.

Edhe tani mbas 50 vjetësh dhurata e parë që ju bëra shokëve të “Radioelektronika74” ishte “ Kënga e ijes” në Italisht.

<https://youtu.be/i5wl5bqRPdg?feature=shared>

Nuk më hiqet nga mëndja ky moment. Aty njoha më mirë Llërin dhe shpirtin e tij. U binda që revoltimi i tij vinte nga një padrejtësi që i ishte bërë. Dhe u mundova ta qetësoj edhe me fjalë:

- Llëro, kam një parandjenjë që çdo gjë do të rregullohet, bëj durim.
- Tito më kupto drejt, Toli osht shok i mirë dhe i du të mirën, nuk du që edhe ai të dënohet si unë, por du që edhe unë të dënohem si ai. Ata jo vetëm që më dënuan keq, por, për protestë, më futën edhe në burg. Prandaj nuk kom mo besim që mund të ndryshojnë mendje.

Kështu pra, edhe mbas këngës së Ijes edhe mbas fjalëve të mia, shqetësimi i Llërit vazhdoi. Inati i shtohej përditë dhe deshte ti ndëshkonte të gjithë ara që e kishin dënuar. Rasti i parë që ju paraqit ishte shërbimi i rojës. Atë natë përgjegjës ndërtese ishte Pëllumbi. Rreth orës 2 të natës Llëri shkon për të ndëruar Tolin. Shërbimi bëhej afër godinës së komandës së repartit. Ishte verë dhe mot i nxehtë. Gjinkallat vazhdonin akoma këngën e tyre. Ishte e vetmja zhurmë që thyente qetësinë e thellë të asaj nate. Kur u afruan, Toli mori qëndrim gaditu dhe raportoi:

- Shoku përgjegjës i ndërresës gjatë shërbimit të rojës nuk kam konstatuar asnjë lëvizje të dyshimtë.

Roja në shërbim ushtar H.

- Ushtar H., Armë zbraz.

Toli, uli armën, I hoqi fishekët nga pushka dhe ja dorëzoi Pëllumbit.

Më pas Pëllumbi dha komandën për ndërrimin e rojeve dhe Llëri mori shërbimin.

Kur Pëllumbi me Tolin u larguan dhe mbeti vetëm, mëndja e Llërit shkoi përsëri tek dënimi që kishte marë. Ky mendim i ishte ngulur si gozhdë në tru dhe nuk i shqitej. Nuk e zinte vendi dhe ishte bërë nervoz. Godiste me forcë guriçkat mbi asfalt për të nxjerrë inatin dhe hapte e mbyllte bajonetën e armës. Mëndja i rrinte si do ta kalonte ditën në zborr kur të gjithë shokët e tij do ishin kthyer nëpër shtëpitë e tyre. Koha kalonte dhe mendimet që bluante në kokë ja shtonin inatin. I kishin thënë që ditët shtesë të zborrit do ti bënte në një nga togat e ushtarëve të regjimentit. Kjo e acaronte edhe më

shumë. Në kokë i rrinte mendimi ”Kanë vendosur të më fusin në një togë kalamajsh ku nuk njoh asnjëri e ku më mungojë shokët, qyfyret dhe gallata e mbrëmjes. Pra më keq se në burg”

U mundua ta hiqte mëndjen nga e keqja dhe të kujtonte diçka të këndëshme po ishte e kotë.

Mendimet ja ndërpreu vetëm silueta e një ushtaraku që po i afrohej vendrojes. Llëri fërkoj sytë që ti dilte mirë gjumi dhe dalloj personin që po afrohej. Ishte një nga oficerët e shtabit të regjimentit.

“O-ho-hoo, një nga ata që më ka dënuar” mendoi.

“Tashti ja rregulloj unë. O do ta bëj që ti mbushi brekët nga frika, o mos më thonçin I.M..”

Llëri i dinte mirë rregullat e shërbimit të rojës. Asnjë oficer i repartit nuk mund ti afrohej vendrojes pa qënë i shoqëruar nga përgjegjësi i ndërresës.

“Ma ka pru zoti peshqesh më duket”, mendoi me vehte.

Në qetësinë e natës dëgjohesh qartë kërcitja e hapave të oficerit mbi asfalt.

E la të afrohej deri në 10m nga vendroja, dhe më pas thirri me zë të lartë:

- Ndal kush kalon!
- Jam oficeri I rojës – u përgjigj oficeri dhe vazhdoi ti afrohej vendrojes. Qëndroi apostafat nën njërin nga neonet e rrugës në mënyrë që drita ti binte në fytyrë. Kështu bëhej i dallueshëm nga roja.
- Ndal se do të qëlloj! - Thirri Llëri me sa fuqi që kishte.

Mbas thirrjes se tij të fuqishme, ra qetësi e plotë, bile edhe gjinkallat u frikësuan dhe e ndërprejnë këngën e tyre. Oficeri qëndronte i pa lëvizur, ja kishte ngulur sytë Llërit dhe nga shprehja e fytyrës, dukej sikur i thoshte.

“Çfarë dreqin do nga unë, çfarë do nga unë?”

Dukej sikur mendimi i tij arrinte deri tek Llëri i cili me anë të një buzëqeshje përçmuese dukej sikur i përgjigjej:

“Dua që të dhitesh në berkë, dua të dhitesh në brekë” mendonte fuqishëm duke shpresuar që tjetri do t’ia lexonte mendimin.

Gjatë shërbimit të rojës biseda ishte e ndaluar. Sipas rregullores, Llëri mund të përdorte vetëm urdhrat “ndal kush kalon” dhe “ndal se do të qëlluj”, ndërsa personi i ndaluar po të fliste, rrezikonte të “hante ndonjë plumb kokës” Në këto kushte mendimet shkëmbeheshin vetëm nëpërmjet shikimit Diçka e çuditshme po ndodhte vërtet, sepse në sytë e oficerit Llëri lexonte këtë përgjigje:

“Nuk ke ç’më bën hiç. Të ma rruash... Të ma rruash...”

Dukej sikur telepatia funksiononte me mënyrën e saj. Përgjigja ja ngriti nervat edhe më keq Llërit dhe nuk duroi më. Lëvizi me shpejtësi shulin aq sa zhurma e ngrehjes së armës u dëgjua deri larg. Pushka mori “fishekun në gojë.”

- Mos lëviz! - komandoi Llëri dhe hoqi siguresën e armës.

Tashti jeta e oficerit varej vetëm nga një lëvizje e gishtit.

Oficeri filloi të dridhej e të mendonte me intensitet të lartë: “Obobo qenka i çmendur ky, çfarë kërkon të bëjë”. Mendimet shkëmbeheshin vetëm me shikime e pa zë, ndërkohë që frika e oficerit kishte arritur kulmin, aq sa ai filloi të dridhej me zë:

- Ëhë..ëëë..

“Ashtu të keqen, mbushi mirë brekët.” mendonte Llëri. “ Më dënuat për largim pa leje ëëë.. Tani do tju dënoj unë me një dhjerje të madhe në brekë aq sa të qelbet i gjithë regjimenti. Ndryshe nuk merni vesh ju.” Vazhdonte të mendonte me sytë e ngulur tek oficeri” Oficeri, e kuptoj se me cilin kishte të bënte dhe filloi të mendonte “obobo është ai që e kemi dënuar. Atëherë, frika ju shtua dhe vazhdoi të dridhej me zë të lartë:

- Ëhë..ëëë..

“ E lëshoi më duket, po i vjen era..” mendoj Llëri.

Pa e kuptuar gishtin e Llërit u vendos mbi këmbëz.

Pëllumbi, që kishte dëgjuar kërcitjen e shulit, po vraponte me shpejtësi drejt vënd rojës. “Prit o Pëllumb se nuk i ka mbushur akoma ky ” thoshte me vehte Llëri.

Pëllumbi e kuptoj që diçka nuk shkonte dhe thirri nga larg:

- Ushtar M. ule armën.

Oficeri dëgjoi zërin e Pëllumbit dhe sikur e mori vehten. Për një moment përkuli pak kokën, gëri lart vetullën e djathtë, shtrembëroi gojën dhe nëpërmjet një buzëqeshje

përçmuese, mendimi i tij mori kurajo dhe filloi të bërtiste.

Llërit ju duk sikur I thoshte:

“Hë pra gjuaj, a ta mban b...a o dhits. Dhits je...”

Atëherë Llëri nuk duroi dot, ngriti lart tytën e pushkës dhe u bë gati të qëllonte në ajër.

Por për fat, në atë moment komunikimi i mendimeve u ndërpre dhe Llëri dëgjoi zërin e trurit të tij që i thërriste:

“Jooo..., ndal..”

U përmend dhe hoqi gishtin nga këmbza. Zëri i brendshëm i foli përsëri.

“Mblihd vehten Llëro. Duhet me i dënu por jo me i vra.”

Mbas disa sekondash Pëllumbi, arriti me një frymë dhe dha komandën:

- Ushtar M., pranë këmbës arm.

Llëri nuk ja vuri veshin. Qëndronte i shtangur me armën në dorë.

- Ushtar M., qetësou! Pranë këmbës arm!

Llëri uli armën dhe oficeri i rojës u qetësua dhe i “erdhi shpirti në vënd”.

Më pas Llëri mori qëndrim gaditu dhe raportoi:

- Shoku përgjegjës i ndëresës, Sot në orën 02:15, një person i pa identifikuar i është afruar zyrave të shtabit të regjimentit dhe për këtë arsye është tentuar të ndalohet nga roja në shërbim, por personi

i pa njohur nuk ka ndaluar edhe mbas thirrjes së rojes "Ndal se do të të qëlluj."

- Ky person nuk është i pa njohur, por është officeri i rojes - i tha Pëllumbi
- Një officer roje që nuk zbaton rregullat e shërbimit të rojes nuk mund të jetë "officer roje", por është ose i pa aftë ose është armik. - shtoi Llëri duke vënë theksin mbi fjalën "armik"

Officeri i rojes, u skuq, gjaku i hipi në kokë, dhe në mënyrë istiktive vuri dorën mbi revolver.

"Qafsha nonën, ky do me më gjujt me gjith men," mendoj fuqishëm Llëri. U shtang dhe u zverdh në fytyrë. Officeri e nuhati dhe e pa me përçmim.

Për një çast, Llërit ju duk sikur mendimi i officerit ju përgjigjej përsëri dhe këtë rradhë ishte ai që komandonte. I dukej sikur I thoshte:

"Hajde mbushi brekët ti tani. Dua që të dhitesh ti në brekë."

Llërit I shkuan pordhët nga frika, por çdo gjë mbeti me kaq e nuk shkoj më tej.

Për fat, Pëllumbi e qetësoi situatën, dhe officeri u mjaftua me kërcënimin:

- Nesër do të përgjigjesh përpara shtabit të regjimentit për kërcënimin me armë që më ke bërë.
- Në shërbimin e rojës unë njoh vetëm përgjegjësin e ndërresës. Ty nuk të njoh fare – ju përgjegj Llëri.

Të nesërmen në mëngjes e pashë Pëllumbin shumë të shqetësuar.

- Pëllumb, çfarë ka bërë vaki?
- Lere - më tha - desh na e vrau officerin e rojes.

Unë që e kisha ndjekur më nga afër shqetësimin e Llërit, i them:

- Llëri me të drejtë është shumë i shqetësuar. Në rastin e dënimit të tij komanda nuk duhej të bënte dallime, mund ti kishte dhënë edhe Llërit një vërejtje dhe puna le të mbyllej me kaq. Unë mendoj që të shkosh tek komisar Gaqoja dhe ti kërkosh, në emër të të gjithë togës, që tja heqin dënimin. Thuaj, po të duash, që ka bërë autokritikë dhe nuk e përsërit më gabimin.
- Po shkoj që tani, se “nuk mban më ujë orizi” tha Pëllumbi dhe u nis në drejtim të shtabit

Të nesërmen Llërit i arritën përgëzimet e komandës si roje shëmbëllore në kryerjen e detyrës luftarake. Komunikimi ju bë Pëllumbit si komandant toge. Atë ditë Pëllumbi na mblodhi dhe na tha:

- Llërin e kanë lavdëruar si roje shëmbullore dhe i kanë hequr dënimin e zborrit shtesë. Llëri u çua në këmbë dhe thirri:
- Rroftë komisar Gaqoja!  
Pastaj filloi të na përqafonte të gjithëve.  
Atë mbrëmje, u mblodhëm edhe për të festuar gëzimin e Llërit.  
Llëri ishte gjithë qef.
- Po pse të lavdëruan Llëro, - pyeti Vasili.

- Sepse kom qenë i zoti.
- Çfarë zotësie ke treguar.
- Kom plagosur rëndë oficerin e rojës.
- Jo.. Llëro, po si ndodhi ?
- I kom gjujt.
- Po si nuk paskemi ndigju asgjë ne o Llëro?

Në atë moment ndërhyt Genci:

- **Veç po ti kesh gjujt me pushkën e Xhejms Bondit. Me atë me sileciator.**

Ne ja dhamë të qeshurit.

Llëri nuk qeshte. Kur ra qetësia, na tha:

- Po qeshni ... ë ? Mirë atëherë, nigjoni këtë barcaletë që ta merni vesh se çere plagosje i kom bo - dhe vazhdoi:

- Ishte një herë një ushtar i ri në luftë. Shkon e i bjen i bjen gjulja në llogore dhe nga shpërthimi i madh u tremb keq dhe e pyet shokun që luftonte në krah “ *O Ded, çfarë ere ka gjaku*”

Deda kishte ngref dy komshin dhe po gjunte me mitraloz.” *Më le rehat se jom i zonë, jom tu vra gjermonët.*”

“ *Aman më thuj..* ”

Deda për ta hek qafe i thotë “*A po më le rehat apo jo. Era m\*t, pra.*”

**“Mos Ded se qënkërkam plagosur rëndë.”**

- A e morët vesh tani se si e kom “plagos rëndë”?
- Po ti ç’thua mo Ilir, po ti na paske qelbur regjimentin o i uruar. - Ja bëri Bakja.

Me pas, Llëri na spjegoi me hollësi se çfarë kishte ndodhur dhe në fund ju drejtua Gencit.

- Kështu Genco, nuk të vret vetëm pushka, por edhe ndërgjegja dhe kur nuk të vret as ndërgjegja për ato që ke bo, të vret mendimi i tjetrit. Sidomos mendimi i atij që e ka shpirtin të vrarë nga padrejtësitë, siç e kisha unë..

**Nga ajo ditë togës tonë ju hoq shërbimi i rojes.**



*Rrapi i Trishit 1974*

## **Kënga e shiut**

**I**shin ditët e fundit të zborrit. Atë ditë Instruktor Xhevati kishte vendosur që stërvitjen e ndërlidhjes ta zhvillonte në një kodër pranë repartit. Po hynte vjeshta dhe kishin filluar shirat e parë. Me qënë se koha ishte e vërejtur, Xhevati na tha që të mernim me vehte edhe mushamatë e zborit. Ngarkuam barabanët me tela e telefonat fushorë dhe marshuam drejt vendit të stërvitjes. Shiu na zuri vërtet por nuk mbajti shumë. Kur doli dielli Xhevati na urdhëroj të bënim 10 minuta pushim përpara stërvitjes.

Ne mezi ç'pritëm, shtruam mushamatë në tokë dhe po shulloheshim në diell. Stërvitja u zhvillua normalisht, dhe në orarin e duhur u këthyhem në repart. Ishim të lodhur. Atë natë dukej sikur të gjithë kishin rënë në gjumë të thellë. Mua nuk po më merte gjumi akoma kur dëgjoj një pëshpëritje, Dikush po fliste me me zë të ulët:

- Booo , nuk po gjej mushamanë.
- A e kishe kur erdhëm nga stërvitja
- Po, ishte pak e lagur dhe e kisha vu me u tha.
- E di ç'ke ti, përlaja ndonjërit këtu afër dhe fute në çantë.

- Mos osht më mire që të pyesim nesër në mëngjes.  
“kush ka gjet ndonjë mushama”
- Po rri o budalla rri, mer një mushama dhe fute në çantë, apo don ta paguash mbas një jave kur të bëjmë dorëzimet.

Ra përsëri qetësia. Unë po mendoja: “ Dikush ka harruar mushamanë tek vendi i stërvitjes. Boo.. do plasi hajdutlliku zinxhir “. Lëviza me ngadalë dhe e fsheha mushamanë nën jastëk. Të nesërmen, para se të dilnim në stërvitje e futa nën dyshek. Natën nuk më zinte gjumi, desha të zbuloja hajdutin, por nuk rezistova dot dhe nga mesi i natës më zuri gjumi. Të nesërmen mu duk sikur jeta vazhdonte e qetë, mbasi asnjë nuk jepte shënja, por në mbrëmje situata ndryshoi. Mbas mesnate, dallova një hije që lëvizte nëpër kabanon.

“ Obo boo” mendova, po vazhdon vjedhja zinxhir. Fillova të rrotullohesha nëpër krevat me shpresën që ta mbaja hajdutin larg nga krevati tim. Dhe ashtu ndodhi vërtet, aksioni përfundoj shpejt dhe unë ja futa gjumit.

Isha i sigurtë që puna e mushamasë nuk ishte zgjidhur. Ashtu ishte, por këtë rradhë vigjilenca ishte rritur shumë dhe pothuajse të gjithë i kishin marrë masat, kështu që “hajduti” vinte vërdallë gjithë natën por pa rezultat konkret. Dëgjoja shpesh të kollitura dhe zhurmë sustash që më jepnin përshtypjen e një mbrojtje pasive nga hajduti i turnit, ndërkohë që gërhitjet në kabanon nuk dëgjoheshin më.” Hajduti spostohej nga krevati në krevat me duar bosh.

Po afroheshe dita e fundit dhe po bënim gati materialet për dorëzim. Para se të shkonim në magazinë dëgjova Tolin që po na pyeste:

- Çuna mos keni gjetur ndonjë mushama.

Unë me zor e mbajta të qeshurën. Llëri I tha:

- Toli sa kërkon kot. Do ta kesh harruar tek fusha e stërvitjes, atë ditën e taktikës. Pyet Instruktor Xhevatini mos di gjë ai.
- Po unë në stërvitje nuk e nxora fare nga çanta.
- Po ti pyete një herë o Toli, se kush e di të gjen ai ndonjë mushama sa për ta dorëzuar.
- Jo, jo nuk shkoj. Më vjen zor.
- Epo mirë, hajde dalim se mos e gjejmë ke vendi ku bëmë stërvitjen.

Llëri më Tolin nuk u vonuan shumë, ndërkohë ne të tjerët u mblodhëm, si për herë, tek sheshi i regjimentit. Kur u kthyhen Vaso i pyeti:

- E çuna a gjetët gjë?
- Jo, asgjë
- Po ku u zhduk xhanëm?

Atëherë Genci e lëshoi batutën e tij.

- **Veç po ta ketë marrë shiu me vehte dhe e ka çu në det...**

Batutat e Gencit ishin të pa pritura dhe ne nuk e mbanim dot të qeshurën. Kur ra qetësia, u dëgjua zëri i Bakes.

- A e patë mbrëmë një hije që lëvizte nëpër kaponon? Me siguri ka qënë ndonjë hajdut. Ai do ta ketë vjedhur mushamanë.
- Po ti që e paske parë, pse nuk bërtite - i tha Genci

- Po çthua mo Genci, jo po të më qëllonte me grusht ai mua.

Kur ra qetësija, Genci lëshoi batutën:

- **Veç po të ketë qënë ndonjë nga togat e ushtarëve.**

Unë fillova të qesh i pari, mbas meje të qeshurën e pasoi, Piroja, mbas tij Apostoli, Kola, Maksi..e kështu me rradhë derisa vala e të qeshurës na përfshiu të gjithëve. Të gjithë e dinim që hajduti fshihej midis nesh. Toli qëndronte I heshtur dhe nuk po e kuptonte të qeshurën tonë. Vërtet ai nuk kishte arsye për të qeshur por së fundi e qeshura e përfshiu edhe atë.

Kur ra përsëri në qetësja, Llëri filloi barcaletën.

- Ishte njoni, si puna e Bakes, I cili kishte frykë nga hajdutët. Nji natë, kishte ra me flejt, dhe nigjon nji zhurmë në ballkon. Çohet dhe sheh nji hajdut i cili po hynte nga ballkoni në dhomën e gjumit. Atëherë del me shpejtësi në korridor, Mbas pak, dera hapet dhe hajduti hyn në koridor. Ky filloi me u dridh prej frykës ne hyni në guzhinë, nga guzhina në sallon dhe më në fund u rras në banjë dhe mbylli derën me çelës. Kur pa që doreza e derës së banjës filloi me lëviz bërtiti “ *Osht e zonë*”

Ishte barcaletë e re, të cilën Llëri po na i tregonte për herë të parë kështu që na ngjiti.

- Morali Llëro- i tha Vaso.

***Kush ka frikë nga hajduti, edhe fshihet në banjë edhe dhitet në brekë.***

Filluam të qeshnim në kor.

- Tito, osht rradha jote- më tha Llëri- dona një kongë për mushamanë.

- Pse a ke ndëgjuar ndonjë këngë për mushamanë ti.
- Hajd mo, na sajo ndonji.

Mu kujtua një këngë Korçare që titullohej “ binte shi” dhe fillova:

*“Binte shiu pa pushuar, ajo pse vonoi  
Mushamanë çë kam harruar, s’di si do tja boj.  
Kalojn orët pika shiu ajo pse vonoi.  
Qull u bëra moj unë I ziu, syzezën kërkoj  
Po pse s’ erdhe ti moj veshë mbrëmë në takim,  
Smë la babi moj me mamanë s’ ishte faji im.”*

- Çuna filloi shiu vërtet – tha Kola - ne nuk po këndojmë as këngë labe.

Dëgjova kërcitjen e pikave të shiut mbi kitarë, por forca e këngës më kishte përfshirë dhe vazhdova:

*“ Binte shiu me lotka shiu ajo pse vonon. Qull u bëra  
moj unë I ziu mushama nuk kom”*

- Çuna, vazhdoni për inat të shiut- tha Llëri duke vazhduar këngën gjithë qef - qull u bona mor un i ziu mushama nuk kom.

U dëgjua zëri I Bakes që po na thërriste:

- Po ç’bëni o budallehje se ju hyri uji në palcë, do të na ftoheni në bithë, do të na ftoheni..e do të na qelbni kapanonin pastaj. Po mjaft tani me këngën e shiut..mjaft.

Atëherë Genci ju përgjegj me këtë batutë:

- **Veç po pushoi shiu i pari, atëherë pushojmë edhe ne.**

Unë me grupin e “ budallenjve” vazhdonim këngën në mes të shiut:


- Po pse s’erdhe ti moj veshë mbrëmë në takim, të besova ndaj të thashë” ti je shpirti im”

*Kreu i dyte*

**Aksioni për elektrifikimin e fshatrave.**







*Dibër 1970*

## **Aksioni i dritës**

Viti 1970 ishte viti i elektrifikimit të plotë të vendit. Ishte parashikuar një aksion i madh vullnetar për elektrifikimin e 1800 fshatrave deri në 25 tetor 1970. Drita elektrike duhet të shkonte në të gjitha shtëpitë e vëndit. Nga ky aksion nuk mund të përjashtoheshe as dega elektrike e fakultetit të inxhinjerisë. Kështu që menjëherë mbas përfundimit të vitit shkollor, na njoftuan se do të niseshim për në aksion.

Studentët e degës elektrike u ndanë në 2 rrethe të vendit. Disa në Dibër dhe disa në Skrapar. Mua më caktuan në rrethin e Dibrës.

Në ditët e para të qershorit. Autobuzi na ndaloi në Fush-Aliaj të rrethit të Dibrës. Aty u ndamë në disa grupe. Mbaj mend që në grupin ku bëja pjesë, ishin gjithashtu Fatmiri, Ximi, Neri dhe Destani. Ne zbritëm nga autobuzi dhe vazhduam rrugën në këmbë drejtim të fshatit Mustafaj. Të tjerët autobuzi i la në zonën e Sinës. Në sinën e poshtme zbritën Apostoli dhe Xhorxhi. Grupi tjetër ndaloi në Sinën e Siperme. Në këtë grup bënë pjesë valzat tona: Alma, Ilira, Tenka, Etleva Tamara si dhe Vali dhe Monda (që vazhduan degën

elektrike). Nga djemtë në grupin e Sinës së sipërme ishin edhe Toli, Llëri, dhe Beso

*Më poshtë një foto e këtij grupi të cilën na e dërgoi Alma.*





*Dibër 1970*

## **Me Fatmirin në Elektrifikim.**

Në atë periudhë shoku im më i ngushtë i shkollës ishte Fatmiri. Me të nuk ndahesha. Rrnim bashkë dhe shpesh mësonim bashkë. Mbaj mend që në matematikë, Fatmiri ishte shumë i zoti dhe shpesh më ndihmonte edhe mua. Prindërit e tij më respektonin sa herë që shkoja për vizitë. Më kujtohet nëna e Fatmirit që më servirte një gliko arrash, që edhe tani që e kujtoj, më shkon goja lëng.

Zbritëm nga autobuzi dhe u vumë në dispozicion të organizatorëve të aksionit. Unë dhe Fatmiri krijuam një grup pune, po kështu bënë edhe të tjerët. Duhet të merrnim pjesë në elektrifikimin e fshatit Mustafaj që ndodhej në një kodër mbi Fushë Aliaj. Ishim të sigurtë që për darkë nuk na priste njeri, kështu që, në Fushë Aliaj hëngrëm paninet që kishim marrë me vehte. Rrema, një nga drejtuesit e Partisë të zonës, na drejtoi për në fshat. Po ngrysej dhe mbas pak do të errësohej

plotësisht. Rrema ndezi baterinë e dorës për të na bërë dritë:

- Djema, duhet tju informoj që banorët e këtij fshati nuk kanë qënë të lidhur me lëvizjen dhe gjatë luftës nuk kanë ndihmuar Partinë, por bajraktarin e Fushë Aliajt duke goditur forcat partizane mbrapa shpine. Mbi 100 partizanë janë vrarë për të çliruar këto zona. Kanë kaluar vite vërtet, por gjithsesi duhet të keni kujdes. Qëndroni bashkë dhe mos u ndani nga njëri tjetri.

Mbas pak Rrema filloi të na shpërndante nëpër shtëpitë e fshatit.


Kur erdhi radha jonë, Deda troket fort në derë dhe thërret:

- O Sami , A pret miq.
- Hajde Bujrum. – dëgjohej një zë nga brenda.
- A i ke lidh qent?
- Po morr burrë po.

Një burrë i gjatë u çfaq tek pragu I derës. Mbante në dorë një llampë vajguri për të na bërë dritë. Na ftoi të hynim brënda.

Deda nuk vonoi të na përshëndeste:

- Haj punë të mbarë djema. Materialet e punës do tja u sjellin nesër në mëngjes. Natën e Mirë.
- Natën - ju përgjegja unë.



*Dibër 1970*

## **Instalimi**

**T**ë nesërmen e mbrijtjes në fshat po qëndronim në pritje të materialeve dhe veglave të punës. Rreth orës 10, Na sjellin materialet:

Tuba plastikë, tela, kuti shpërndarëse , allçi dhe rërë, si edhe disa vegla pune. Projektin e installimit duhet ta krijojmë vetë në vartësi të shtëpisë ku bëhej instalimi.

Fatmiri kishte dhunti për vizatim teknik dhe për fat, kishte marrë me vete edhe laps, vizore dhe një metër robaqepsish për të matur dimensionet e dhomave për të bërë projektin paraprak, si edhe një fletore me kuadrate. Projektin e bënte ai. Fillimisht kontrollonim shtëpinë dhe bënim matjet në të gjitha ambjentet ku do instalonim. Më pas Fatmiri vizatonte në fletore projektin e instalimit të shtëpisë.



Kur projekti ishte gati, me një shkumës, shënonim mbi mure pozicionin e kutive shpërndarëse, prizave dhe çelsave.

Përsa i përsa i përket instalimit, i ndamë punët që në fillim. Fatmiri përgatiste materialet, priste tubat, dhe telat, përgatiste kutitë shpërndarëse dhe kthente tubat duke i mbushur me rërë e duke i nxehur në zjarr. Unë kisha gjetur një palë shkallë dhe i fiksoja në mur sipas projektit të përgatitur. Hapja më parë me daltë e çekiç vrimat e kutive shpërndarëse dhe i fiksoja me allçi. Puna po na ecte. Punonim me pasion dhe me kualitet. Të zotit të shtëpisë i bëhej qefi dhe nuk na shihte më me mosbesim. Për 3 ditë përfunduam instalimin në shtëpinë e parë dhe vazhduam me shtëpi të tjera.



*Dibër 1970*

## **Mikpritja**

Samiu, na drejtoi për në dhomën tonë të gjumit Gruaja e Samiut hyn në dhomë me një legen, ibrikun e ujit dhe një copë peshqiri dhe u bë gati të na lante këmbët.

- Faleminderit i thashë, po mos u mundo se i lajmë vetë.

Gruaja, na priti deri sa lamë këmbët, dhe, u largua pa thënë asnjë fjalë.

Ramë të flinim por gjumi nuk na merte. Kishim hyrë në fshatin e “erësirës” për ti sjellë dritë dhe zhvillim.

Na dukej sikur kishim zbritur në një planet tjetër, Gjuhën e tyre nuk e kuptonim. Midis tyre flisnin në një dialekt të rëndë.

Më kujtohet një nga ditët e para, kur ishim ngjitur në një pemë qershie dhe po hanim gjithë qef qershitë e pjekura. Nën pemë kalojnë disa gra me shtamba uji në kokë. Më e vjetra na drejtohet:

- Or ti voc, hip ati përkie se ke tri kshaja të maira.

Ne nuk u përgjegjëm. Sa u larguan pak, I drejtohem Fatmirit.

- Fate, a more vesh gjë ti.
- Hiç fare.

Gratë e kuptuan që kishin të bënin me të huaj, dhe na treguan me gisht disa qershi që ndodheshin më lart kodrës.

- Oooo.., e mora vesh tha Fatmiri, po na ofrojnë disa qershi më të mira.

Kështu, dal nga dal filluam ti kuptojmë e të bisedojmë me banorët.

Të nesërmen e mbritjes tonë në fshat, që pa gdhirë, i zoti i shtëpisë trokiti në derë për të na ftuar që të hanim mëngjes.

Ky mëngjes, me vezë e gjizë të kripur të skuqura në gjalpë, na u përsërit për gjithë kohën që qëndruam në aksion dhe në çdo shtëpi ku punuam. Për drekë dhe për darkë na nxirnin makarona në formë të rrumbullakët si formë kërmilli, me gjalpë dhe për darkë edhe ndonjë kofshë pule.

Në vënd të kafes, na ofronin nga një gotë qumësht me sheqer.

Nuk pamë asnjëherë fruta ose zarzavate në sofër. Buka e misrit , qumshti, dhalli dhe gjiza nuk mungonte.



Në asnjë shtëpi nuk pamë tavolinë.

Ushqimin e shtronin në sofër ku qëndronim gjithmonë unë, Fatmiri dhe i zoti i shtëpisë. Gratë shërbenin. Në fillim na sillnin ujë me ibrik për të larë

duart dhe më pas ushqimin, por nuk hanin me ne. Fëmijët rrinin larg sofrës.

Një ditë Fatmiri i drejtohet të zotit të shtëpisë:

- Më fal, po na keni nxjerrë shumë për të ngrënë. Një stomak kemi.
- Ani he burrë, se çfarë tepron e hanë gratë dhe cullt (fëmijët).

Unë u shtanga dhe kokra e makaronës më ngeli në fyt. Mu duk sikur po haja racionin e fëmijëve. Për një moment sytë më shkuan në fund të dhomës ku rrinin fëmijët. Mu dukën të uritur e sikur mezi prisnin për të ngrënë. Për një moment mu bë sikur po më numëronin lugët dhe kokrat e makaronave që fusja në gojë. Fatmiri gjithashtu ngeli, uli lugën dhe shtyu tepricë..

- Ja, për të mirë I thashë.
- Ju befte mirë - na u përgjegj i zoti i shtëpisë.

Gratë mblodhën çkishte mbetur dhe e çuan në guzhinë. Mbas pak u dëgjuan lugët që kërcenin mbi tepsi.

- Të shkretët , po hanë si të babëzitur atë që lamë ne- i thashë Fatmirit.

Nga ajo ditë, u munduam të hanim më shpejt dhe vetëm nga një porcion ushqim,

Kjo ishte mikpritja e asaj shtëpie. por vumë re që mikpritja nuk na shoqëronte në çdo shtëpi njësoj. Familjet më të varfëra ishin më mikpritëse, dhe e nderonin mikun me gjithçka që kishin. Shpesh mikpritja lidhej edhe me bindjet politike të personave por në ndonjë rast edhe me interesat personale siç mund të ishte

rasti i ndonjë instalimi shtesë brenda shtëpisë. Udhëzimi ishte që instalimi të bëhej për të gjitha familjet njësoj pa dallim.

Fatmiri më kujton rastin e Azisit, një të dënuari politik që sapo kishte kryer dënimin me 25 vjet burg si bashkëpunëtor me armikun gjatë luftës nacional-çlirimtare.

Azisi ishte i martuar me një grua shumë të shëndoshë, të cilës

asnjë nuk ja dinte emrin mbasi të gjithë i thërrisnin “Lopa e Azisit”. Shtëpinë e tij po e instalonin 3 nga shokët tanë. Azisi kur e mori vesh që edhe në shtëpinë e tij do të vinte drita elektrike, sa nuk fluturonte nga gëzimi. Doli në oborr me gjithë “Lopën” e tij për ti pritur shokët tanë. Grupi përbëhej nga Ximi , Neri dhe nga Destani. Azisi nuk dinte kë të falënderonte për këtë “nder” që edhe shtëpia e një të dënuari politik mund të vinte drita elektrike. Filloi ti bënte shokëve tanë një trajtim të veçantë. I mbante me ushqime të zgjedhura, me fruta bile edhe me raki.

Sidomos në ditën e parë, si dita që prezantonte mikpritjen, rrakia nuk u kursye. Të gjithë u bënë tapë , bile edhe “ Lopa”. I pari që u deh, ishte Azisi. Si zakonisht, ai filloi me urimet e mirëseardhjes.

- Mirë se na keni ardh, he burra. Në shtëpinë e Azisit do të gjeni të gjitha të mirat.
- Mirëse ju gjetëm – foli Ximi.  
dhe e ngriti gotën me fund. Të tjerët e pasuan. Azisi kishte nxjerrë raki të mirë dhe për të ngrënë kishte me bollëk. Për seicilin kishte therur nga një pulë.

Kur erdhi në qief, filloi të tregonte historitë e jetës së tij.

- Të gjithë më thonë që nuk kam qenë me fat në jetë.
- Pse Aziz– e pyeti Neri.
- Po ja, që u lidha me bajraktarin. Po në ato vite he burra, ajo ishte zgjedhja e vetme. Këtu tek ne bajraktari ishte zot. Kush lidhej me të kishte fitime, të tjerët mbeteshin rrjepacakë. Arrita me u ba adjutant personal i Muharem bajraktarit dhe kam luftu për të në të gjithë Shqipërinë. Bile kena luftu edhe në jug deri në Vlorë kundër partizanëve.

Ximi, dëgjonte gjithë kureshtje historitë e Azizit. I jati i tij kishte qenë partizan në jug të vendit dhe pikërisht atje ku kishte luftuar Azizi. Pa dashur bëlbëzoi.

- Po pse nuk thua o Azis që më paske shpëtuar jetën. Po të më kishe vrarë babën, nuk do të isha as unë sot. Ximit i kishin hipur nervat dhe nuk dinte si të reagonte. E mbajti vehten dhe në fund të tregimit të Azizit e mori fjalën dhe tha:
- Të shkuara të harruara o Aziz. Ti dënimin e ke kryer në rregull, kështu që edhe në shtëpinë tënde do të vijë drita ashtu si në gjithë shtëpitë e tjera.
- Të lumtë goja dhe ju lumshin duart të gjithëve. Po e ngre këtë gotë për shëndetin tuaj.

Dollitë vazhduan deri në mëngjes sa që edhe “Lopa” u deh dhe ja mori këngës. Në fakt Azizi e vinte gruan në krye të tavolinës. Për 25 vjet rresht, ajo kishte qenë burrë dhe grua në atë shtëpi. Veç kësaj burgu i kishte bërë mirë dhe ja kishte ndryshuar konceptet dhe zakonet për trajtimin e gruas.



*Dibër 1970*

## **Kenga dhe Çiftelia**

**P**othuajse çdo shtëpi kishte nga një çifteli të varur në mur.

Çdo mbrëmje, I zoti shtëpisë merte çiftelinë, dhe na këndonte ndonjë këngë. Shumica ishin këngë historike, që tregonin për trimëritë e treguar në luftërat kundër Serbëve. Nuk mbaj mend të këndonin qasnjë këngë për Partinë.

Një ditë po bënim installimin në shtëpinë e Selimit. Selimi i shte njëri nga rapsodët më të njohur të fshatit që i binte çiftelisë dhe këndonte bukur. Melodia e këngëve më dukej shumë e ngjashme. Ai që i jepte forcë këngës së tij ishte teksti.

Këngët me çifteli, të kënduara brez pas brezi kishin evoluar shpesh edhe në përmbajtjen dhe tekstin e këngës. Me dëshirën për ti dhënë më forcë mendimit, në disa këngë epike, fjalët ishin ndryshuar dhe kuptimi ishte deformuar. Kjo bënte shpesh që tekstit të këngës ti humbiste realiteti dhe shpesh edhe logjika. Në një nga këngët historike që përshkruante një luftë midis Dibranëve dhe Mirditorëve teksti kishte dalë jashtë

logjike. Selimi e këndonte plot pasion dhe krenari. Kënga tregonte se si Dibranët i kishin hedhur Mirditorët në Drin dhe ju kishin shkaktuar 20.000 të vrarë

Fatmiri filloi të qeshte:

- Gjithë Mirdita ka apo ska 8000 burra, ku i gjetën këto 20.000 veta
- Po kështu thotë kënga.
- Po ti që e këndon si thua?
- Lere Fatmir - i them – kjo këngë ka kaluar nga goja në gojë dhe është bërë si “telefon i prishur” diku ka kaluar nga 2000 në 20.000 dhe ka ardhur deri tek Selimi. Ky jo vetëm që i beson tekstit por e këndon edhe me krenari.

Më pas i drejtohem Selimit:

- Selim a e di ti sa banorë ka Shqipëria?
- Jo. Nuk më kujtohet.
- Ju Dibranët na e paskeni lënë Shqipërinë e vogël o Selim, sepse na i keni vrarë gjithë katolikët - i them.

Selimi u zu në faj dhe e la çiftelinë më njanë.

- Nuk këndoj më për ju – na tha - gjyshi im është vrarë në luftë kundër Mirditorëve kurse ju talleni me lavdinë e tij.
- Nuk kemi asgjë me gjyshin tënd - i thotë Fatmiri. - Fëmijët e tu që shkojnë në shkollë, do ta dallojnë menjëherë gabimin dhe nuk do ta këndojnë më. Pastaj le ti harrojmë këto këngë që ndjellin vëlla vrasje.

Selimi nuk foli. Mori çiftelinë dhe u largua.

Selimi kishte një tufë kalamaj, të ciët, duke më treguar kitarën më pyetën:

- A i bjen kësaj çiftelisë me 6 tela?
- Po - I thashë- quhet kitarë.
- A po na merr edhe ti ndonjë këngë ?

Kisha mësuar disa këngë popullore dibrane dhe i këndoja me qef:

- *Oj zogo, oj zogo jelek me vija oj zone...Ai ke pa, ai ke pa shoqet e mija, ai ke pa.. I kam pa moj nën një hije tuj u ba gati për nusrie.*

<https://youtu.be/Xp5BiKQQ1uM?si=wUMBHrcT-88lPI81>

Isha mësuar që këngën time ta pëlqenin dhe shpesh ta shoqëronin, por këtu ndodhi e kundërta, Asnjë nuk e njihte këngën time.

Më dëgjonin gjithë kureshtje, e pëlqenin muzikën por këngën nuk e njihnin e nuk e kishin dëgjuar.

- Është këngë e krahinës tuaj- i thashë.
- Aaa, nuk e kena nigju noi herë

Mbeta për një çast, por shpejt e kuptova arësyen.

Në një vënd pa energji elektrike, ku nuk kishte asnjë aparat radio, të vetmet këngë që njiheshin ishin ato që trasmetoheshin nga brezi në brez dhe nga shtëpia në shtëpi, por mbeteshin brënda katundit. Ndërsa këngët që dija unë i kisha dëgjuar në radio. Aty kuptova që isha vërtet në një botë tjetër me gjuhë të panjohur dhe me

zakone të panjohura. Nuk e di se si mu dha dhe i bëra zë fëmijëve që të më afroheshin.

- A doni me i ra kitarës edhe ju? A po doni që tju mësoj këtë këngë?

Fëmijët ishin kureshtarë dhe u afruan menjëherë.

- Po axha Petrit - më thanë - dhe filluan të më ndiqnin në këngë

Këndonin edhe ata bashkë me mua. Kënga ishte e bukur dhe tërheqëse. Pak më vonë u afrua edhe i jati I fëmijëve, mori në dorë çiftelinë dhe filloi të më shoqëronte. Këndonim të gjithë së bashku.

- Hajde Fate, futu edhe ti në këngë – i thashë Fatmirit.

Kurioziteti i “ çiftelisë me 6 tela” dhe bukuria e këngës, thirri në koncert edhe fëmijët e fqinjëve aty pranë. U mbusha me gëzim dhe fillova të këndoja gjithë pasion:

- *I kam pa moj nën një hije, tuju ba gati për nusërie*  
Fëmijët që shkonin në shkollë, filluan të shkruanin dhe shpërndanin tekstin e këngës. Tashmë forca e këngës i kishte përfshirë të gjithë

- *I kam pa mor nën një hije, tuju ba gati për nusërie..*  
Kishin kaluar disa ditë dhe ne po përfundonim instalimet në fshatin fqinj, kur I zoti I shtëpisë na përshëndeti:

- Du me ju përshëndet me një këngë të re që e kena mësu këto ditë.  
- Pa ta ndëgjojmë - i thashë.  
- Oj thëllanxë oj thëllanxë thëllanxa e malit.  
Ai ke ba çorapet e djalit.

Atëherë orë mora kitarën dhe vazhdova bashkë me ta.

- I kam ba e i kam qëndise, lule më lule i kam ujdise.

***Kënga kishte “mare dhenë” dhe po përhapej nga katundi në katund.***



*Dibër 1970*

## **Besimi**

**B**anorët e fshatrave ku u bë elektrifikimi ishin të fesë myslimane. Megjithë çensurën e vendosur mbi besimin, shumë zakone fetare ishin ruajtur. Xhamija e fshatit ishte e mbyllur, por vumë re që shtëpitë ishin kthyer në vënde falje. Banorët faleshin për ditë në kohën që ne punonim.

Por ajo që na prishte punë nuk ishte feja, por injoranca e theksuar që sundonte vendin. Mu kujtua shprehja e Ajnshtajnit “*stresin më të madh ta japin njerëzit injorantë.*” Kjo injorancë na vinte shpesh në vështirësi gjatë bisedave që kishim me ta. Një mbrëmje, tek po rrinin në oborrin e shtëpisë ku bënim instalimin filloi një shi vere me shkrepëtima dhe bubullima. I zoti I shtëpisë, Saidiu na thërret që të hynim brenda:

- Shpejt futuni në shtëpi se “shtrigat” janë egërsuar keq dhe kanë filluar luftën me “burrat dragoi”.

Hyjmë në shtëpi dhe shohim të zonjën e shtëpisë duke folur me vehte.

- Çfarë ka ndodhur? – pyeti Fatmiri.
- Ka filluar lufta e qiellit. Shtrigat me dragojt.
- Shkrepëtimat dhe bubullimat janë fenomene të natyrës, janë retë e ngarkuara me elektricitet që shkarkojnë njëra me tjetrën – u mundua tja shpjegonte Fatmiri.

- Po ti a ke sy në ballë, hajde me mu që ti tregoj.  
Dolëm përjashta dhe Sajdiu drejtoj gishtin nga retë:
- A e sheh këtë renë këtu afër? A nuk të duket që ka formën e një njeriu.
- Pak a shumë.
- Ai është një “burrë dragua”, shih tani kur të qëllojë me flakë atë shtrigën që ka afër.  
Vetëtimat vazhdonin në qiell por “burri dragua” nuk po qëllonte akoma. Sajdiu qëndronte i heshtur dhe priste vetëtimën. Bashkë me të edhe ne. Mbas 2 minutash në qiell u duk vetëtima. Shkarkimi ishte i fuqishëm. Sajdiu u hodh përpjetë.
- A e patë si e qëlloj me flakë?
- Po, po ajo është vetëtimë dhe nuk ka lidhje as me “burrë dragua” dhe as me “grua shtrigë”
- Sajdi, duhet të shkosh në shkollë që ti mësosh. – i thashë.
- Kjo punë nuk do shkollë se duket me sy, po ty or voc ti ka marrë mendë shkolla dhe të ka lanë pa sy.  
Sajdiu me të shoqen vazhdonin të insistonin për të na mbushur mendjen. Hikëm me vrap dhe u mbyllëm në dhomën tonë, por ata na u qepën dhe vazhdonin të na flisnin.
- Dilni të shihni një tjetër “burrë dragua” që po qëllon një “grua shtrigë”.  
Ishim zënë ngushtë vërtet .
- Fatmir, na mbytën injorantët – i them – nuk dimë ku të futemi. Për fat shiu i verës pushoi shpejt, retë u shkarkuan dhe “gratë shtriga” u zhdukën.

***Lufta mbaroi, si gjithmonë me fitoren e “burrave dragoj”***



*Dibër 1970*

## **Kutia e shkrepse.**

**I**shin ditët e fundit të aksionit tonë të elektrifikimit, kur hymë në shtëpinë e Ismailit. Duhej të ishte shtëpia e fundit që instalonim. I zoti I shtëpisë doli të na priste sipas zakonit duke na uruar mirëseardhjen dhe na kërkoi ta prisnim pak në oborr sa të përcillte një mik. U ulëm në një stol dhe për të kaluar kohën fillova të luaja një vijë metodike në kitarë. Një vajzë e vogël po vinte vërdallë nëpër oborr dhe po dëgjonte tingujt e kitarës. U afrua ngadalë dhe filloi të prekte telat e kitarës, pastaj vraponte përsëri në oborr dhe vinte të prekte përsëri ndonjë tel. Unë i buzëqeshja dhe ajo vazhdonte lojën e saj. Nuk kaloi shumë dhe Ismaili u duk te dera i shoqëruar nga miku i tij. Mbante në dorë një kuti shkrepse megjithëse asnjë nga ne nuk pinte duhan.

- Hava maj, Hajde e përshnete axha Syrin.

Havaja e vogël vazhdonte lojën e saj dhe nuk ja ndante sytë kitarës. Kaçurreli i verdhë që i binte mbi sytë e zezë, ja shtonte bukurinë fëminore.

Ti nuk më kap dot..ee, ti nuk më kap dot..e vazhdonte të më drejtohej mua duke vrapuar nëpër oborr.

Ndërkohë Ismaili dhe miku i tij na u afruan për të na përshëndetur.

- Këta janë punëtorët e elektrikut - na prezantoi Ismaili.

Ne u ngritëm në këmbë dhe e përshëndetëm.

Mbas pak miku u largua dhe ne mbetëm me Ismailin dhe me Havanë. Ismaili vazhdonte të shtrëngonte gjithë qef kutinë e shkrepeses sikur ajo të fshihte një pasuri të madhe. Më pas mori në krahë Havanë e vogël dhe filloi ta puthte e të sillej rrotull bashkë me të. Papritur kutia e shkrepeses i bije nga dora. Unë e mora dhe i thashë.

- Faleminderit po ne nuk e pimë duhanin.
- Hajdeni he burra se zoti ju ka pru në shtëpinë time që të më sillni jo vetëm dritë por edhe një gëzim të madh. Prandaj du me e festu me ju gëzimin tim.

Ne nuk po kuptonim asgjë.

- Gëzime paçim gjithmonë o Ismail, por do të ishim të lumtur edhe ne që ta dinim gëzimin tënd. – i thashë.
- Ju, ju ka dërgu zoti dhe keni hy me këmbë të mbarë në shpinë time.

Më pas thirri me të madhe:

- O Fatma.
- Urdhno.
- Hajde moj se u kry.
- Ooo lumja une, O e lumja une. Ooo desh zoti.

Fatimja, një grua e shëndoshë doli me vrap në oborr, Nga Gëzimi i madh harroi të na përshëndeste, mori në krahë Havanë e vogël dhe po e puthte fort. Lotët nuk i përmbante dot.

Unë me Fatmirin qëndronim të shtangur dhe nuk po kuptonim asgjë. Bëja pyetjen: “Çlidhje kishte Havaja me kutinë e shkrepeses.”

Pak më vonë Fatma u kujtua për prezencën tonë dhe na përshëndeti.

- Ardhshi gjithmonë të bardhë se na keni pru sot një gëzim të madh - na tha Fatimja dhe nxitoi të na mbushte nga një gotë raki.
- Hajde gjithmonë gëzime paçi - tha Fatmiri dhe e ngriti me fund gotën e rakisë. Me qënëse nuk deshën të hapeshin, ne nuk u bëmë shumë kuriazë të pyesnim më shumë. Ra heshtja. Kjo si duket e bëri Ismailin që të hapej më shumë:
- Sot kena dhanë fjalën për Havanë. Deri sa jeni këtu duhet ti njihni edhe zakonet tona. Këtu tek na fëmijët i martojmë që të vegjël.

Megjithse kisha dëgjuar që në malësi fëmijët i martojnë që në djep, kur e prek këtë realitet të krijohet një shtrëngim në zemër. Ajo vajzë 5 vjeçare që 5 minuta më parë luante me mua duke ngacmuar telat e kitarës tani rezultonte e martuar.

Por më e tmerrshme ishte ajo që erdhi pas.

Fatimen e hante akoma merakun të merte vesh diçka. Ja bëri me shenjë Ismailit dhe bashkoi gishtin e madh me atë tregues sikur po e pyeste “Sa?”

Ismaili i zgjati kutinë e shkrepes. Unë ndiqja me sy çdo lëvizje të tyre. Fatimja e zbrazti dhe filloi të numëronte një nga një fijet e shkrepes që kishte brenda. Më pas i shndriti fytyra, I futi me kujdes fijet e shkrepes në kuti dhe ja ktheu të shoqit. Kur e kuptova që flitej për shitjen e një fëmije 5 vjeç, mu përzie, dola në rrugë dhe “ nxora zorrët”.

Të zotët e shtëpisë u shqetësuan. Fatmiri e vuri re dhe duke e kuptuar shqetësimin tim ju thotë:

- Mos ja vini re, por ai nuk e mban rakinë.

Kështu u justifikuam për tu ndarë me ta dhe për të shkuar në dhomën tonë. Erdhi mbrëmja dhe ramë të flinim. Nuk më zinte gjumi. Veshët më oshëtinin nga zëri fëminor i Havasë së vogël: “ Ti nuk më kap dot..Ti nuk më kap dot.” Pa pritur ndjeva që një pikë lot më shkau mbi faqe. “ Vërtet nuk e ndihmoja dot këtë fëmijë që po e mbyllte jetën në moshën 5 vjeçare”

Fatmiri e kuptoi shqetësimin tim dhe më tha:

- Petrit, qetësohu dhe fli gjumë se nesër flasim me të jatin.

Të nesërmen në mëngjes, Fatimja erdhi të na servirte mëngjesin. Kishte përgatitur vezë me gjizë të kripur dhe një filxhan qumësht me sheqer. I thamë se deshëm të flisnim me Ismailin dhe se e prisnim në oborr.

Ismaili nuk u vonua. Na gjeti në oborr duke përgatitur materialet e instalimit.

- Ismail si ke njerë sot mbas marrëveshjes së martesës.
- Unë mirë, Po ty a të bani dëm rakia?
- Dëgjo Ismail, nuk e kisha nga rakia. Të them të drejtën u shqetësova për fatin e Havasë së vogël. Më fal, nuk është detyra ime të vendos për fatin e saj, por kur flitet për fejesë e martesë mendoj që këtë nuk duhet ta vendosni as ju si prind. Lëreni të rritet, të piqet e të vendosi vetë për fatin e saj. Uroj që ti thërrisni mendjes për të mirën e vajzës tuaj.
- Ti vjen nga një botë tjetër or voc. Ne këtu kemi zakonet tona dhe ne i respektojmë zakonet. Sipas këtyre zakoneve për fatin e vajzës vendosim ne dhe

jo ti. Prandaj shih punën që të na sjellësh dritën në shtëpi, atë bëj ti.

Ismaili u ngrit dhe u largua duke më lënë pa përgjigje.

E kuptova që po i flisja një veshi të shurdhët. Zakoni në ato anë bënte ligjin.

Nuk e di sa kishim influencuar për të sjellë të renë në këto fshatra, por lufta kundër injorancës dhe zakonit nuk ishte fituar akoma. Ndoshta drita jonë do të sillte edhe kulturë e zakone të reja.

Historia e kutisë së shkrepse u muar vesh edhe nga grupet e tjera të punës. Një nga profesorët që na shoqëronte në aksion vendosi ta bisedojë me një nga fshatarët.

- O Sul, a nuk më thua si është ky zajoni i shkrepse këtu tek ju.
- Profesor, meqënëse je beqar, a do me ta dhanë gocën time. Nuk kërkoj fije shkrepse prej teje. Ma jep kutinë bosh, mjafton që vajza ime të vijë në Tiranë.

Gjatë kësaj periudhe konstatuam probleme të mëdha në familjet që rridhnin nga martesat “me shkrepse.”

Kjo vihej re sidomos në mënyrën e si na silleshin vajzat e fshatit.

Shpesh themi që morali i femrës varet nga edukata e marrë në familje dhe kultura e marrë në shkollë, për ndryshe pasionet bëhen primare, të pakontrolluara dhe influencojnë dukshëm në moralin e femrës.

Sipas “zakonit të shkrepse”, prindi e kishte bërë “dalje” vajzën që në moshë të vogël dhe përgjegjësia për

moralin e saj, ishte e pa konsiderueshme, mbasi prindi kishte dorëzuar tek “blerësi” një vajzë të virgjër. Nga ana tjetër, “Blerësi” ja kishte dorëzuar të birit vajzën i cili duhej të trajtonte edhe moralin e saj. Shpesh, ky i fundit nuk e çonte as në shkollë dhe e linte pa kulturë. Pra këto vajza mbeteshin pa edukatë dhe pa kulturë morale. Në ato anë, dasmat bëheshin përpara se djali të shkonte ushtar. Shpesh na takonte që, në shtëpitë ku instalonim të ndeshim vajza të reja që i kishin burrat ushtarë.

Qëllonte që na bënin edhe ndonjë shërbim kur mungonte e zonja e shtëpisë. Nuk mungonin bile as provokimet që na bëheshin.

- Kujdes Fate, se ti paska ngulur sytë keq kjo katundarja - i thashë një ditë Fatmirit.

Fatmiri ishte djalë i turpshëm dhe u skuq në fytyrë.

Mesa dukej, kjo gjë nuk i shpëtoi syrit të të zotit të shtëpisë dhe që nga ajo ditë, vajzën nuk e lanë që të na afrohej më. Ishte e pa evitueshme që ky fenomen të ndodhte edhe me shokë të tjerë.

Në përfundim të aksionit të elektrifikimit, komiteti i partisë i rrethit të Dibrës organizoi një mbrëmje falenderimi, ku morëm pjesë të gjithë.

Aty morëm vesh edhe lajmet për incidentet që kishin ndodhur me 2 nga shokët tanë: njërin e kishte ngrënë qeni dhe e kishin shtruar në spitalin e peshkopisë, ***kurse tjetrin e kishte “ngrënë” një femër por, për fat, ishte shëndosh e mirë.***



*Skrapar 1970*

## **Grupi i Skraparit**

**G**jatë aksioneve dhe zborreve, jo vetëm takoheshim por jetonim së bashku në komunitet, kështu që edhe mbresat e kujtimeve janë më të forta dhe rrojnë më shumë në kujtesë.

*Në datën 10 Qershor 2024, hapa “dritaren e kujtimeve” dhe gjej 2 kujtime interesante të Gëzimit dhe Kolit, të cilat lidhen me aksionin e elektrifikimit. Këto mëfrymëzuan për të shkruar sa më poshtë:*

Ishte fundi i Qershorit i vitit 1970. Autobuzi I aksionistëve ndaloj në zonën e Tomorricës, pranë malit Tomorr. Aty zbriti edhe grupi i studentëve tanë i përbërë nga Gëzimi, Telo, Koli, Maksi, Janaqi, Ademi, Kosta dhe Mysreti. Grupi morri rrugën në këmbë për të arritur në fshatin Cerricë. Rrugës ndaluan në qendrën e zonës, në fshatin Gjerbes. Në dyqanin e fshatit, Telos i zënë sytë një model syresh dielli me xhama të errëta.

- Ej, Çuna, Unë them të blemë nga një palë syze si këto
- Telo, i do që ti shesësh tangërllek katundarve të Skraparit – i thotë Kosta.

- Edhe për atë, por më shumë si një shënjë që e dallon grupin tonë nga të tjerët. Jemi shokë apo jo. Syzet do të na lidhin edhe më shumë.
- Mirë, mirë..., po ku e gjete këtë model xhanëm, Jemi bërë si makinat e legatave me xham të zi. - vazhdoi bisedën Kosta.

Grupi me syze dielli, vazhdoi rrugën drejt fshatit Cerricë. Atje u ndanë në dy grupe dhe filluan punën. Për punën nuk ka kujtime, por një kujtim i bukur për të gjithë grupin mbetet pikniku i organizuar me rastin e 10 Korrikut.

Atë ditë “grupi i syzeve të diellit” kishte vendosur të bënte një piknik në një luginë afër fshatit. Dukej që e kishin organizuar mirë mbasi kishin blerë një qingj të mirë, dhe nuk mungonte as rakia e as veglat e gatimit. Por mbi të gjitha nuk mungonte kasapi. Kishin me vehte Ademin që ja thoshte mirë këtij zanati. I jati I Ademit punonte si kasap në Delvinë dhe Ademi e kishte mësuar zanatin prej tij. Të tjerët nuk mernin vesh nga qingjat. Dinin vetëm të bënin beee..., dhe të hanin mish qingji të pjekur. Kështu Ademi mori drejtimin dhe organizimin e punës. I ndau menjëherë detyrat, Maksi, Janaqi dhe Telo morën detyrën të mblidhni dru dhe shkarpa të thata për zjarr, Kosta me Mysretin duhet të ndiznin zjarrin dhe ti hidhnin sa më shumë dru.

Ndërkohë që vetë Ademi përgatiti hellin dhe 2 kraba për ta mbështetur.

Gëzimin dhe Kolin i mbajti afër për ta ndihmuar në therje, larje zorrësh e plëncash dhe përgatitjen e

kukurecit. Puna filloi me qef. Objektivi ishte i qartë: të hanin mish qingji e të pinin raki.

Ademi zgjodhi vendin ku do therte qingjin. Gjeti një vënd pranë një burimi me ujë të ftohtë, ku më pas do të laheshin të brendshmet e do të përgatitej kukureci.

Mbasi e therri, e vari me kokëposhtë në pemë dhe filloi ti rinte lëkurën. Preu më parë lëkurën në pjesën e këmbëve të pasme dhe filloi të frynte ajër ndërmjet lëkurës dhe mishit. Lëkura e qingjit u fry.

- Çfar po na bën o Kasap, gajde po na bën? – i tha Koli me shaka.
- Po o Koli një gajde për ty që ti biesh se i bie bukur.

Ajri nën lëkurë e ndihmoi Ademin që ta ripte shpejt e shpejt qingjin. Më pas i preu barkun dhe i nxori të brendshmet në tepsë.

- Punën e keni gati tani – i thotë Gëzimit e Kolit.- duhet të lani mirë e mirë të brendshmet, sidomos zorrët për të bërë kukurecin.

Ademi ishte vërtet mjeshtër në përgatitjen e qingjit. Mbasi e përshkoi hellin në trupin e qingjit, ja lidhi mirë kurrizin dhe këmbët mbas hellit dhe e bëri gati për ta pjekur. Më pas, e preu pak me thikë në tulet e të dy kofshëve dhe e mbushi me kripë dhe erëza. Ndërkohë zjarri ishte gati. E mbështeti hellin mbi 2 krabat mbajtëse dhe instruktori pjekësit.

- Filloni ta rrotullon ngadalë duke e larguar pak zjarrin. Duhet që mishi të piqet dhe helli të mos digjet.

Pjekja vazhdonte nën drejtimin e Ademit, ndërkohë që Koli me Gëzimin ishin mbrapa me larjen e kukurecit.

- Nuk pastrohet kollaj dreqi - thotë Gëzimi -unë për vete u lodha.
- Dakord, e lemë me kaq, po mos i thua asnjëriut se mos ja shpifim. Unë dhe ti nuk hamë kukurec.

Të tjerëve ju bëftë mirë.

- Duhet ta qepim gojën se ndryshe e pësojmë si guzhinjeri i mbretit. E di atë të mbretit dhe kukurecit Koli?
- Hë, si është.
- Ishte një mbret që e hante shumë kukurecin. Një ditë një fshatar i solli një copë kukurec për ti bërë qefin. Mbretit i pëlqeu shumë dhe e mori në oborrin e tij si guzhinier. Nga ajo ditë mbreti nuk ngopej duke ngrënë kukurec. Një ditë mbreti i kërkon sekretin e gatimit të kukurecit dhe fshatari u detyrua tja tregoj.”Lartmadhëri, sekreti është tek larja e zorrëve, Unë i lë pak të palara dhe ajo i jep lezet”

Mbreti u revoltua, urdhëroi që ta thernin si qingj, zorrët tja bënin kukurec dhe tja hidhnin qenve. Që atë ditë mbreti nuk hëngri më kukurec.”

Koli me Gëzimin vazhduan me lidhjen e kukurecit dhe i vunë në zjarr për tu pjekur.

Pjekja e qingjit në hell u hapi oreksin dhe mezi po duronin që ti suleshin mishit të pjekur. Ju shkante goja

lëng. Telo, që rrotullonte hellin, fuste ndonjë copë lëkure në gojë.

- Telo duro sa të bëhet. – i thotë Mysreti.
- Atë po bëj po e provoj a është bërë apo jo.

Më në fund Ademi vendosi ta heqë qingjin nga helli. E zbrazti mishin mbi tepsi dhe e preu copa copa. Mbas pak u poq edhe kukureci dhe çdo gjë ishte gati.

- Hajd na bëftë mirë tha Ademi- dhe futi në gojë copën e parë të mishit.

Mbas tij sulmuan edhe të tjerët. Kush e kush të hante sa më shumë mish.

Sic kujton Gëzimi:

*“Per 1/2 ore mbaroj tepsia me rreth 17 kile mish dhe kukurecin. Kosta me Shaka tha, Sokolit gjate gjithë kohes nuk I pash fytyren, vetem qafen, pasi mer mish e ha “*

- Mmm..edhe kukureci i mirë paska dalë tha Telo.
- Ha Telo ha, se është kukrec mbreti ky – i tha Gëzimi që mezi mbante të qeshurin.
- Ju lumshin duart ty dhe Kolit që e keni përgatitur. Po ju pse nuk po e provoni?
- Duam që ti kënaqim shokët më parë, pastaj, po teproi..

*Vetëm tani mbas 50 vjetësh, Telo, Maksi e Ademi marin vesh se çfarë kukureci kanë ngrënë.*

- Ja gëzuar festën e ushtrisë - tha Kosta dhe ngriti dollinë e parë. Mbas tij ngritën dolli të gjithë me radhë duke kaluar dorë më dorë shishen e rakisë.

Rakia e Skraparit ishte e fortë dhe i solli në qef.

- A çdo duheshe kitarja e Titit sot.- tha Gëzimi. Telo na merr një lapçe se ta mbaj unë.
- Di një lapçe nga Zagoria që më pëlqen shumë.

Hajdeni djema ma mbani- ju tha Telo.

Nuk u muar vesh kush këndonte e kush mbante ison, po kënga mori zjarr:

- *Në krua more shoko ,Ëëëëëëë,*  
*Në krua të Qestoratit,*  
*Dalinë more shoko, Ëëëëëëëë,*  
*Dalinë çupat e fshatit.*  
*Me balu.. more shoko,Ëëëëëëëë*  
*Me baluket si të hatit.*  
*Shkon sarka.. more shoko.Ëëëëëëëë.*  
*Shkon Sarkadhja monopatit.*
- Ngrihuni të kërceni se po ju merr gjumi o syze-zinj  
- ju tha Kosta me shaka dhe u vu në krye të valles.

Deshin të kërcenin por këllqet nuk i mbanin në këmbë dhe filluan të këputeshin njëri pas tjetrit nga lodhja.

Këtu Gëzimi e përfundon kujtimin e tij:

*“Ishte shume e lezeteshme, u kenaqem, pastaj na vinte gjume, pak nga rakia, pasi 4 nga ne ishim tek 19 vjec dhe nuk ishim nesuar te pinim”.*

*Kreu i trete*

## **Me Shoqërinë e Universitetit**







*Tiranë- Sarandë 1973*

## **Ekskursioni**

**I**shte 15 prill i vitit 1973. Të nesërmen në mëngjes do të niseshim për një eskursion 2 ditor në jug të vëndit.

Gjëja e parë që duhej të merrja vesh atë mbrëmje ishte parashikimi i motit, për të vendosur çfarë duhej të vishja gjatë rrugës e çfarë duhej të merrja me vete. Në atë moment nuk më interesonte fare nëse këto rroba ishin apo jo të modës. Por nuk mund të ishte kështu për të gjithë. Vajzat e grupit mund të kishin qef që ti zgjidhnin veshjet për të rënë pak në sy. “Këq nuk do bëjnë”, mendova, “do të na zbukurojnë grupin.” Pranvera e bulevardit të Tiranës do të na vazhdonte edhe gjatë ekskursionit. Vajzat i kishim si “ujët e pakët” dhe mundoheshin që ti ruanim e ti mbronim.

Si gjithmonë edhe atë mbrëmje u ula pranë televizionit dhe po prisja të mbaronin lajmet. Në orën 8.30, në ekranin e Televizorit duhej shfaqej Petriti, Gazetari i programit “Moti sot dhe nesër” Petriti ishte një personash simpatik që i kishte hyrë në zemër telespektatorëve. Të gjithë qëndronim të heshtur përpara ekranin për të marrë vesh nëse të nesërmen do të bënte nxehtë, apo ftohtë, do të binte shi apo do të frynte erë.

Parashikimet e tija në shumicën e rasteve ishin të sakta. Petriti e njihte mirë zanatin e tij.

Më përpara mblidhte të gjitha informacionet e motit që vinin nga shtetet fqinje si dhe nga stacionet meteorologjike të vendit, i përpunonte dhe në mbrëmje i paraqiste në televizion. Shtrirja e vogël sipërfaqësore e vendit tonë e ndihmonte Petritin që të kishte sukses në parashikim. Por moti ishte shpesh kapriçoz dhe nuk i bindej metodës së Petritit. Kështu kishte ndodhur, në fakt, edhe një natë më përpara. Por nuk i dhashë aspak rëndësi këtij fakti. Vazhdoja të prisja me pa durim përpara ekranit. Motra e vogël, Anila po luante me kukullën e saj Sonin dhe po mundohej ta vinte në gjumë

- Fli tani të keqen mami se është ora 8.- Dhe vazhdonte me këngën e saj të përnatëshme
- Nani nani Sonin ooo, zere gjumë, rrite shumë
- Shsht se dua të dëgjoj kohën – i thashë, por në ekran në vend të Petritit, u çfaq një tabelë me vlerat e temperaturës dhe të reshjeve nëpër rrethe.

Parashikimi për Gjirokastrë e Sarandë ishte për kohë të mirë, ditë pranverore



Të them të drejtën nuk më ngjiti. Petriti me paraqitjen dhe me zërin e tij, sikur të hipnotizonte dhe ta mbushte mendjen. U vura në merak dhe mu kujtua ç’i kishte ndodhur një vit më parë:

Si çdo ditë, edhe atë ditë, Petriti ishte nisur për në televizion. Një person me një “dërrasë mangut” i kishte prerë rrugën duke e kërcënuar.

“ Dje më gënjeve, më the që do të jetë koha e mirë dhe unë hoqa tjegullat dhe zbulova çatinë. Tani për dëmin që më ke bërë.. meriton një dru na, na..“ dhe e kishte qëlluar me grusht në fytyrë.

Petriti i shkretë kishte rënë në tokë i gjakosur. E kishin çuar me urgjencë në spital.

Kur e mora vesh, më erdhi shumë keq për të që na ishte bërë si i shtëpisë.

Sigurisht të gjithë e kuptojnë që fenomenet e natyrës shpesh janë të pa parashikueshme dhe ajo që i ndodhi Petritit ishte një rastësi, por kur flasim për modën, e vitit 1973 është krejt ndryshe, ndryshimi ishte i parashikuar dhe bile, kishte filluar.

Në Tiranë ndryshimi ishte më i ngadaltë dhe nuk ra shpejt në sy, kurse në rrethe ishte shumë më i shpejtë edhe për shkak të popullsisë më të vogël dhe të rasteve më të pakta të modës së huaj.

Për fat të keq këtë ndryshim të madh ndërmjet modës së Tiranës dhe Gjirokastrës nuk e parashikuam dot.

U nisëm në ekskursion me ato rroba që vishnim përditë në Tiranë qoftë në shkollë e qoftë në rrugë. Po në fund të fundit ne ato rroba kishim xhanëm, nuk mund të qepnim të tjera për ekskursionin dhe nuk kishte shumë për të zgjedhur, mbasi gardërobën nuk e kishim plot me rroba.

Si përfundim ndodhi ajo që ndodhi. Në qoftë se Petriti që nuk e parashikoi mirë motin, takoi në rrugë një

hundëlesh, dhe hëngri një grusht, ne që nuk e parashikuam mirë ndryshimin e modës, “hëngrëm” kritika dhe vërejtje të cilat i kujtojmë akoma mbas 50 vjetësh.

Ata funksionarë të universitetit që provokuan më vonë mbledhjet për të na kritikuar, na shihnin për ditë me këto rroba ose veshje të ngjashme në universitet dhe nuk na thoshin asnjë fjalë. Po kështu ata që na ndaluan në Gjirokastër, ishin në gjendje të kuptonin që flitej akoma për udhëzime dhe aplikimi i tyre në Tiranë ishte më e ngadaltë, kështu që mundet vetëm të na këshillonin e të kërkonin largimin tonë në mënyrë më të sjellshme.

Viktimë e këtij qëndrimi të pa përgjegjshëm nga të dyja palët u bënë vajzat tona por bashkë me to dhe ne të gjithë së bashku që “hëngrëm” një Fletë Rrufe të madhe sa një çarçaf në hyrje të universitetit.

Të tjerët bënë vetëm garë kush e kush të demonstronte më shumë “partishmëri.”

Po si u zhvillua ekskursioni jonë?

*Është data 2 qershor 2024 e kanë kaluar mbi 50 vjet nga ajo ditë. Jam duke shkruar pjesën e dytë të librit “Kujtime dhe Këngë.” Më kujtohet, por nuk mbaj mënd zhvillimin e plotë të ngjarjeve gjatë ekskursionit dhe veçanërisht incidentin e Gjirokastrës. Në këtë rast kënga më çonte më shumë brenda autobusit ku kemi edhe kënduar. Vendosa të pyes shokët. Për fat të mirë këto ditë Pirro dhe Maksi kanë krijuar një grup në “WhatsApp”, kështu që I ftova të gjithë të jepnin mendime Në fakt e*

*ndjej edhe si detyrim për ta përshkruar me vërtetësi ngjarjen. Vetëm në sajë të mendimeve të shokëve arrita ta kompletoj idenë. Rrol shumë të rëndësishëm luajti edhe takimi që pata dje me Apostolin i cili më tregoi kujtimet e tij në lidhje me ekskursionin. Kështu si rezultat i mendimit të të gjithëve vendosa shkruaj si më poshtë:*

16 prill i vitit 1973.

Atë mëngjes u ngrita herët. Mamaja që kishte merak, ishte çuar më herët akoma dhe më kishte përgatitur mëngjesin. Unë isha veshur dhe isha bërë gati. Mamaja filloi nga porositë:

- Dhe rrugës ki kujdes të keqen mami, shiko edhe vehten, mos bëj vetëm xhungër-xhungër me kitarë, se të janë bërë gishtat copë.

Të këndosh vetëm këngët tona,.. dëgjon, mos më bëj “viu-viu” me ato këngë të huaja që këndon. Kujto tët atë që e ke të sëmurë e mos e shqetëso më shumë.

- Po moj mami, mos u bëj merak - i thashë  
Isha vonë, nxitova të merja valixhen e kitarën dhe u nisa.

U takuam rreth orës 8 të mëngjesit në hyrje të universitetit. Në sheshin përballë na priste një autobuz i madh turistash ku mund të zinin vënd që të gjithë.

Nuk vonoi shumë autobuzi u mbush dhe ne u nisëm. Si drejtues i eskursionit ishte caktuar Jakupi një nga pedagogët që do të na shpjegonte edhe organizimin dhe funksionimin e stacionit radiofonik të Cërrikut.

Në Cerrik, në gjysmën e dytë të viteve 60, ishin instaluar disa radiotransmetuesa me valë të shkurta, 15 kW dhe 50kW, që sëbashku me qendrën radiotransmetuese me valë të mesme të Fllakës realizonin transmetimin e programeve të Radio Tiranës në shqip për bashkëatdhetarët dhe në gjuhë të huaj. Ing. Jakupi, që kishte punuar aty së bashku me pedagogë të tjerë si edhe me bashkëstudentët edhe me shokët tanë të kursit Vasilin, Pavlinën dhe Pëllumbin, që ishin me ne në ekskursion, na spjegoi funksionimin e stacionit. Të gjithë transmetuesat ishin me llampa dhe që ne i kishim studjuar tashmë nëpërmjet leksioneve të dhëna nga pedagogët tanë. Qëllimi kryesor i vizitës ishte që të njihnim aplikimin praktik të njohurive të mara në shkollë. Aparaturat ishin instaluar dhe kolauduar nga inxhinierët e teknikët kinezë së bashku me tanët. Radiostacioni ishte modern për kohën, dhe shumë funksional, Programet e Radio Tiranës transmetoheshin në mbi 40 gjuhë të huaja dhe duke marrë parasysh përhapjen e valëve të shkurta nëpërmjet jonosferës, këto programe dëgjoheshin deri në Australi, hemisfera lindore dhe deri në Kanada,

Në stacion arritëm rreth orës 9. Jakupi u tregua i shkathët, i dha drejtim punës dhe për 1 orë përfundua leksionin dhe vizitën në radiostacion. Nuk na mbetej tjetër veç se të fillonim odisenë turistike. Ja hipëm autobuzit dhe morëm drejtimin e Fierit. Sapo kishim bërë nja 10 km e kishim dalë në rrugë kryesore ja filluam këngës .

Në këto lloje grumbullimeve shoqërore më ka pëlqyer gjithmonë që kënga të ndizet me forcë dhe të këndojmë të gjithë. Kjo më ka bërë që të mësoj këngë nga të gjitha krahinat e vendit. Kitara si instrument shkon më tepër me këngë qytetare Korçare e shkodrane por edhe me këngë përmetare e me të Shqipërisë së mesme. Krijova një re maxhore në kitarë dhe fillova:

*“Një ditë shkova nga drenova një ditë shko.*

*Një ditë shkova nga Drenova, pashë një vajzë të re..”*

Kaq ishte, u ndezëm. këngët pasonin njëra tjetrën si një potpuri e zgjatur Korçare që nuk mbaronte kurrë:

- *O moj ti që ri tek porta, mos dëgjo se ç’thonë bota,  
se bota na kanë haset, plaç me gojë pse së flet.*

Dhe më pas:

- *Kur vjen behari dhe qershia,  
vajzat e bukura faqkat pa puthura  
andej këndeje kërkojnë djemtë...*

Pashë që edhe shoferi erdhi në qef dhe po këndonte me zë të ulët:

- *Me ato to to to,  
lipsur qofshin këto,  
kur kujtoja vathuren në kurbet,  
o ri ri ri riri  
në Shqipëri në Shqipëri  
vënd i bukur për dashuri.*

U gëzova që edhe ai e kishte marrë me këngë rrugën. Atëherë, për ti bërë qefin, e ndërpreva potpurinë e stërzgatur Korçare dhe i kërkoja shokëve qetësi:

- Çuna kam një propozim. Dua që të këndojmë një këngë për shoferin tonë të dashur që do të na shoqërojë për 3 ditë rresht - dhe nxora nga arkivi një këngë të viteve 60 titulluar “ Kënga e shoferit”

Fillova:

*“Që nga Durrësi në Bulqizë, rrugë e gjatë gjarpëron,  
si harusha nëpër male, skoda ime fluturon....*

*Ty ty ty bien buria,*

*Me kadal se bagëtia e kan mushun rrugën plot,*

*Mos u tremni dhent e e mija,*

*skoda ime ju don fort.”*

<https://youtu.be/4U4VWF2qhsQ?si=RPxd-6jsrVecZ04Y>

Shoferi sa s’fluturonte nga qefi dhe na shoqëronte me burine e makinës:

*Ty ty ty bije buria..*

*Ty ty tu bije buria..*

Pa dashur sytë më shkuan tek tabela “Mos i fol shoferit” dhe ndërrova menjëherë akord.

Me qenë se po hynim në Lushnjë mu kujtua e madhja Vaçe Zela dhe vazhdova me disa këngë të saj:

*“ Në një arë në një o moj lëndinë,*

*trëndelinë moj trëndelinë,*

*Janë 2 vajza tek o moj po rrin*

*ë, trëndelinë moj trëndelinë.*

[https://youtu.be/1YvteuBzdHM?si=\\_g89wzjFJAu0MN9](https://youtu.be/1YvteuBzdHM?si=_g89wzjFJAu0MN9)

[p](#)

Dhe:

*“Je sot ma e bukura mes lulesh lule, djell pranveror.*

*Flokët e tua ndrisin spërkatur me ar diellor.”*

<https://youtu.be/XYuFDGvbMTo?si=k5ia5zUTOa3h56X0>

Në Fier arrijmë në kohën e drekës. Pak të lodhur nga rruga por plot humor. Autobusi na ndaloj tek hotel turizmi. Nëna e Yllit punonte në sportelin e Hotelit dhe na ndihmoi që të sistemoheshim. Të nesërmen në mëngjes, pasi bëmë disa fotografi në qendër të qytetit, u nisëm herët për të vazhduar rrugën drejt Sarandës dhe Butrintit.

Sapo hipëm në autobus Nikollaqi më bën një kërkesë.

- Petja na bëj edhe ne të kujtojmë rininë tonë të hershme kur ishim me studime në B.S.

- Pa tjetër I thashë.

Në fakt, babai kishte mbaruar shkollën në B.S kështu që edhe në shtëpi këndonim ndonjëherë edhe në rusisht.

Nikollaqi ju afrua mikrofonit të autobusit dhe komunikoi:

Për ju Petja ofron disa këngë të rinisë tonë në B.S.

Grupi i oficerëve më dhuroi duartrokitje të cilat më inkurajuan që të filloja me këngët ruse që dija:

*“Oçi çionnaje oçi strastnie,  
oçi Sguçie, i prekrasnie,  
Kak lubju ja vas,  
Kak bojus ja vas..”*

[https://youtu.be/MZUWmOL3ChM?si=kJ\\_De4wtOESf2TL6](https://youtu.be/MZUWmOL3ChM?si=kJ_De4wtOESf2TL6)

Më pas grupi i këngëtarëve në rusisht vazhdoi me këngën “pad moskovnie vjeçera”

<https://youtu.be/KairmsARpyo?si=A-cgmio4aDJbzwUT>

Nikollaqi, drejtonte grupim e tyre dhe lëvizte lart e poshtë nëpër autobus, duke i ftuar të gjithë në këngë. Mbante në dorë një laps dhe bënte rrolin e dirigjentit. Kuptova që këto këngë ju sillnin kujtime të bukura dhe u përpoqa që ti kënaq. Aq shumë u pasionuan mbas këngës sa që nuk e fshehën dot mallëngjimin në sytë e tyre. Mendova që kishte ardhur momenti ti çoja në këmbë për ti larguar nga malinkonia prandaj vazhdova me:

*“Hei lin ka ka lin ka ka linka maja.*

*Vzadu ja goda kalin, ka ka linka maja.*

*Hei lin ka ka lin ka ka linka maja.”*

[https://youtu.be/0hlETuS8vyA?si=UiBLcedd\\_zFNwvNf](https://youtu.be/0hlETuS8vyA?si=UiBLcedd_zFNwvNf)

Nikollaqi nuk u përmbajt, filloi të kërcente kozakshe duke rrahur thembrat me shuplaka e duke kryqëzuar duart në gjoks. E pashë që këngëtarët në rusisht nuk ndaleshin ndërsa të tjerët që nuk e dinin tekstin e këngës përplasnin shuplakat për të mbajtur ritmin. Desha ti fusja të gjithë në këngë e në valle, prandaj zgjodha një këngë ruse të përkthyer në shqip, të cilën e këndonim në Korçë:

*“E puthi veshën kozaku dhe me sy të përlotur,  
pastaj vrap kaliti hapin që të arrinte shokët.  
Hajde hajde dhe hajde në një fushë të gjelbër,  
ndalet vesha Kozare dhe kozaku i saj.”*

Kënga ishte një këngë Kozake, prandaj grupi i këngëtarëve në rusisht vazhdoi pa ndërprerje kërcimin, por me ta u bashkuan të gjithë. U krijua kështu mundësia për tu rikthyer me këngë në Korçë. U bëra gati të vazhdoja, por dëgjova zërin e Jakupit:

- Një sekondë. Dreka është parashikuar të hahet në Tepelenë, kështu që bëhuni gati për të zbritur.

Ndaluam në ujin e ftohtë të Tepelenës, hëngrëm nga një panine dhe mbasi shijua ujin e burimeve të Tepelenës, bëmë disa foto dhe u nisëm drejt Sarandës.-

Mbas nisjes, kënga kaloi nga Moska në Korçë nga *Pad moskovskie vjeçera.. në o moj Korçare sa e bukur je*  
Unë kur hyj në repertorin e këngëve Korçare, vështirë se dal kollaj. Kështu që vazhdova me:

*Syçka si ato të tuat nuk gjenden në fynja, lum ai që i ka shijuar frikë nga vdekja nuk ka...*

*Ky pazari i Korçës ka vajza pa masë, dalin e shëtisin pa lejen e mamasë..*

*Perëndeshë e bukurisë më je, unë për ty moj do të pëlcam... e të tjera.*

Isha zhytur në këngët Korçare kur dëgjoj:

- Çuna deti..shihni detin.

Për ti shoqëruar pamjet e bukura të detit, mora kitarën dhe fillova:

*“Se vinka deti mi lale o tallaz tallaze.*

*O ç’më ka zon o mi shpirto sevdaja ma gaze”*

<https://youtu.be/oIGANKjeh4M?si=Q-Kl7Goc5gDizMK>  
[B](#)

Dy durrsakët e grupit, Koli me Metin mu afruan dhe po më shoqëronin. Këndonin gjithë pasion duke lëkundur trupin. Dukej sikur ishin dehur nga kënga. Kënga vazhdoi me :

*“Jam bandill një trim i fort,*

*zemërohem kot e kot,*

*boj durim e sduroj dot*

*nat e ditë po qaj me lot.”*

Mu duk me vënd që shpirti i mrekullueshëm i Shqipërisë së mesme të shpërthente në valle:

*“E ra Faja prej fikut,*

*e ra Faja prej fikut,*

*e nuk e zu dekiku e nuk e zu dekiku.”*

[https://youtu.be/nbZeFZiiVu8?si=0PMHrfOQNXvvDm](https://youtu.be/nbZeFZiiVu8?si=0PMHrfOQNXvvDmnU)  
[nU](#)

Për ti dhënë gjallëri grupit, çifti durrsak u nda. Meti nxori shaminë dhe filloi vallen, Me të u bashkua gjithë autobuzi. Koli nga qefi, hoqi këpucët dhe hipi mbi sedilje. Që andej drejtonte me duar e me këmbë

valltarët. Mbas pak Jakupi mori mikrofonin për të uruar mirëseardhjen në Sarandë duke shtuar:

- Ju kërkoj të mos largohemi shumë nga autobusi mbasi mbas pak do të nisemi për në Butrint.

Dolëm nga autobusi vetëm për tu ç'mpirë e për të thithur ajrin e detit

Në atë kohë, Butrinti si zonë kufitare mund të vizitohet vetëm me leje nga policia. Jakupi, nxitoi të na nxirrte lejen dhe për më pak se 1 orë, formalitetet ishin gati.

U nisëm drejt Butrintit dhe ja dhashë fjalën Telos që kishte talent si imitues. Ai filloi të imitonte komentatorin sportiv Anton Mazreku. Shtrëngoi hundën me gishta, për të ndërruar frekuencën e zërit, dhe filloi transmetimin:

- Të dashur ndëgjues, jemi në lidhje të drejtpërdrejtë me stadiumin Qemal Stafa të kryeqytetit për trasmetimin e ndeshjes midis skuadrave të Partizanit dhe 17 Nëntorit të Tiranës.

Në skuadrën e Partizanit kishte futur të gjithë oficerat e grupit dhe portiere kishte vënë Tamarën. Kurse tek 17 Nëntori bënim pjesë ne Tiranast me portiere Ilirën.

Telo ishte mjeshtër në trasmetim dhe i tërhoqi të gjithë me komentimet e një ndeshje të improvizuar. Edhe shoferi merrte pjesë në ndeshje. Sa herë që bëhej gol i binte borisë ndërsa të tjerët brohorisnin dhe pastaj i fusnin nga një të qeshur mbasi e kuptonin që ishin në autobus dhe jo në stadium.

Ishte hera e parë që vizitoja Butrintin. Më bënë përshtypje amfiteatri dhe busti i Deas, perëndeshës së bukurisë së grekëve të lashtë. Nuk mund ti linim pa foto

këto 2 vende. U grumbulluam dhe u ulëm të gjithë në shkallët e amfiteatrit, duke fiksuar një nga



kujtimet më të bukura të këtij ekskursioni. Një tjetër foto origjinale mbetet ajo kur Piroja është duke puthur Dean. Shokatë e asaj dite nuk kanë të numëruara. Vërtet u kënaqëm.

Butrinti ishte një vënd me bukuri natyrore dhe me bimësi subtropikale. Dikush kujtoi që kishte qënë i pasur edhe me zvarranike sidomos me gjarpërinj. Në kohën kur Krushovi kishte vizituar Butrintin, qeveria, kishte dhënë urdhër që të helmoheshin gjithë gjarpërinjtë. Që atëherë, që atëherë, gjarpërinj nuk kishte më.

Butrinti është vend i vogël dhe vizita mbaroi shpejt. Në mesditë u kthyem në Sarandë.

Kishim prenotuar hotelin në Gjirokastër, kështu që nuk u vonuam shumë, mbasi hëngrëm bukë dhe bëmë një shëtitje bregut të detit, morëm rrugën e kthimit. Nuk harruam edhe fotot në grup të cilat na kujtojnë këtë vizitë.

Visita e bukur në Butrint e Sarandë, na kishte mbushur me frymëzim i cili, sa hipëm në autobus, shpërtheu nëpërmjet këngës.

I pari që u afrua në këngë ishte Bakja.

Bakja ishte person simpatik, që shkonte mirë me të gjithë, prandaj e kishim zgjedhur edhe sekretar të rinisë të grupit.

Piroja kujton takimin e parë me Baken, gjatë praktikës që bënim në vitit të parë në universitet.

- Bashkim Mehmeti - i ishte prezantuar Bakja
- Po nga të kemi o Bashkim? E kishte pyetur Pirua.
- Nga qyteti - i ishte përgjigjur Bakja.
- Po Çthua mo, nga qyteti jemi të gjithë, edhe unë nga qyteti jam nuk jam nga fshati.
- Nga Qyteti Stalin. – ishte korrigjuar Bakja.

Më pas kishin lëshuar një aaaa të zgjatur dhe kishin filluar të qeshnin.

Kjo batutë e prezantimit të parë i kishte mbetur në mëndje Piros edhe mbas 50 vjetëve.

Edhe me mua Bakja kishte krijuar shoqëri, kur kishim raste këndonim bashkë me kitarë.

- Bake - i them,- le tja marrim edhe një nga ana jote:  
*“Nëm ujë se pla o jasa moj çupë e Beratit  
Skam me se të ta ja o japë pëllumb i Tomorit.”*

[https://youtu.be/STBQAN0k\\_Es?si=EcThxi77Xgh5qJ-6](https://youtu.be/STBQAN0k_Es?si=EcThxi77Xgh5qJ-6)

Nuk e ndërpreva këngën, kalova në La minore, dhe vazhdova me një këngë të njohur përmetare:

*Mora çiftin dola për gjah, jaman shoko jaman jaman.*

*O çiftin me gjithë zagar, jaman shoko more jaman  
jaman*

<https://youtu.be/8YsxHTispBA?si=jOANH7dlAIH1xLn>

[A](#)

Kënga dhe Vallja përmetare vazhdoi deri sa hymë në Gjirokastër.

Më në fund, rreth orës 6 të mbrëmjes arritëm në Gjirokastër. Jakupi mori në dorë mikrofonin dhe na foli:

- Ju uroj pushim të mbarë. Çlodhuni dhe merni vehten. Nesër në orën 10 do të marrim rrugën e kthimit për në Tiranë.

Ndjehesha shumë i lodhur, gishtat e dorës së majtë më ishin nxirë nga presioni mbi tela dhe më dhimnim.

Përveç telave rezervë, kisha marë me vehte edhe një shishe me alkool për ti dezinfektuar.

Nga ora 7 hëngra darkë dhe rashë të flija. Lindja e diellit të ditës së nesërme, premtonte mot të mirë. Mëngjesin e hëngrëm lehtë, dhe u nisëm për të vizituar qytetin. U ndamë në grupe dhe filluam shëtitjen.

Unë u bashkova me grupin që do të vizitonte kalanë

Kalaja e Gjirokastrës ishte një surprizë për mua, që dilja rrallë nga Tirana. Ishte vërtet një legjendë. Kishim caktuar orarin e nisjes dhe nuk u vonuam më shumë se 2 orë.

Ndërkohë një grup që përbëhej nga Telo dhe Apostoli, kishin shkuar ti bënë vizitë familjarëve të tyre.

Telo dhe Apostoli u nisën të takonin hallën që banonin në qytet.

Në lidhje me këtë vizitë Apostoli kujton:

“Pas mëngjesit në Turizmin e Gjirokastrës unë dhe Telo zbritëm në lagjen 18 Shtatori për të takuar një hallën tonë që banonte aty. Futemi në shtëpi, takohemi të përmalluar me të dhe me burrin e saj që ne e thërrisnin “basho Nika”. Nikollaq Shkurti ishte një burrë interesant dhe i kulturuar, mbi 70-at, prej shumë vitesh në pension, ish nëpunës i Bankës së Shtetit në Gjirokastrë. Ai ishte ulur pranë një prej atyre etazherëve klasikë të asaj kohe ku në mes vendosej televizori ose radio. Ai po dëgjonte radion, me volum të ulur dhe ne i themi;

- basho Nika, pse ja ke ulur zërin radios sa mezi e dëgjon, se ne këtu ku jemi ulur nuk dëgjojmë asgjë
- djema, po ta ngrë volumin më shumë shkoj kështu dhe kryqëzoi duart siç veprojnë njerëzit kur arrestohen.

Ne qeshëm me të madhe, por me ç'ndodhi më vonë tek autobusi, na bëri të reflektojmë për këtë "gjysëm të vërtetë".

Në qytetet e vogla ku të gjithë e njohin njëri tjetrin, udhëzimet që kalonin nga qendra në organet lokale të pushtetit, mesa duket zbatoheshin në mënyrë shumë sektare."

Kishim caktuar orarin e nisjes dhe nuk u vonuam më shumë se 2 orë. Rrugës ndoqa me sy vajzat e grupit, Ishim veshur vërtet bukur, dhe binin shumë në sy. Ilira kujton që kishte veshur një palë pantallona gri terital që i shkonin shumë

Etleva kujton që Tenka ishte veshur me një palë pantallona bezhë që i rrinin bukur. Të them të drejtën Etleva vishej gjithmonë thjeshtë, edhe jo vetëm për arsye të pozicionit shoqëror të familjes së saj por edhe për vetë karakterin e saj si njeri. Edhe në ekskursion nuk ra në sy për veshje të ekzagjeruar, ndërkohë që grupi Tenka, Ilira e Tamara u bënë objekt vëzhgimi dhe diskutimi. Të parat ishin vajzat Gjirokastrite të cilat i shikonin me zili dhe i komentonin. Në më pak se 1 orë lajmi kishte marrë dhenë dhe kishte shkuar edhe në vesh të organizatës së rinisë të qytetit. Mbas vizitës u drejtuam për tek sheshi i Çerçiz Topullit ku na priste autobusi. Kur u kthyem, përballë autobusit pamë një

grup të rinjsh që po na prisnin. Po kërkonin informacione në lidhje me ne, kush ishim e nga vinim. Një nga vajzat e grupit të të rinjve shkoi më tej :

- Në Gjirokastrën tonë nuk pranojmë shfaqe të modës së huaj prandaj nuk lejojmë të na vizitoni qytetin me këto veshje. - na tha dhe bëri me shenjë Tenkën.

Në fakt Tenka kishte veshur një palë pantallona që i theksonin pjesët e bukura të trupit të saj, por që për sytë e mi nuk kishin asgjë të ekzagjeruar. Po ti vishje në Tiranë ishin më se normale.

Tenka, për mua, ishte një vajzë simpatike, sidomos kur fliste të bënte për vehte me mënyrën e saj të llastimit femëror që i jepte një barrë lezet, veç kësaj kishim edhe njohje familjare përmes nënave tona, kështu që u mërzita që po më akuzonin shoqen dhe ju fola:

- O goce, ne vijmë nga Shqipëria, jo nga jashtë shtetit. Këto rroba ajo i vesh në shkollë e në bulevardin e Tiranës e nuk i thotë gjë njeri, gjetët ju të na ndaloni tani ?

Mbas pak na u afrua një djalë i gjatë që na u prezantua si sekretari i rinisë i cili na la të prisnim deri sa autobusit ju afrua një nga personalitetet e vendit i cili na pyeti për arsyen e vizitës.

- Kemi ardhur të vizitojmë qytetin – i thotë Jakupi.
- Bëni mirë që më parë të vizitoni uzinën metalike që të takoni klasën tonë punëtore dhe të mësoni si të visheni e si të respektoni qytetin tonë. Në kohën që partia ngre problemin e modës së huaj, ju keni

ardhur këtu të na e demonstroni. - tha duke ju drejtuar Tenkës. Tenka u vu në pozitë të vështire dhe mori ti përgjigjej.

- Shoku veteran..
- Veteran mund të jetë yt atë – ndërhyri sekretari i rinisë - shoku është edhe hero i popullit, prandaj kërkoj më shumë respekt.

Një nga oficerët më të vjetër, Kosta, mori fjalën dhe u mundua ta qetësonte situatën:

- Unë jam oficer, anëtar partie dhe një nga më të moshuarit e grupit dhe mund tju garantoj që edhe vajzat tona do ti zbatojnë porositë e partisë për ndryshimet në modë,

Dua të theksoj se këto ndryshime kanë të bëjnë në radhë të parë me bindjen e të rinjve për ti kuptuar e luftuar çfaqet e huaja. Këto janë porosi të partisë të cilat janë shtruar me forcë këto 2 muajt e fundit dhe kemi menduar që ti lemë vajzave kohën materiale për të ndryshuar veshjet e tyre.

Fjala e Kostës u duk sikur e qetësoj situatën.

Më në fund na thanë:

- Do ti shkruajmë një letër komitetit qendror të rinisë. Le ta vlerësojnë edhe ata paraqitjen tuaj. – dhe më pas u larguan. Me sa u kuptua kishin bërë edhe ndonjë foto.

I hipëm autobusit dhe vazhduam rrugën. Koha kalonte dhe asnjë nuk fliste. Në autobus kishte rënë qetësi e plotë, dëgjohej vetëm zhurma e motorit dhe gërhitja e

atyre që ja kishin futur gjumit. U dëgjua vetëm zëri i Llërit që tha:

- Heronjtë janë bo telef.

Shoferi e dëgjoi dhe fiku dritat brënda autobusit.

Ditët që pasuan, ishin vërtet të trishtuara. Na kishte hyrë ankthi dhe nuk dinim përmasat që mund të merrte problemi. Nuk vonoi shumë kur mbas 2 ditësh pamë në hyrje të universitetit një Fletë Rrufe të madhe që ata të Gjirokastrës e kishin qëndisur me kujdes. Kështu pra edhe fjala e Kostës nuk ishte marrë parasysh. Kishte triumfuar euforia e të dukurit parimor.

Me sa dukej nuk kishte institucion që nuk e kishte marrë vesh nga dekanati e rektorati i universitetit, deri tek komiteti I partisë së rrethit e komiteti qëndron i rinisë. Topi kishte kaluar nga Gjirokastra në Tiranë dhe tashti ndeshja po zhvillohej në fushën tonë kush e kush të bënte gol, pra të tregohej më i zellshëm dhe më me partishmëri. Situata për vajzat po rëndohej.

*Ashtu siç kujton Bakja: “Po përgatitej një mbledhje e zgjeruar me pjesëmarrjen edhe të drejtuesve të partisë të universitetit, ku parashikoheshin edhe masa rënduese.”*

Mbas disa ditësh kishte dalë varianti i një mbledhjeje paraprake që mund ta zbuste situatën. Në atë kohë nuk e kuptuam burimin e këtij vendimi për ta zbutur situatën. U desh të kalonin 50 vjet deri sa në diskutimin që po bëjmë në WhatsApp edhe për këtë çështje, na arrin mesazhi i Tolit i cili kujton përgjigjen që i kishte dhënë një funksionari të lartë në Komitetin e partisë së Tiranës

*“Nuk e lashe të fliste gjate por i thashe pse çfarë mendoni ju se po të isha dhe unë me shoket e shoqet e universitetit do ngrihesha i revoltuar duke ikur dhe duke denuar çfarë po benin? E ke shumë gabim. Aty do rija e do gezoja me ta.”*

Mbas kësaj drejtuesit dhe të deleguarit u tërhoqën dhe kaluan nga sulmi në mbrojtje. U kalua nga një mbledhje me të deleguar në një mbledhje të thjeshtë, nga masa ndëshkimore për vajzat, vetëm në një vërejtje të thjeshtë për profesor Jakupin.

*Në lidhje me këtë Bakja kujton:*

*“Pas disa diskutimeve të shkurtëra me sens autokritike mbledhja u mbyll brenda auditorit dhe më pas vazhduam jetën studentore të qetë.”*

Nuk mund të le pa përmendur edhe qëndrimin kritik dhe shumë kurajoz të Tamarës në këtë mbledhje të cilën Ilira e kujton në mënyrë të veçantë.

***Konkluzioni dilte qartë:***

***“Llafi I Tolit kishte shkuar në vesh të perëndisë”***



*Tiranë 1973*

## **Përfundimi i shkollës.**

Qershori i vitit 1973 do të shënonte edhe përfundimin e universitetit. E lamë që mbas provimeve të fundit të dilnim nga liqeni për ta festuar.

Më përpara dekanati kishte organizuar një takim lamtumire ku merrnin edhe mendimet tona për kualitetin e mësim dhënies si edhe ndonjë propozim për emërimet në punë. Mendimi i jonë mund të merrej në konsideratë edhe në karakteristikat e propozimet që bënte universiteti për emërimet në punë të gjithsecilit nga ne.

Toli ishte ulur një bankë mbrapa meje. Në një moment ngrihet në këmbë dhe merr fjalën:

- Për sa i përket emërimeve dua të jap mendimin tim. Petritin e kemi edhe muzikant që këndon dhe i bie kitarës. Mendoj që emërimi i tij në Radio Tirana do të ishte i vlefshëm edhe për këtë institucion. U ktheva dhe i buzëqesha në shenjë falënderimi.

Isha i sigurt që fjala e tij peshonte shumë.

Ato që tha ishin të vërteta, por edhe mund të mos fliste fare po të donte.

Nuk dija si ta falënderoja. Në atë moment nuk fola.

Toli kishte shprehur atë që mendonte.

Kisha mendimin që e pëlqente këngën time, dhe më inkurajonte. Më kujtohet që kohë më parë më kishte dhuruar edhe një bobinë me këngët e Beatles-ave. Ku përfshiheshin disa nga këngët e “The White Album” si edhe kënga e George Harrison “Bangladesh” që e pëlqoja dhe e këndoja shpesh. Për mua kishte qene një dhuratë e çmuar që më shërbeu për të mësuar këngët.

Atë ditë isha vërtet i gëzuar. Fjala e tij dëgjohej shumë, por më pas mendova se ajo që kishte propozuar Toli, nuk mund të realizohej, meqenëse im atë ishte drejtues në Radio dhe 2 persona nga e njëjta familje nuk mund të punonin në të njëjtin institucion, megjithatë ky opinion i mirë i tij do të influenconte pozitivisht në emërimin tim. Dhe ashtu ndodhi vërtet.

Më vonë mora vesh se propozimi i universitetit kishte shkuar në Radio pra ishte bërë ajo që kishte propozuar Toli, por sigurisht ky propozim nuk mund të pranohej, megjithatë u emërova me punë në Tiranë.

Atë mbrëmje shokët e kursit u nisën përpara drejt liqenit. Merrnim pjesë kryesisht ata me banim në Tiranë. Unë u ktheva në shtëpi për të marrë kitarën. Shtëpinë e kisha shumë afër liqenit kështu që për 10 minuta u ngjita përsëri tek Liqeni dhe i takova. Në atë kohë buzë liqenit ishin ndërtuar disa si bankina të vogla, të rrumbullakëta e të shtruara me pllaka që mund të na shërbenin edhe si vend kërcimi. Shokët po më prisnin mbi një rrënjë prej tyre. Nuk e bëra të gjatë dhe fillova këngën. Me ne ishin edhe ato pak vajza të kursit, kështu që këngës dhe ritmit të kitarës ju shtua edhe vallëzimi. Tashmë isha mësuar që

çdo evenimenti ti përshtasja këngët e duhura. Prandaj me rastin e kësaj ndarje nga shokët fillova me:

- *Në bangat e shkollës o mike, dy emra ç'i gdhendëm dikur, por unë nuk e di si më ike dhe zemrës I vura një gur.*

*Ne u ndamë në errësirë..*

Vazhduam të këndonim të gjithë se bashku.

Më pas hyra në repertorin tim të preferuar. Më kujtohet që në mëndje kisha krijuar një album me këngët më të bukura të “beatles-ave”:

*Yesterday..*

*Imagen..*

*Let it be..*

Më ka pëlqyer gjithmonë Batisti, kështu që nuk lashë pa kënduar “ I giardini di marzo “ e “Acqua azzura acqua chiara.”

Ishte vërtet një moment gëzimi the ndjenjat shpërthyen me forcë në këngën tonë.Po mbyllnim portën e shkollës për të hapur atë të jetës.

Ishte vërtet momenti që siç thonë: “ Po dilnim në jetë.”

Gjëja e veçantë e mbrëmjes ishte se shokët kishin marrë me vete edhe një magnetofon. Kjo më dha mundësinë që të kërceja me vajzat e grupit.

Dikush nga çunat gjeti edhe një barkë me lopata kështu që filluam edhe xhiron me barkë në liqen. Çdo gjë po shkonte për mrekulli kur pa pritur kënga dhe kërcimi na u ndërpre nga dikush:

“ Policia..policia “.

U shpërndamë me vrap nga të katër anët. Rrugicat për të arritur në shtëpi i dija mirë. Ishte vonë, të gjithë kishin rënë të flenë. Nuk shqetësova asnjëri dhe u shtriva në krevat. Por gjumi nuk më merrte. Çdo gjë mund të ndodhte. Prita sa u gdhi. Nuk vonoi dhe po atë ditë më erdhi lajmërimi për tu paraqitur në rajon. Të nesërmen në mëngjes u paraqita në zyrën e policisë.

Punonjësi i policisë në shërbim më pyeti:

- Je nga ata të liqenit ?
- Po
- Si e ke emrin?
- Petrit.
- Do të paguash një gjobë të si prishës i qetësisë publike.

Në atë kohë zona e liqenit, ishte një zonë e pa banuar. Të them të drejtën nuk e mora vesh kujt i kishim prishur qetësinë, çifteve që bënë dashuri në pyllin për rreth, apo peshqve të kuq të liqenit. Nuk e zgjata, e kuptova që ishte vetëm një pretekst për të justifikuar kontrollin. Përsëritë policin dhe u largova

Por çfarë kishte ndodhur me shokët. Mendova e njëjta që kishte ndodhur me mua. Shkolla kishte përfunduar dhe nuk I takova dot të nesërmen. Më pas kjo histori u harrua. Dhe akoma tani, mbas 50 vjetësh, nuk e dija përfundimin e saj. Vendosa të hyj në WhatsApp për ti pyetur. Hapa “Dritaren e kujtimeve” dhe ju paraqita variantin tim. Ja çfarë kujtojë shokët; Pirro:

*“Petrit, kur erdhi polici, të gjithë ja mbathëm nëpër ferra. Ai u tregua I zgjuar dhe kapi nja dy vajza për dore. Nga ato mori emrat e të gjithë shokëve.”*

Piro:

*“Siç e kujtoj unë  
Magnetofoni mbeti ne toke te ajo struktura ku po  
kërcehej  
Kujtoj policet qe erdhën me vrull nga lart  
Kam marre magnetofonin une me Metin dhe Kolin dhe  
bashke me Maken kemi shkuar te shtëpia e Makes mbasi  
i kishte prindërit ne Hungari.  
Unë ndenja disa ore dhe ika ne shtëpi kurse Meti dhe  
Koli ndenjen deri ne mengjes  
Nuk di cu be me magnetofonin”*

Tenka:

*Shpresa, Make, Tenka dhe nje shok tjeter zbrite me shumë shpejtesi parallel me xhipsat e policise me kahje te kundert poshte drejt Librit Universitar, u ndame me shoket dhe fjetem tek Shpresa që me shumë respekt ne ate peridhe mbante vellane dhe motren, pasi prinderit I kishte ne Kine.*

Ilira:

*“Unë po them pjesen time. Mua policia me kapte si magnet, nuk e di pse . Edhe atë nate m'u drejtuan menjëherë. Etleva natyrisht nuk lëvizi dhe Genci gjithashtu, si gentleman qe ishte. Ne polici ndenjëm deri sa erdhi babai im, i moshuar I shkreti, nuk e di si e*

*thirren ndoshta me telefon. Pastaj na liruan. Si gjithmonë, babai nuk me shau, ti e di vete çfarë bën, me thoshte.. mesa di unë ishte i vetmi që u thirr në polici, se Spiron dhe Bilbilin nuk donin t'i shqetësonin.”*

Si përfundim:

Nga kontrolli nuk kishin konstatuar asgjë që nuk shkonte.



*Me sa duket, duke analizuar emrat dhe familjet tona, e kishin mbyllur njërin sy edhe për këngët e huaja.*

*Në 5 vjetorin e kësaj ngjarje u mbledhëm përsëri tek liqeni.*



*Tiranë 1973*

## **Saja dhe kanoçja e tij.**

Saja, ishte një nga shokët e universitetit me të cilin u afrova në vitin e fundit të universitetit. Të them të drejtën Saja ishte djalë i singertë, bile shpesh më tepër seç duhej. Vërtet kishte një edukatë familjare që ndryshonte nga timja por që mua nuk më krijonte probleme. Ndryshe nga im atë që ishte lidhur që i vogël me lëvizjen dhe shkollën e kishte bërë mbas çlirimit, jati i Sajës Rushiti, kishte mbaruar shkollën e Fulzit në Tiranë dhe për shumë gjëra, kishte marrë një edukatë perëndimore me të cilën kishte edukuar edhe fëmijët e tij. Siç thoshte Saja, Shiti kishte mbaruar shkëlqyeshëm gjimnazin dhe kërkonte rezultate të shkëlqyera edhe nga fëmijët. Mesa kuptoja fjala e Shitit ishte ligj për Sajën. Saja, nuk mungonte kurrë në Leksione dhe studionte shumë, për të qenë gjithmonë i pari i kursit.

Këto ditë( mbas 50 vjetësh) duke pirë kafe me Apostolin, kujtuam një rast kur kishim vendosur që të linim orën e mësimi dhe të gjithë si grup të shkonim në kinema. Atë ditë në leksion kishin mbetur vetëm 2 veta Saja dhe profesori, ndërkohë që në apelin e kinemasë Saja mungonte.

Unë në universitet nuk kam qënë dalluar në mësim, nuk kam ngelur në asnjë provim por as nuk jam dalluar për nota të mira. Pra nuk kisha rënë akoma në dashuri” me

elektronikën. Saja, ishte natyrë e afruar dhe kishte shprehur gjithmonë dëshirën që të më ofronte ndihmë, sa herë që do të kisha nevojë.

Shiti, kishte qef që vija e takoja Sajën, me dëshirën që të hynte në bisedë edhe me mua.

Presa i përket filmave dhe programeve televizive të huaja Shiti më dukej shumë liberal që korrespondonte edhe me edukatën e tij perëndimore. Më kujtohet kur një ditë tek “jugosllavi” do transmetohej filmi “Dekameroni.” Saja më fton që ta shihnim tek shtëpia e tij. Unë e pyes se mos ishte edhe Shiti.

- Shi, nga Shiti ke turp ti, Shiti është “dora jonë”. Hajde se do të kënaqemi.

Rreth orës 10 të mbrëmjes shkoj tek shtëpia e Sajës. Mbas pak do të fillonte filmi. Dhoma e Televizorit ishte mbushur plot me njerëz.

Shiti ishte ulur në kolltuk, përballë televizorit dhe mbi poltron. Me sa dija, në atë kohë kishte pësuar një paralizë parciaie, kështu që nuk fliste qartë:

- Mirëmbërëma e mirë se erdhe - më tha.- A je mbi 16 vjeç?
- Po.
- Edhe unë - më tha.- Kështu që na lejohet që ta shohim filmin.

Unë qesha pa folur. Dhoma, ishte mbushur plot, dhe prisnim që të fillonte filmi. Fillimi i filmit u shoqërua me duartrokitje. Më pas ra qetësia, e cila shndërrohej në evocione, sapo shfaqej ndonjë skenë erotike. Më

kujtohet skena kur protagonistja e filmit hynte e dilte në liqen lakuriq, në dhomë dëgjoheshin:

“Uuuu. Uuu.. mashalla, të keqen e rimorkios” dhe më pas duartrokitje dhe të qeshura.

Ishte hera e parë që po shihja një film erotik në grup. Në shtëpi shihja ndonjë fshehurazi e në qetësi, për të mos zgjuar babain nga i cili më vinte zor. Këtu atmosfera ishte ndryshe. Shiti duartrokiste i lumtur që po i kënaqte të rinjtë. Me sa kuptova Shiti kishte qef të organizonte kinemanë, por unë nuk mora pjesë më. Mbaj mend disa kohë më vonë po kaloja rastësisht nga shtëpia e Sajës kur dëgjoj të njëjtat zëra dhe atë ditë nuk kishte ndeshje sporti. Mora vesh më vonë që edhe shokë të tjerë të kursit tonë kishin marrë pjesë në kinemanë e Shitit.


Viti 1973, solli ndryshime të mëdha në jetën kulturore të Tiranës. Në dhjetor 1972 ishin mbyllur stacionet ritrasmetuese të televizionit Italian në Dajt. Nga ky moment u lanë të lira vetëm emisionet e lajmeve të kanaleve RAI. Shumë njerëz kishin mbetur si “peshku pa ujë.”

- Tito, më është bërë televizori si kafaz pëllumbash. E Kam ble 50 mijë lek e tani nuk vlen më as një grosh. - Më thotë një ditë Gazi, një nga shokët e gjimnazit.
- Po Gazi, piji lëngun se ske çfar bën hiç. – i them
- Po pse a është e drejtë kjo. Unë televizorin e kam ble që të shoh Italinë dhe këtë ma kanë lënë ta shoh. Pse tani duhet të shoh vetëm Tiranën.

Njerëzit kërkonin zgjidhje dhe ju drejtuan qiellit. Filluan të mbinin si “kërpudhat mbas shiut” antenat UHF të drejtuara direkt nga perëndimi, ndërkohë që ato drejtuara nga Dajti dolën të pa vlefshme ose u modifikuan për të parë stacionet e Jugosllavisë. Materialet për përgatitjen e antenave filluan të kërkoheshin nga të gjithë. Nëpër ndërmarrje, tubat e aluminit dhe të bakrit filluan të mungonin. Filluan të vidheshin antenat UHF nëpër pallate. Njerëzve ju “hiku truni”: “Pse ai ta shohi Italinë dhe unë Jo”. Por kjo nuk mjaftonte. Edhe kur e shihnin vazhdonin të ankoheshin: ”Duket, por atij i duket më mirë ama.” Antenat e përmirësonin sinjalin, por efektin e kishin më shumë në periudhën e verës, Elektronistët u vunë në kërkim të solucionëve më efikase. Saja, si kudo, deshte të ishte i pari. Nuk e zgjati dhe i hyri punës për krijimin e amplifikatorëve të sinjaleve televizivë. Nuk mund të them që ishte i vetmi, por me sa di, nga kursi jonë ishte ai që pruri rezultate të mira. Prodhimi i “kanoçeve”, siç filluam ti quanim, kërkonte precizion në montim dhe në zgjedhjen e komponentëve. Fama e “kanoçeve” të Sajës kishte marrë dhenë aq sa në mesazhet që më dërgon mbas 50 vjetësh në WhatsApp më dërgon fotot ku ka dalë me disa personalitete të futbollit Italian dhe më shkruan: ***“Edhe këto e dinin historinë e kanoçes time”***

*Kreu i katert*

## **Stazhi Pasuniversitar**







*Laprake 1973*

## **Uzina e PTT së.**

**I**shte Shtatori i vitit 1973. Isha njoftuar se do të filloja punë në uzinën e PTT së në Laprakë. Më kujtohet që në hyrje të uzinës takova Tenkën dhe Gencin. U gëzova që isha caktuar në uzinë bashkë me shokë të mirë të cilët i njihja që në Universitet.

Më pëlqeu si vend pune, sidomos mikpritja e punonjësve ishte e veçantë. Njerës të thjeshtë e punëtorë.

Më kujtohet që Tenkën e caktuan në repartin e prodhimit të telefonisë. Reparti prodhonte centrale telefonikë manuale dhe pjesë ndërrimi për centrale. Brënda repartit ishte edhe një grup montimi i centraleve automatikë. Këtu bënë pjesë punonjësit më të vjetër dhe më me eksperiencë: Esati, Hakiu, Llazi, Rudolfi, Servetja dhe Nina. Këta ishin edhe baza e repartit, por ishin të gjithë afër moshës së pensionit, Kështu që ardhja time dhe e Gencit krijonte një situatë të favorshme për të rifreskuar grupin e montimeve. Vendosën të na vënë

menjëherë në provë. Në planin e punës ishte vënë montimi i centralit automatik të Lezhës.

Me Gencin kemi kaluar një periudhë të gjatë kohe së bashku, në shkollë dhe në punë. Edhe gjatë periudhës së diplomës kemi studiuar së bashku.

Ishte shoku i universitetit me të cilën u lidha më shumë gjatë viteve të para të punës. Emërimi tonë në uzinën e PTT-së në Tiranë e forcoi lidhjen shoqërore. Të pa haruara mbeten instalimet e centraleve telefonikë në qytetet e Lezhës dhe të Burrelit ku punuam së bashku. Jeta me shërbime të gjata jashtë Tirane na afroi edhe më shumë meqë rrinim gjithë kohën bashkë jo vetëm në punë por edhe jashtë orarit të punës. Shpesh merrnim kitarën dhe mblidheshin në grup duke kënduar.

Për montimin e centralit të Lezhës, u krijua një grup i përzier me të rinjtë dhe me të vjetrit.

Bënim pjesë unë dhe Genci nga të rinjtë, si dhe Hakiu, Servetja, Nina e Llazi nga grupi i të vjetërve. Në fillim të nëntorit u nisëm për në Lezhë. Ishte hera e parë që qëndroja në Lezhë. Kishim marrë si parapagesë dietat e shërbimit për 1 muaj dhe u sistemua në hotelin në qendër të qytetit që e quanin hotel turizmi, një hotel aspak komod që nuk kishte as ngrohje në periudhën e dimrit, dhe ku shërbimi nëpër dhoma ishte shumë i kufizuar.

Periudha e montimit të centralit ishte relativisht e shkurtër. Makinaria, që vinte nga Çekia ishte e montuar. Ne duhet të përfundonim shtrirjen dhe lidhjen e telave nëpër panele në bazë të skemave të projektit të

parapërgatitur. Unë me Gencin duhet të njiheshim me projektin dhe të ndihmonin në zbatimin e tij. Punën e mora me qef dhe mësova shumë nga mjeshtrit e vjetër. Shpesh kisha nevojë edhe për proceset e thjeshta të montimit. Më koenfidencë kisha me Ninën dhe i rrija pranë që të mësoja operacionet e punës.

- Më fal, i thoja, që të pyes.
- Duhet të më pyesësh që të mësosh - më thotë dhe vazhdoi. - Hunda e gjatë nuk të len me kullotë.-

***Kështu nga teknikët e vjetër mësova shumë. Kjo eksperiencë do të më duhej më vonë në montimin e centralit të Burrelit***



*Tiranë - Burrel 1974*

## **Diploma e shkollës dhe e punës**

**F**illimi i vitit 1974 na gjeti me përgatitjen e diplomës. Unë dhe Genci, që kishi bërë stazhin bashkë në uzinën e Ptt na kishin caktuar nga universiteti të njëjtin drejtues, Dilaverin, që ne I thërrisnim shkurt Dyli, kurse në universitet i thërrisnin “Dyli i Dajës.” Dilaveri në fakt, ishte nipi i njërit prej pedagogëve tanë që na jepte lëndën e Dhënësave. Ai ishte diplomuar 2 vjet më parë. Që nga koha kur Dilaveri ishte student, pedagogut të dhënësave filluan ti thërrisnin Dajë dhe nipit të tij Dilaverit “Dyli I Dajës”

Me sa dukej, Dilaveri i thërriste “Dajë” edhe gjatë leksionit.

Nuk e di si rrodhi ky epitete por ç’rëndësi ka. Daja ishte pedagogu më i vjetër por edhe më simpatik i shkollës. E deshëm të gjithë se na linte të kopjonim, por edhe Dyli ishte burrë i mirë dhe babaxhan. I kishte ngjarë shumë Dajës.

Unë, Dyli dhe Genci, kishim zgjedhur shtëpinë e Gencit për përgatitjen e diplomës, falë edhe kushteve më të mira që na u krijuan atje për studim. Dyli vinte shpesh dhe na sillte literaturë në rusisht. Në atë kohë libra

teknikë në anglisht gjeje rrallë. Dyli na ndihmoi edhe për skemat elektrike dhe përshkrimin e temës ndërsa për lidhjen e paraqitjen më ndihmoi Genci. Me qënëse punonim në uzinën e Ptt-së, të dyja temat që drejtonte Dyli kishin të bënin me telefoninë.

Kujtoj që babai i Gencit kalonte për të na pyetur si shkon përgatitja dhe unë vihesha në vështirësi për tju përgjigjur.

Një ditë Dyli i spjegoi gjërë e gjatë përmbajtjen e temës së diplomave dhe gjëndjen e studimit. Mua mu duk se u bind dhe mbeti i kënaqur.

Mbrojtja e diplomës ishte relativisht e lehtë. Tema ishte shume specifike, Më bënë vetëm disa pyetje formale dhe më këputën një Tetë.



Centrali telefonik i Burrelit u bë etapa tjetër e montimeve për mua. Meqënëse Genci pritej të transferohej në Elbasan për montimin e centralit telefonik të kombinatit

metalurgjik,

për këtë central, përgjegjësia e montimit dhe e kolaudit mu ngarkuan mua. Për mua, përfundimi me sukses i centralit ishte një diplomë e dytë.

Mora në dorë skemat e montimit të centralit dhe fillova ti studioj. Centrali ishte komplet elektromekanik. Kishte

shumë pak pjesë elektronike. Panelet, që importoheshin, përbëheshin kryesisht nga kontatorë dhe rrele. I vura gocat të përgatisnin kabllazhin dhe vetë u mora me kontrollin e paneleve. Për kabllazhin më duheshin vetëm dërrasa, gozhda, spango dhe tela shumëngjyrëshe.

Gocat i mësuan shpejt të gjitha procedurat.

Kisha nën drejtim edhe 2 djem të rinj që punonin kryesisht mbi shkallë për montimin dhe lidhjen e kablllove në panel.

Puna po më ecte shumë mirë. Nuk kaloi shumë kohë dhe montimit po i vinte fundi. Telefonova drejtorinë dhe i lajmërova që centrali ishte thuajse gati për kolaudim.

Me këtë rast më dërgojnë një nga teknikët e vjetër për të marrë pjesë në kolaudimin dhe kontrollin përfundimtar. Tekniku ishte Dolfi, specialist i zoti dhe burrë alegro e shumë shakaxhi që këndonte këngë e tregonte barceleta. Dolfi kishte qenë këngëtar i njohur i muzikës së lehtë dhe kishte disa regjistrime që transmetoheshin akoma në radio. Mbas buke na tregonte gjithmonë barceleta, që megjithëse përsëriteshin vazhdimisht, i kishin lezet dhe ne gjithmonë qeshnim.

Në moshë ishte rreth 20 vjet më i madh se ne por në bisedë dukej si shoku i jonë.

***Kanë kaluar 50 vjet nga ajo kohë dhe ruaj akoma kujtime dhe respekt për këto vajza dhe djem me të cilët ndamë sakrificat, përpjekjet dhe sadsfaksionet për ti dhënë Burrelit centralin e parë automatik dhe disa qindra numra telefonikë.***



*Burrel 1975*

## **Humori i Bikut**

Atë ditë Dolfi po vonohej, dhe kënga e tij na mungonte në central.

Në vënd të tij, këngës ja kishte marë Nikoja që kishte filluar një potpuri këngësh humoristike Korçare:

*“ Topalli po vraponte, topalli po vraponte,      Makinës ja kalonte xum trialala lila ooo.*

*Qorri po kërkonte, qorri po kërkonte,      Gjilpërën mu në kashtë xum trialala lila ooo...*

*Kush e pa priftin dhëndër dhe hoxhën me barrë xum trialala..“*

Atë ditë Dolfi na bën një surprizë. Hyn në central me një person tjetër i cili mu duk fytyrë e parë por që nuk po e kujtoja nga e njihja.

- Ju prezantoj me artistin, regjisorin dhe humoristin e mirënjohur të estradës së Shkodrës, Bik Pepa që ka ardhur të na bëjë një vizitë në central.

Më pas Dolfi më afrohet dhe më thotë me zë të ulët:

- Titi, ka ca bejte të bukura Biku, por I ka vetëm për gjininë mashkullore.

Kishte kaluar koha e pushimit të drekës dhe unë ju drejtova vajzave:

- Goca, po të doni shkoni të hani drekë ju, se Bikun e shohim sot në darkë në çfaqen e estradës.

Vajzat përshëndetën bikun dhe u larguan.

Kur vajzat dolën, Dolfi na thotë:

- Biku ka dëshirë të na recitojë poezinë :

“ Mallkim Dashurie”

Biku, që poezinë e dinte përmendësh, mori pozicion, dhe me një zë të plotë e kumbues filloi të recitonte:

*“Atëherë kur ti ke për të qenë e humbun, mbjellë thellë në tokë të majme tul,*

*dhe kryqi i zotit ka për të qenë i ngulun mbi arkën tuaj pingul.*

*Atëherë kur ty kanë për të ra mollëzat e kalbëzituna mbi dhambët e ba gjytryma,*

*e në gollën e syve tujë të plasaritun do të vlojnë me mijëra kryma,*

*për ty, ai gjumë që prehje asht për të tjerë do të jetë mundim i ri,*

*bremja e ndërgjegjes do të vijë o e mjerë, trutë me të dhamzu përsëri.*

*Një bremje shumë e mprehtë, me të egërsumun, do të vijë në gropë si morr.*

*E boll zotit e Krishtit të tij të kryqëzimin, do ti skuqë edhe eshtrat në vorr.*

*Unë do të jem ajo bremje, Unë tue të kërkuar brenda asaj nate të thellë thellim..”*

Poezia e Bikut ishte e gjatë e të çonte në pafundësi mendimesh e ndjenjash. Shpesh të fuste frikë dhe ankth. Ishim shtangur të gjithë dhe dëgjonim me kureshtje, ndërkohë që Biku vazhdonte recitimin:

*“Pse më the ti Jo, kur shtri përtokë tuj të lutë: - ki mëshirë o e ngratë -*

*ndërsa në rrugë kodoshët tuj zbathokë pritshin Englezët me të shit.”*

E kuptova që po recitonte një poezi të huaj, por mjeshtëria e tij e përkthimit dhe e interpretimit ishte vërtet e rrallë.

Deri vonë e kam kërkuar poezinë e Bikut edhe në internet por nuk kam mundur të gjej gjë. Këtë pjesë poezie e mbaj mend akoma mbas 50 vjetësh aq shumë më është ngulitur në memorie.

Më në fund Biku e kishte përfunduar recitimin, por ne vazhdonim të qëndronim të ngrirë e të heshtur duke pritur vazhdimin.

Biku na pa që kishim rënë të gjithë në një qetësi. Monologu i tij, i krijuar dhe interpretuar me mjeshtëri, na kishin mallëngjyer dhe na kishin futur në një melankoni të thellë. Ishte pikërisht momenti që priste regjisor Biku. Kur qetësia u bë e plotë, pa pritur, ai lëshoi fuqishëm një seri bejtesh të cilat, në ambientin e

krijuar, na u dukën edhe më të bukura, na ngritën peshë dhe e qeshura shpërtheu fuqishëm:

*“ Për herë të parë kur ti më fole, lulja e bukur plot arom.*

*Unë të dhurova një copë b\*le, dhe një k\*r të njomë.*

*Lamtumirë mos më thirr kur ma, le t’ma grirë k\*\*in dashnia.*

*O moj ti që rri tuj fsha, ndër b\*le të mia.”*

Ky shpërthim të qeshure, më krijoi një kontrast të madh sentimental të pa provuar ndonjëherë. Kaluam nga një trishtim dhe vajtim i një dashurie të humbur, në një shpërthim ndjenjash të një humori të pa pritur dhe ekstrem.

Vargu i bejtes të Bikut ishte vërtet i veçantë dhe interpretimi i tij ishte ai, i një mjeshtëri të skenës dhe të humorit.

Mbas kësaj të pa pritur, Biku erdhi të na takonte dhe ne ishim të gëzuar që ti uronin mirëseardhjen Takimin e filloi nga unë. Dolfi e shoqëronte.

- Ky është inxhinieri dhe drejtuesi i punimeve – i thotë.

Mbasi u prezantova, Biku më tha:

- Të lumtë Titi për punën e bukur që keni ba. Dolfi po m’thotë që edhe kënon bukur.

Kam qef me t’nigju.

- Do ta organizojmë sot, - i thashë - edhe unë kam qef.

Para se të largoheshim lajmërova çunat e grupit të punës që mbas ditën e kishin pushim dhe në mbrëmje mund të shkonin në çfaqen e estradës. Vendosa që mbas ditën ta kaloja me Dolfin dhe me Bikun. Ishte vonë dhe restorantin tonë e gjetëm të mbyllur.

Gjetëm akoma hapur një restorant të lirë. I vetmi në arë zonë.

U ulëm që të hanim dhe Biku porositi gjellë me mish viçi. Sapo u ulëm thërret përgjegjësen e lokalit dhe thotë:

- O shoqja përgjegjëse, nuk përdorni thika ju këtu..aaa.
- Jo mor shok. Ne jemi restorant i kategorisë së dytë.
- Pse maj, ba me kenë i kategorisë të tretë nuk duhet të kena as lugë e pirunj...aaa.

Përgjegjësja filloi të qeshë bashkë me ne dhe mbas pak i solli një thikë të madhe guzhine.

- Po kjo çfar është maj, ma ke pru për me pre viçin për së dytit.aaa.

Të qeshurat vazhduan. Mbas pak na prunë pjatat dhe filluam të hanim por e qeshura nuk pushonte.

Mua më shkoj keq buka dhe fillova të kollitesha. Biku më pa dhe shtoi:

- Ku kuu për besë, po na e myt inxhinierin maj shoqja përgjegjëse. Bjeri maj një gotë ujë, se tash po ngelesh edhe pa telefon.

Hëngrëm dhe pimë një verë të hapur që e kishin përzier me ujë. Biku e kuptoi dhe e pyeti:

- O shoqja përgjegjëse, kujt ja keni vjedhun këtë venë maj ?
- Kjo është verë e lokalit mor shok. - i thotë përgjegjësjë, - e kemi bërë vetë.
- Aaa..Paskeni gjet kohë me shi veç.

Përgjegjësjë u skuq dhe se desh veten.

- Uuu paske shumë fjalë ti mor shok - u përgjigj duke u larguar.

Vazhduan të qeshurat. Bikut i kishte lezet çdo fjalë që lëshonte. Çdo shprehje kishte nënkuptimin dhe filozofinë e vet. Dialekti i bukur Shkodran ja shtonte bukurinë dhe i jepte forcë mendimit të tij. Para se të largoheshim nga restoranti e pyes Bikun se çfarë pije preferonte për mbas dite.

- Pimë çfarë të doni mor Titi. Për mu marrim raki dëllinje.
- Shumë mirë i them, dhe porosita një shishe raki dëllinje dhe gjashtë bërxolla.

Çdo gjë ishte gati për mbas dite. Shkova në hotel dhe mora kitarën. Biku me Dolfën më prisnin në central. Shtuam një copë linoleum për tu ulur e në vend të tavolinës përdorëm dërrasat e montazhit.

Vumë përpara 3 gota uji, bërxollat dhe shishen e rakisë.

- Hajde gëzuar e mirëse ju gjeta, uroi Biku duke na trokitur gotat. Më pas hodhi sytë nga kitara. Ja kuptova mendimin, mora kitarën dhe fillova këngën:

*“Chitarra, suona più piano*

*Qualcuno può sentire  
Soltanto lei deve capire,  
Lei sola deve sapere  
Che sto parlando d'amore..”*

Biku më ndiqte me shumë interes. Isha i bindur që Italishten e dinte mirë dhe këngën e kuptonte por nuk e dija që edhe e këndonte bukur. Kur fillova refrenin filloi të këndonte bashkë me mua me zërin e dytë:

*“L'ora di darle tutto il bene che ho nel cuore  
Di dirle addio per sempre, o perdonare  
E amarla come un altro non può fare.”*

Mu kujtua që edhe në Shkodër kishin vënë antena dhe kishin bërë “kanoçe” për të parë stacionet e televizionit italian. Sidomos katolikët e Shkodrës ishin të parët. E pyeta:

- A duket Italia në Shkodër Biku?
- Po mor Titi, kena vu ashi veglash. Unë e shof xham. Sepse, si i thojn fjalës: “çdo gjë e ndalume asht ma e dëshirume.”

Kështu që Biku, me siguri i kishte dëgjuar dhe i dinte këto këngë edhe më mirë se unë. Prandaj vazhdova me një nga këngët fituese të festivalit të San Remos:

*“Avevo una ferita in fondo al cuore,  
soffrivo, soffrivo...  
Le dissi non è niente ma mentivo,  
piangevo, piangevo.*

*Per te si è fatto tardi è già notte,  
non mi tenere lasciarmi giù  
mi disse non guardarmi negli occhi,  
e mi lasciò cantando così:  
Che colpa ne ha,  
il cuore è uno zingaro va....”*

Këndoja pa ndërprerje këngët e Nicola di Bari-t dhe Biku më shoqëronte vazhdimisht. Në një moment pushimi e merr fjalën Dolfi që nxjerr nga repertori një nga barcaletat e tij dhe i drejtohet Bikut.

- Biku a më thu dot sa herë hyn shtata ke trembëdhjeta.
- Në matematikë kam kenë tan desha. - Përgjigjet Biku.
- Meqenëse nuk e din, po ta them me barcalet vazhdoi Dolfi.
- Pyet mësuesja e klasës së parë “ *Fëmijë, sa herë hyn 7 ke 13*”. Disa përgjigjeshin 1 disa të tjerë 2. Nga banka e fundit e kërkon fjalën Zefi: “ *psss ..me leje zysh*” “ *he Zef*”

*“ hyn 2 herë po hyn shtrëngueshëm”*

Unë e kisha dëgjuar me dhjetëra herë barcaletën, megjithatë sa herë e dëgjoja qeshja edhe pse Dolfi i tregonte bukur.

Biku po e dëgjonte për herë të parë dhe u shkri gazit.

- Po e regjistroj ket, kjo që “hyn shtrëngueshëm” po më pëlqen. – dhe vazhdoi:

- A po na i merr një nga ato këngët e tua mar Dolfi. Hajd ta marsha, se me këto këngë i ke ba tan femnat me ra dekun.

Unë ja dija akordet dhe fillova të shoqëroja në kitarë:

*“Kur gjethet bijn në vjeshtë dhe m'dukesh n'vuj natyr  
Për ty s'mundem me heshtë, si gjethja bahem n'fyt  
Ti m'ke braktis, qofshin haram ndjenjat e mija  
Se larg dashnis, të lindi n'zemër pabesia  
Ke me u pendue, por at'her ka me qen' von  
dhe tuj lotue do t'vij nermen dashnia jon.”*

<https://youtu.be/PquFdkc24go?si=lA6bwJgOCq7ajY27>

- Biku, tash ta kam lan rradhën ty - i thotë Dolfi.
- Mirë boll mor Dolfi, po si i doni bejtet “ me krypë” a “ pa krypë”
- Nuk të kuptova Biku – I thashë.
- Nigjo Titi, lezeti i gjellës asht te krypa, kurse lezeti i bejtes ashtë tek“ fjalët e pista” ose “ llafe turpet” siç i thonë korçarët kurse unë i them thjesht “krypë”. N’publik na smundena me i përdor, ashtu siç e ke edhe ti të ndalume këngën e huaj. Por si e thamë “ çdo gjë e ndalume asht ma e dëshirume.”

Bejtet me krypë mi quajnë të pamoralshme, por kur i nigjojë shkrihen tuj qesh. Asht si puna a tërhanit Titi. A e din atë të tërhanit ?

- Jo - i thashë.
- *Tërhan, tërhan, lum kush e ban, zotnajtë e shajnë, me e pas e përllajnë.*

Më pas vazhdoi:

- Nigjoje tash “krypën” time - dhe filloi:

*“ Kan dal gocat e Idrizit,  
shalë e p\*\*h sa të duash në pazar,  
prifni pra majat e bizit,  
o kurvarë. “*

Të them të drejtën, edukata ime familiare dhe shoqërore nuk më lejonte që ti përdorja ato fjalë por edhe kur i dëgjoja skuqesha nga turpi, por Bikut i kishin lezet dhe mua më vinte për të qeshur. Biku vazhdonte pa ndërprerje breshërinë e bejteve me krypë:

*“Erdh pranvera çelin micat,  
lulëzon tranafili gem n’gem..  
Unë ti hangsha moj të dy ci\*at,  
dhe ti hongsh k\*\*\*n tem.”*

- Biku, po më përzihet i thashë. I paske hedh shumë krypë kësaj.
- Ani, ani, se tash po të kalon ta poshte.- Më tha.

Biku kishte një zë të plotë dhe kumbues. Zëri oshëtinte në sallën e centralit. Në çast mu kujtua që në dhomën ngjitur, punonin vajzat e centralit dhe i fola Bikut.

- Duhet të kemi kujdes me “krypën” Biku, se këtu ngjitur punojnë 2 çentralistet e Ptt-së.
- Pse Titi nuk e kanë në vend ato aaa..?
- Po mor Bik, si të gjithë, edhe ato në vend e kanë, po mos është turp me ja përmend.

- Turp asht mos me i përmend ato që janë burimi i jetës. Po prej atyre kena dal në jetë Titi, Në shoqëri dhe në bisedat e përditshme këto fjalë i përmendin të gjithë. Në përfundim i përdorin edhe në publik. Ba me pa televizionin Italian kur bajnë kronika e intervista në çdo 10 fjalë nigrin nga një “biip”, do të thotë një fjalë “krypet”. Nigrini këtë se është e bukur. – dhe vazhdoi të tregonte:
- Unë televizionin e lej vetë ke Italia. Fill masi vuna “ kanoçen” dhe lidha Italinë, të nesërmen vjen gruaja dhe më thotë: “ Hajde Biku se nuk punon mirë televizioni”

“Çfarë dreqin ka moj gru?”

“ Herë mas herët ban “ biip”

“U ku.. kuu për mu, po e ka prej krypës moj gru.

“ Aaa, a thu? “

“Po fajin e kam une. qi nuk ti kam mësuar fjalët e pista të italishtes.”

“Uuu.. mos pritsha un ma mirë, po krypa të çoka jo vetëm tensionin mor Bik, por edhe nervat, për besë nuk po marr vesh gja hiç Biku. Ça do me thane “ka-bip”

“ Tash po ta tregoj sontë mrama kur të shkojmë në shtrat” - i thashë.

Unë dhe Dolfi ja dhamë të qeshurit.

Më pas Biku vazhdoi:

- E patme fjalën tek bejtja. Bejtja asht një menim i koncentrum Titi. Me dy fjalë tregohet një histori. Nigjoje kët..

Isha tuj shkue në Puke me Xhovën, një shokut tim të fëminis. Zoti na i morri ment e fillume mu u sha me njani tjetrin jo : ti je kalama, ti je fmi 2 vjeç etj. Për me ja myll gojën i qita kët bejte:

*“Po bjen shi me copa mu\*it,  
morra rrugën për në sharra të Pukës,  
rroftë e qoftë Xhovani i Gudit  
në p\*\*h të Lugës. (Luga  
ishte nana e vet.)”*

Unë po mekesha nga të qeshurit e më shkonin lotë nga sytë.

- A të ka xan krypa aa..? Më pyet Biku.
- Po - I them, - kot nuk thonë “ gjella me krypë e krypa me karar.”
- Çfarë asht prej arit?
- Kujdes nga fjalët me 2 kuptime - më thotë Dolfi, - se jemi në regjim “krypet” këtu.
- Unë me të mijt jam tan ditën në regjim “krypet.” - vazhdoi Biku.
- Sot tuj ardh këtu me autobus u vume në garë kush gjen ma shumë, makina të markës Kar-pat. Kush e gjente pyste varzat ( si ma kompetente demek) “ He a e pat apo s’e pat ? “

“ poo për bes e pat”, përgjigjeshin varzat. Na ka shku rruga fjoll Titi.

Pasi u mendua pak vazhdoi:

- Eee ku e patme fjalën..., po te varzat. A të pëlqejnë varzat tona mor Titi,
- Po, I them.
- A po don me ta ba ndonjanën ?
- E kisha fjalën si artiste – i them dhe e ndieva që u skuqa.
- Po mar zot, për art jena tuj fol.

Dolfi e vuri re që isha vënë në siklet dhe ndërhyri:

- Mos na i ngacmo inxhinierin Biku se tash asht në fazën e karrierës.
- Po mor Dolf, po nuk po dona me e martu djalin, edhe unë për kar-jer po flas. Inxhinierin e kena të ri dhe duhet të bajë kar-jer.
- Më fal Biku, harrova që jena në regjim “krypet” - vazhdoi Dolfi.

Biku vazhdoi të punonte në regjim “krypet” deri sa u ndamë.

Rreth orës 6 të mbrëmjes, çohet në këmbë dhe na thotë:

- Sot na asht shtu jeta, se kanga dhe humori, ta shtojnë jetën mor Titi. Tash më falni, ika, se jam ba vonë për shfaqje. Shifna nesër nadje. Po kaloj me ju taku para se të nisen.

Na përshëndeti dhe u largua.

Ajo ditë e paharruar na kaloi vetëm me këngë, bejte dhe barcaleta. Të nesërmen në mëngjes herët erdhi të na përshëndesë.

Dy çentralistet e P.t.t.-së që kishin dëgjuar të qeshurat tona mbrëmë, i kërkuan ti recitonte diçka edhe për ato.

- Varza nuk kam kohë se po më pret autobuzi jashtë.
- Aman, një të shkurtër – i thanë duke i zënë rrugën.
- A po më leni tash, se du me kalu, një herë tjetër.

Vajzat qeshnin dhe nuk lëviznin nga vendi. Atëherë Bikut i hypën dhe u mat që ti shtynte për të kaluar, por e mbajti vehten dhe në nerva e sipër sajoi një të çastit:

*“Paskenti vendos me më blloku,  
dhe dorë më dorë më jeni lidh,  
a po më leni tash me kalu,  
apo tju q\* ka një her në p\*\*h.”*

- Uaaa çfar thotë ky moj, nuk i vjen turp - thanë vajzat me një zë dhe duke qeshur, ja dhanë vrapit e u larguan.

Kështu rruga për Bikun u hap dhe unë e shoqërova deri tek autobuzi. Kur u ndamë më tha:

- Titi mos harro ti kërkosh të falur varzave nga ana ime, por isha i detyrum me i përzan me një bejte të çastit që më doli shumë e krypun dreqi.
- Pa tjetër Biku, janë vajza të mira.
- Nuk e vej në dyshim. Po me femrat duhet me përdor ma shumë fjalën se sa dorën Titi, për ndryshe të akuzojnë që ke dash me i “fut durët”.

U ktheva në central. Vajzat më pritën me këmbët e para.

- Uaa sa turp - më tha Sania. Po ai shoku jot si na e kërkoi një copet pa njoft e pa e dit.
- E çfarë të bënte, tju shtynte që ti hapnit rrugën? Më tha që tju kërkoi të falur. Mirë është që, kur ta takoni herën tjetër, ti kërkoni edhe ju të falur, që u

bëtë të bezdisura. Biku është zotni burrë dhe njeri i talentuar.

- Titi, se të kemi si vëlla - vazhdoi Sania, - të them të drejtën mendova që ka dëgjuar fjalët e rrugës dhe prandaj dhe e lëshoj atë bejte aq të rëndë. Profesioni jonë është pak sa delikat dhe kemi të bëjmë gjithë ditën me njerës nga më të ndryshmit. Ka nga ata që nuk na thërresin më centraliste por “vajza fut e qit” meqënëse gjithë ditën fusim e qisim fisha për të lidhur bisedat telefonike. Por, për dreq, edhe fjalorin e punës shpesh e kemi me dy kuptime. Në orët e ngarkesës, përdorim pa dashur edhe shprehjet “Mbaro shpejt se ta preva”(bisedën) ose “Prit se e kam të zënë”(linjën)

Mbas këtyre shprehjeve fillova të qesh me zë. Vajzat filluan të qeshin bashkë me mua, dhe njëzëri shtuan:

- Rrofshi ju që po na instaloni centralin automatik. Do shpëtojmë një herë e mirë nga thash e themet, nga propozimet dhe nga bisedat e turpshme, që na bëjnë për ditë në telefon.

U ktheva në punë gjithë humor. Nikoja kishte hipur në majë të shkallëve dhe ja kishte filluar këngës së mëngjezit:

*”Sanë moj, sanë moj e zeza Sanë ,  
mbuloje, mbuloje moj se ta panë.  
Kush ma pa, kush ma pa mor i uruar,  
unë e kisha unë e kisha të mbuluar”*

U dëgjua zëri i Sanies:

- O Niko, a do ta lesh atë këngë tashti..

E kuptova që kisha hyrë në rutinën e përditshme të montimit. Mbas 2 javësh dorëzuam centralin dhe u këthyem në uzinën e P.t.t së.



Vitet kalojnë por Biku dhe Dolfi kanë mbetur të pa harruar në kujtesën time. Dolfi si mbret i tangos shqipëtare:

<https://g.co/kgs/f5776Nf>

dhe Biku si legjendë e humorit Shkodran.



Të dy nuk jetojnë më, por për mua kujtimi i tyre do të mbetet i pa vdekshëm.

Shpesh kujtoj filozofinë e Bikut në lidhje me humorin dhe fjalorin humoristik që përdorte. Këtu ku jetoj, të ashtuquajturat “parolacce ” kanë hyrë shumë në fjalorin e përditshëm dhe unë gjithmonë qesh kur i dëgjoj dhe kujtoj Bikun.

## ***Epilog***

*Ngjarjet e përshkruara në libër kanë bazë reale. Ato bazohen në kujtimet e autorit dhe të personazheve kryesorë të librit. Po kështu të gjithë personazhet kryesorë janë realë. Kanë jetuar dhe kanë marrë pjesë në episodet e përshkruar në libër.*

*Jemi pra ne, shokët e Radioelektronika 74, që me kujtimet tona, krijojmë përmbajtjen e librit..Është jeta jonë e përditshme e atyre viteve që reflektohet nëpër këto shkrime. Libri është pra, pjesë e biografisë të këtij grupi shoqëror.*